

Kjo kumtesë është mbajtur në konferencën shkencore ndërkombëtare “Bajroni dhe bajronizmi në botën shqiptare”, organizuar nga Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë

Bajroni si frymëzues i temës shqiptare në art

Nga Prof. Dr. Ferid Hudhri

ÇFARË ËSHTË NJË LEXIM PLAZHI?

Nga Chelsea Ennen (fq. 23)

ISHTE KADARE, DHE NË KËTË, ISHIM EDHE NE

Nga Ballsor Hoxha (fq. 7)

SHËNIME MBI LIBRAT

Botimet Dituria, 2006

“MOTI I MADH”, NJË LIBËR SUI GENERIS I SHUTERIQIT

Nga Feride Pappleka (fq. 8)

Mbi librin “Mbledhësi i mjegullave”
të poetit Sami Velçani

NJË DHEMBJE NGA TOKA PËR QIELLIN

Nga Dhimitër Pojanaku (fq. 10)

Anton Nikë Berisha, Rreth disa kryeveprave të letërsisë
sonë. Botoi SHB “Faik Konica”

LIBËR QË DËSHMON STUDIMIN CILËSOR TË KRYEVEPRAVE TË LETËRSISË SONË

Nga Mikel Gojani (fq. 12)

Spiro Gjoni, Udhëtimi letrar i Sazan Golikut UDHËTIM NË POETIKËN E NJË AUTORI BASHKËKOHËS

Nga Prof. Dr. Klara Kodra (fq. 13)



KADARE: PËR NJË VEPËR UNIVERSALE

Nga Fatmir Alimani


Ai perceptoi nga kjo botë gjërat themelore të jetës dhe të vdekjes. Në perceptimin e tij madhor ndodheshin të gjitha perceptimet e mundshme. Por perceptimi në fjalë, nuk mbetej asnjë herë vetëm perceptim, por bëhej ndijim dhe emocion, për të krijuar kështu një atmosferë inkandeshente universale.... (fq. 6)

Fotografi i shquar shkodran Dedë Jakova

Nga Qerim Vrioni (fq. 22)

“Shije, pije dhe aroma në letërsinë dhe artin shqiptar”

Nga Elektra dhe Stefan Çapaliku



BIBLIOTEKË

Roland Gjoza (fq. 14)

Prelude poetike

Artur Spanjoll (fq. 15)

Mërgata e korbave

Flamur Topi (fq. 16)

Homo Sapiens në qytetin

që nuk sheh

Arjola Zadrime (fq. 18)

Po të due unë

Arben Mexi (fq. 24)

Karikatura e së shtunës

MBI GJENINË, DISTANCËN DHE VETMINË E KADARESË

Nga Dr. Skënder Karriqi (fq. 11)

Vizionet mbresëlënëse të Henry Moore të Londrës gjatë Blitz-it

Nga Sotheby's (fq. 19)

Bajroni si frymëzues i temës shqiptare në art

Nga Prof. Dr. Ferid HUDHRI

Pas udhëtimit që bëri në Tepelenë gjatë vitit 1809, kur shkroi për traditat dhe zakonet burrërore të vendasve, për veshjet e bukura, duke pozuar në studion e piktorit Thomas Philips në Londër me kostumin shqiptar, poeti i famshëm i romantizmit anglez George Gordon Byron (1788-1824) ndikoi më shumë në përkapjen e temës shqiptare nga artistë europianë. Vargjet e tij *për bijtë e shqipes* te *Çajld Haroldi*, si dhe vlerësimi për *veshjet më madhështore*, nxitën shumë artistë nga Europa në realizimin e tablove, gravurave dhe krijimeve të tjera. Nisur nga

fama e tij e madhe, nga rrezatimi i krijimtarisë dhe figurës së tij *me fuqinë e një Prometheu* të shekullit XIX, siç e ka quajtur Bjelinski, për shumë autorë apo vepra të veçanta të krijuara gjatë shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX, Bajroni mund të pagëzohet edhe si *frymëzuesi i temës shqiptare* në artin botëror.

Nga piktura *Bajroni me veshje shqiptare* u nxitën shumë artistë tjerë në realizimin e veprave kushtuar shqiptarëve. Sipas vëzhgimeve të studiuesve anglez Christine Kenyon-Jones dhe Geoffrey Bond në ilustrimet e para të veprave të Bajronit, të realizuara



“Bajroni me veshje shqiptare”, akua-rel i vitit 2017, nga A. Guillamos.

nga piktori Thomas Stothard, personazhet paraqiten me veshjet shqiptare si në pikturën e Filipsit¹. Po ashtu edhe në shumë tablo nga Delacroix, Colin, Decamps dhe autorë të tjerë të njohur, që u realizuan nën ndikimin e Bajronit, figurat kryesore janë pikturuar me të njëjtën tipologji veshjesh. Gjithë këto piktura, ilustrime e litografi sot mund t'i paraqesim edhe si dëshmi të bukura piktorike që tregojnë se



Fragmente nga piktura “Bajroni me veshje shqiptare” (Thomas Philips)



“Bajroni betohet në varrin e Marko Bocarit” (Ludovico Lipparini)



statuja “Bajroni me veshje shqiptare” që është vendosur në Mesollongji.

motivet shqiptare të Bajronit përveç Çajld Haroldit, i gjejmë edhe në vepra të tjera si të “Nusja e Abidos” dhe “Gjauri”².


Në veprat e piktorëve anglezë, francezë, gjermanë dhe të tjerë, gjatë udhëtimeve nëpër trojet shqiptare në shekullin XIX dhe vitet e para të shekullit XX jo vetëm që ndihet qartë ndikimi i poetit rebel e frymëzues, po citohen edhe vargje apo shënime të tij për shqiptarët. Pranë gravurave të C. Woodville-t, ku paraqiten tipa malësorësh, shkruhet se *piktori është nxitur nga përshtypja e Bajronit për kostumin e mrekullueshëm shqiptar, me fustanellë e me rrobat e qëndisura me ar dhe armët e lara me flori*. Përshkrimi i *Bajronit*, shkruhet pranë një gravure tjetër, *sjell të gjallë përpara mendjes së njeriut që nuk ka shëtitur këtu, kostumin e mrekullueshëm shqiptar. I zbukuruar me këtë madhështi të bardhë, të kuqe dhe të artë, shqiptari të kënaq syrin, njëlloj si në fillim të shekullit kur Bajroni e pa në Jug të vendit*³. Gravurat e W. Williams-it me motive nga bregdeti i Jugut shqiptar janë shoqëruar gjithashtu me vargje të shkëputura nga Çajld *Haroldi*. Artisti ka zgjedhur këndvështrime piktorike sa më të përafërta me përshkrimet e poetit. Gravurën e parë e ka shoqëruar me vargjet: *O Shqipëri ku lindi Iskanderi/ Këngë e rinisë, fanar i të urtëve... lejomë të kthej sytë e mi/ Mbi ty o nënë burrash të rreptë*⁴. Gravurat e tjera shoqërohen me strofat e mëpasshme që i përshtaten peizazhit të pikturuar. Edhe në albumet dhe librat ku u botuan akuarelet, vizatimet dhe litografitë e piktorëve Charles Cockerell, Joseph Cartwright, Poer Beresford, Henry Cook, Edward Lear, Edith Durham dhe çiftit Cora e Jean Gordon, përmendet emri dhe vargjet e Bajronit për Shqipërinë.

Nga poeti u ndikuan edhe piktorë të tjerë që nuk mundën të udhëtojnë nëpër viset shqiptare. Ndër të parët e këtij grupimi është kreu i romantizmit francez Delacroix. Në ditarin e tij të datës 11 maj 1824, pikërisht në kohën kur hidhte në telajo tablotë me temë nga Shqipëria dhe Greqia, shkruante se gjatë pikturimit në studio *për t’u ndezur i tëri, kujtoj vargje të Bajronit*⁵. Dhe tablotë e tij për shqiptarët,



Th. Philips, “Koloneli George Vivian me veshje shqiptare”, Galeria Kombëtare e Portreteve, Londër.

sidomos ato kushtuar Marko Boçarit dhe suljotëve të tjerë, bartin atë fuqi, atë impuls dhe atë dinamizëm që ndihet në vargjet e Bajronit: *Kur mirënjohja dhe trimëria i shtyn të derdhin gjakun/ Sulen pa frikë kudo që t’i shpjerë prijsi* (shqipërim i F. Nolit). Edhe tablotë e romantikëve të tjerë francezë, Decamps, Scheffer, Gérôme, Colin, ku paraqiten figura shqiptarësh me veshjet tradicionale, janë nën ndikimin e admirimit që ka shprehur më parë Bajroni. Krahës këtyre veprave origjinale, nga disa artistë të njohur europianë janë pikturuar variante të tablosë *Bajroni me veshje shqiptare*. Nëpërmjet teknikës së gravurës, piktori William Finden stampoi shumë kopje që u përhapën në disa vende të Europës. Disa vjet më pas George Sidney Hunt krijoi dhjetëra litografi me bazë po këtë imazh. Piktori spanjoll Jean Michelle Hoper, i mbështetur në të njëjtën tablo, krijoi një vepër të re,



“Lord King duke pozuar si Bajroni”. Piktura është realizuar në vitin 1835, në kohën kur Lordi King ishte i martuar me Augusta Ada Bajron, vajza e vetme legjitime e Bajronit.

ku ndihet po aq interpretimi i tij. Ndërsa autorë të tjerë, si G. Müntzel, të mbështetur te kjo pikturë i kanë dhënë trajtë figurës tipike të shqiptarëve për albumet me kostume nga kombe të ndryshme të Ballkanit. Kështu për disa vjet piktura e Philips-it u shndërrua gati në një ikonë. Numri i veprave të frymëzuara nga Bajroni është akoma më i madh. Po ashtu edhe tablotë që e paraqesin poetin me veshje shqiptare nuk janë vetëm ato që u përmendën. Rreth vitit 1840, italiani Ludovico Lipparini pikturoi *Betimin e Bajronit mbi varrin e Marko Boçarit*. Midis grupit të madh të personazheve, aty spikat figura e Bajronit që ndrit nga ngjyrat e çelura dhe qëndisjet me ar të kostumit shqiptar. Poeti anglez me kostumin shqiptar është paraqitur në mjaft vepra në mjedise të ndryshme greke. Njëra prej tyre ndodhet në Muzeun Benaki të Athinës. Të tjera tablo gjithashtu



H. W. Williams, Shqiptar me veshje tradicionale, vizatim i vitit 1819. Koleksion privat, Angli.



Alexandre Colin, Tablo e frymëzuar nga krijimtaria Bajronit.



Eugen Delacroix, Tablo me motiv nga krijimtaria Bajronit.



Thomas Stothard, ilustrim nga krijimtaria e Bajronit

dëshmojnë figurativisht faktin e njohur se Bajroni e mbajti të veshur atë kostum gjatë shtegtimeve të tij nëpër Greqi. Në tablonë *The dream of Byron* (Ëndrra e Bajronit) të piktorit C. L. Eastlake, përveç poetit, me ato veshje janë pikturuar edhe personazhet që e shoqërojnë.

Pas vlerësimeve dhe jetësimeve në art, kostumi shqiptar u bë më i njohur në Angli e nëpër botë. Bajroni e mbajti atë edhe në disa pritje ceremoniale në Londër. Më pas kostumin e veshën figura të tjera të asaj kohe, madje disa prej tyre u pikturuan po nga Philips në të njëjtën studio në Londër. Janë të njohura portretet me veshje shqiptare të kolonelit anglez George Vivian (1770-1845), arkeologut, historianit të artit, politikanit dhe diplomatit të njohur Sir Austen Henry Layard (1817-1894), si dhe biografrit dhe shkrimtarit Edward John Trelawny (1792-1881), të tre miq të Bajronit dhe të Shellit. Kohët e fundit janë bërë të njohura edhe disa vepra të tjera ku personazhe të rëndësishëm janë pikturuar me veshjet që përdori poeti. Me interteres të veçantë është tabloja "Lord King mburret me pamjen si Bajroni". Aty paraqitet Lord William King-Noel duke pozuar me veshje shqiptare, njëloj si te piktura e Filipit. Piktura është realizuar në vitin 1835, në kohën kur Lordi King ishte i martuar me Augusta Ada Bajron, vajza e vetme legjitime e Bajronit.

Pas pikturimeve nga Thomas Philips, kostumin e tij të preferuar Bajroni ia dhuroi zonjushës Margaret Mercer, vajzës së kontit Keith, me të cilën ka pasur një korrespondencë të gjatë letrash dashurie. Vajza angleze, e sugjestionuar nga bukuria e kostumit shqiptar, e veshi në ditën e ceremonisë së fejesës së saj. Në vitin 1817 Margaret martohet me kontin Flahault. Vajza e tyre bëhet Markezja e katërt e fisit Lansdowne, pra pjesëtare e familjes së famshme që trashëgonte kompleksin muzeal të quajtur Bowood House & Garden. Kësodore *Kostumi Shqiptar i Bajronit* është bërë pronë e tyre. Ai qëndron i ekspozuar prej shumë vitesh midis veprave të artit dhe objekteve të tjera të çmuara të Britanisë e të disa vendeve të tjera.

Që nga ajo kohë vizita në Boowod House shoqërohet me emocione për çdo shqiptar. Sapo ngjitesh në katin e dytë të godinës kryesore të muzeut, përballësh me një sipërfaqe të madhe të qelqtë, brenda së cilës është vendosur një manekin me imazhin e Bajronit, veshur me rrobat origjinale, të bardha e të ndritura në ar, që poeti i kishte sjellë nga Shqipëria në vitin 1909. Përveç fytyrës dhe duarve, i gjithë shtati i manekinit është i mbuluar me petka shqiptare. Që nga shalli sipër kokës që varet mbi shpatulla, deri te çorapet; që nga jeleku, fustanella, xhamadani, mëngoret, të gjitha të endura dhe të qëndisura me mjeshtëri nga artizanët shqiptarë të shekullit XVIII. Në murin pas manekinit janë vendosur pjesë të tjera veshjesh shqiptare, si një jelek, një feste, një mbajtëse fishekësh etj. Anash veshjeve ndodhet një pllakë mermeri, ku është gdhendur shënimi shpjegues rreth përbërjes së kostumit, bashkë me të dhënat për kohën kur është marrë nga Shqipëria dhe kur është vendosur në atë muze. Kanë kaluar më shumë se 200 vjet nga dita kur Bajroni e veshi në trupin e vet atë kostum, si shenjë respekti dhe adhurimi për racën trimërore të shqiptarëve. Ndërkohë, është e kuptueshme që thurja, qepja, qëndisja dhe kompletimi i atyre veshjeve, mund të jetë bërë disa vjet para se Bajroni të arrinte në tokën shqiptare. Pra kostumi që ruhet në Boowod House & Garden është më se 200-vjeçar. Dhe ruhet në gjendje shumë të mirë, sa të krijohet përshtypja sikur sapo ka dalë nga duart e artizanëve

që e kanë endur. Në atë muze ndihesh mirë kur sheh se veshjet shqiptare kanë gjetur një nga ekspozimet më të bukura që u është bërë deri tani nëpër botë.

Midis shumëllojshmërisë së objekteve të dyqanit në Galerinë Kombëtare të Portretit në Londër, imazhi i *Bajronit me kostum shqiptar* gjendet thuajse në të gjitha variantet; në postera, në kartolina, në kopertina librash, në katalogë, në guida të Galerisë, në kuti lodrash, në medaljone, në kapakët për blloqe, në pulla postare etj. E themeluar në vitin 1856, Galeria Kombëtare e Portreteve ruan një nga koleksionet më të pasura britanike. Midis qindra e mijëra pikturave dhe skulpturave, *Bajroni me Kostum Shqiptar* është nga më të vyerat e atij koleksioni. Vetë figura e Lord Bajronit, pikturimi me mjeshtëri nga Thomas Philips-i, si dhe bukuria e kostumit shqiptar, përbëjnë tri nga vlerat e çmuara që e kanë shndërruar këtë pikturë në një ikonë të gjithë koleksionit. Prej shumë vjetësh, suveniret e ndryshme me këtë imazh, duke u shpërndarë në të gjithë botën, i bëjnë më të njohura veshjet shqiptare. Ka edhe tablo të tjera nëpër koleksionet e muzeve të ndryshëm ku paraqitet Bajroni me kostum shqiptar, por Galeria Kombëtare e Portreteve në Londër është vendi më i vizitueshëm, ku mund të këqyret dhe admirohet mjeshtëria e artizanëve shqiptarë në realizimin e atij kostumi.

Jehona e veshjeve shqiptare të Bajronit e shumëfishuar edhe në disa qindra ilustrime, litografi, gravura dhe tablo vazhdon të ndjehet edhe në ditët e sotme. Nga autorë të ndryshëm, shqiptarë dhe të huaj janë realizuar piktura të reja . Gjatë muajit maj të këtij viti, në përkujtim të 200 vjetorit të ndarjes nga jeta të Bajronit, studentja e dizajnit në Universiteti i Nottinghamit, Phoebe Godsmark stiloj dhe ekspozoi në mjediset e universitetit një variant të kostumit shqiptar mbështetur në pikturën e Thomas Philips të vitit 1813.



Kostumi i Lord Bajronit i rikrijuar nga studentja e dizajnit Phoebe Godsmark, Universiteti i Nottinghamit, maj 2024

BIBLIOGRAFI:

1. *‘Dangerous to Show’: Byron and his Portraits*, by Christine Kenyon-Jones and Geoffrey Bond, London, 13th October 2020.
2. Poeti Dhorë Qiriazi, nga hulumtimeve që ka bërë gjatë përkthimeve të disa vjershave dhe poemave të Bajronit, ka gjetur shënime të poetit anglez që dëshmojnë lidhje të tjera me botën shqiptare të poema *Nusja e Abidos*.

- Shih librin: Xhorxh G. Bajron, *Nusja e Abidos, vjersha dhe poema*, Globus R., f. 82, 123, Tiranë, 2007.
3. Mayhew, A.: *In Albania with the Ghegs*, Scribner’s Monthly, vol XXI, f. 377-391, New York, 1881.
 4. *Sipas botimit të shqipëruar nga Skënder Luarasi* Byron, G.: *Childe Harold’s Pilgrimage 1812-1817*, Onufri, f. 48-59, Tiranë, 1999.
 5. *The Journal of Eugene Delacroix*, f. 87, 144, London, 1938.

“Shqiptarë duke vallëzuar”, akualet nga Henry Warren. Frymëzuar nga kujtimet e J. C. Hobhouse për udhëtimin e tij bashkë me Bajronin në vitin 1809.



Gjeniu bëri sikur e ndaloi fluturimin. Në fakt, Kadare bëri sikur iku në një mister tjetër. Ishte fjala tashmë për misterin e fundit. Ai bëri sikur preku vdekjen. Në të vërtetë, ai vetëm sa la përgjithmonë tokën e të vdekshmëve, për të hyrë në përjetësi, në botën e të pavdekshmëve.

Për të nuk kishte asgjë të papërballueshme. Për të përballuar dhe fituar të përjetshmen duhet të fitojë përjetësinë. Kjo ishte një fitore unike dhe universale. Kadare ishte një zbulues, që fshihte njëkohësisht diçka misterioze. Çdo lloj manipulimi nuk kishte asnjë shans. Asnjë intrigë. Dështimin e priste çdo aventurier. Ai ishte dhe mbetej universal.

Ose, ne mund si një kohë tjetër e një rapsodi homerik modern, ose, si një përçudnim mitik.

Kadare i dha botës vepra artistike madhore. Ja, vetëm disa prej tyre:

Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Kronikë në gur, Kështjella, Përbindëshi, Pallati i ëndrrave, Hija, Aksidenti, Ftesë në studio, Hamleti princi i vështirë, Prilli i thyer. Dimri i madh, Koncerti, Eskili ky humbës i madh, etj.

Si gjithë shkrimtarët e vërtetë, ai e vëzhgonte politikën e madhe botërore, me sytë e shqiponjës dhe me qetësinë e vetvetes. Kjo i jepte fuqi të posaçme atij, një fuqi, që e bënte atë të përballonte çdo situatë të ndërlkuar. Çdo inskenim. I çdo luftë sekrete apo të hapur.

Për Hamletin dhe Makbethin, ai përdorte një hetuesi shumë të çuditshme. Gjithçka kulmonte në pyetjen e pyetjeve: “Mos vallë ajo që shikonim në skenë, mbulonte një tjetër? Një tjetër. Po një tjetër. Kush ishte ky, ky tjetërlojsi, i cili gjithnjë hidhte gurin dhe fshihte dorën. Nuk është zbuluar akoma. Ai kërkohet në të gjithë botën. Ka qindra vjet që nuk e gjejnë dhe vazhdojnë ta kërkojnë më me ngulm se kurrë. Çfarë ka ndodhur më parë? Çfarë ndodh sot? Çfarë do të ndodhte nesër?

Mbuluesi i enigmave ishte i pagjetshëm. Ai është një mjeshtër i illojit të vet. Një tjetër. Një tjetër histori, që po të tregohej, bota do të mbushej plot me ujë të bollshëm, por askund nuk shfaqej një vend me ujë të pijshëm. Ose kudo mund të gjeje vetëm ujë të turbullt. Mjaft! Çfarë dreq rrëfimi është ky?

Shekspiri u stërvit fshehurazi, për të përballuar çdo situatë të re, të jashtëzakonshme.

Disa rrenacakë kishin hapur fjalë, që, Shekspiri nuk ishte i aftë që ta tregonte një nga historitë e vjetra, sepse ajo ishte aq e ndërlkuar, dhe nuk e kishte zgjedhur askush gjer më sot. Çfarë ? Çfarë? Çfarë thuhet e çfarë nuk thuhet në këtë botë. Si nuk qenka i aftë Shekspiri i madh, për të treguar qëndroqoftë, dhe sado e ndërlkuar që të ishte ajo? A nuk kishte Shekspiri një mendje universale? A nuk ishte ai një njeri universal?

Çfarë kërkonte ai, zoti K? Ndoshta nuk e lanë të tjerët, ose e mashturuan njerëzit, vallë, njerëzit e tij të largët, gjer tek më të afërmit, si vëllezërit dhe motrat. Nëna, ati, kushërinjtë, apo miqtë më të mirë. Çka të ban i joti, nuk ta bën kurrë i huaji.

Kështu thuhej dhe kështu ishte dhe kështu nuk ishte.

Po tjetër? Një grup simpatik mendonte, që Shekspiri nuk donte ta interpretonte vetë këtë apokalips. Përse? Sepse do të zbulohesh qëllimi i tij i fshehtëdhe i madh.

Çfarë kërkonte? Mos dëshironte të bëhej zëvendësuesi i Hamletit të ri? Joooo...

Po... ja... Kadare mund të zbërthente gjithë gjërat e pazbërthyeshme. Një shkrimtar i mirë ka mendjen e tij, stilin e tij dhe fantazinë e tij. Kadare i njihte mirë kundërmimet e veçanta të çdo fjale.

Ai kishte një nuhatje speciale njerëzore. Harmonia dhe antiharmonia shkriheshin në njësh, dhe përbënin një mister të vetëm, por tashmë, të ri dhe të guximshëm.

Ishte një betejë tepër e hollë dhe një kalim përtej gjithçkaje gjeniale.

Kadare ngjitej vazhdimisht lart e më lart.

Asgjë nuk mund ta ndalonte marshimin e tij prej maratonomaku grek dhe prej një maratonomaku tjetër universal. Kadare e siguronte universalizmin e tij duke përfshirë gjithçka, si një uragan, pa asnjë përjashtim. Ai ishte i gjithësishtë. Ai zotëronte një çelës universal. Kadare ndiente edhe tërheqjen e trupave të gjithësisë nga njëri tek tjetri.

Andrra të fikura të hedhura në rrugë, bënin një dritë të ëmbël, si të ishin rritur me mjaltë e me bukuri.

Shpresa të rreme luanin bashkë çdo ditë dhe megjithëse gjithnjë humbnin, vazhdonin të luanin pa pushim, gjersa i zinte mëngjesi nëpër rrugët e Brukselit, duke brohoritur.

Njerëzit këtu shihnin më mirë natën se ditën.

Megjithëse tre herë në ditë, edhe me hekur

KADARE: PËR NJË VEPËR UNIVERSALE

nga Fatmir Alimani

mund ta mbajmë veten, vetëm me hekur.

Si minjtë e uritur kemi rënë në një kurth special.

Ardhur nga Kina e çudive...

Kadare bën pjesë natyrshëm në racën e re të njerëzimit, sepse ai jo vetëm nuk harrohet por as nuk vjetrohet. Ai nuk e njeh sundimin e kohës, të cilës i përkulen miliona njerëz. Ai nuk preferon sensacione boshe. Miliarda të tjerë janë zhytur thellë në një moçal apokaliptik. Të tjerë akoma ndjekin gjithë jetën lojën e paradokseve. Shpesh, këto paradokse nuk ndodhen në librin e autorit, por në kokën e lexuesit.

Kush isha unë? Kush po e tregonte këtë histori? Unë? Përse unë nuk e dija kush isha unë? Me një siguri të plotë? Oh, nëse nuk ka unë as antiunë, çfarë ka atëherë?

Kadare guxon ta zbulojë jetën, atje ku nuk ka mundur askush tjetër. Guximi është thelbi i tij. Kjo i ka dhënë gjithë veprës së Kadaresë një frymë të fuqishme shekspiriane. Ose ai duket sikur kompozon një muzikë të re. Një kryevepër aktuale. Ose një skulpturë të mrekullueshme.

Kadare shkonte prorre përtej përtejshmërisë. Atje ku të gjitha gjërat marrin formën e tyre metafizike.

Si një botë tjetër shpalolet para lexuesit gjithë vepra e Kadaresë. Kush e bëri historinë e botës me bujashka tradicionale dhe me kalbësira moderne? A është pena më e fortë se shpata? Njerëzit apo demonët?

Kush do t'i zhdukë moskuptimet ose keqkuptimet? Si duhet t'u a mësojmë popujve leximin e ri? Leximi është muzikë, thoshte Kafka. Një lexim i pastër, i gjallë, i dashur, që depërton gjer në thellësi të çdo fjale. Apo në thellësinë maksimale.

Një lexim nën ujë, çfarë mund të sillte? Ai e shikonte botën nga perspektiva e zogut ose e tokës. Nga shteti i diellit apo nga shoqëria e lirë e hënës. Çfarë të shqetëson, i thoshte ai botës.

Kurrsesi, nuk mund të gjeje tek ai një fjalë të tepërt as të mangët. Por koha ishte gjithnjë e pamjaftueshme.

Shkrimtarit të vërtetë nuk i mjafton koha kurrë. Të gjithë janë të pakënaqur me të. E megjithatë, shkrimtari e kryen veprën e vet. Pamjaftueshmëria mund të mundet hap pas hapi.

Kujdes, çfarë të shqetëson? Një presje e vënë keq, apo një pikëpyetje e harruar?

Ti nuk ke sy që të shohësh. Ti nuk sheh, Ti je i verbër, me 400 sy në ballin tënd lirik. As i vdekur as i gjallë. Ti nuk ke pasione as emër.

Hej! Kush mund ta interpretojë drejt një artist të madh? Nuk ka keqkuptim më të madh dhe më absurd. Me 400 sy në ballin tënd epik. Mjaft! Ikja dhe ardhja janë e njëjta gjë. Të vdekur ne jemi ndoshta miq të mirë. Të gjallë jemi armiq të tërbuar. Hej! Hapni sytë mirë. Këtu ka material për një film fantastik me seri. Mund të fitojmë edhe gjërat që quhen të pashitshme.

Mund edhe të humbasim gjëra që nuk do t'i shohim me sy, kurrë më. Mund të bëhemi me dy fytyra, ose me tre. Mund të largohemi nga toka. Po ti, a nuk do të vish me ne? Përse ngurron. Ti nuk ke frikë nga përgjimi. Ah, edhe përgjuesit, kanë uri, kanë etje. Bota jonë është më i madhi burg, më i vjetri dhe më i riu. Më i vërteti. Ah! Këtu nuk ka tiranë me bollëk, ku mund të zgjedhësh tiranin tënd, lirisht.

Diçka më e keqe se vdekja, më ka mbërthyer me litarë prej çeliku. Në të vërtetë, jam tërësisht i lirë. Asgjë nuk ka ndodhur. Diçka më e keqe se vdekja mund të ishte brejtja e trurit. Ty të është prishur gjaku, por ti nuk e kupton çfarë të ka ndodhur. Por, kur ke kuptuar ti, ndonjëherë, diçka më të keqe se vdekja?

Ti nuk ke guxim për asgjë. Ndoshta më e mira mungon, duke pritur që ta shprehim ne.

Për sa më përket mua, fjala më e lartë është fjala guxim.

Guximi legjendar i Kadaresë. Guximi i guximeve.


Ai e njihte mirë artin e kalimit nga një guxim te tjetri. Asnjë herë nuk u përku. Asnjë herë nuk zgjodhi

rrugë të qeta as kompromise të blera me para të pista. Guximi i tij shfaqej në temat madhore që trajtonte, në fjalët që zgjidhte, në figurat e mrekullueshme që i përdorte me një mjeshtri të jashtëzakonshme. Ai ishte i prekshëm dhe e trajtonte çdo temë me një transparencë dhe ironi që merrte përmasa të papara gjer më sot. Kjo ironi e gjithëgjendshme pushtonte tërë procesin e krijimit. Ajo ishte një ironi kolosale dhe një metaforë gjeniale, që e bënte tekstin të triumfonte mbi çdo kundërshtar.

Me dashurinë nuk mund të luftosh me asnjë armë dhe me asnjë truk homerik. Dashuria është një dhimbje universale. Por ajo është bërë karikatura e karikaturave. Ruajuni nga hiçi, ruajuni nga kitschi. Ruajuni nga kripa dhe sheqeri. Dhe çdo histori ka një histori tjetër paralele dhe të papërfundueshme. Çdo gjë rifillon nga e para. Çdo histori do të vazhdojë të jetë rrëfimi i moskuptimit.

Prandaj, a nuk presin të gjithë që të jenë një ditë tiranë më të marrë.

Presim posi, çfarë të bëjmë tjetër. Gjithçka do të përsëritet.



Ne pyesim: Kur “do të çamletizohet” bota dhe njerëzimi?

Gjithçka vazhdon të jetë e pashpjegueshme. A mos duhet patjetër, që njeriu të mbysetë tjerët, për të mbetur më në fund, i vetëm në skenën e madhe? I vetëm në një duel me veten, me veten, vetëm në një duel, me vetveten, në mes të një fushe të pafundme, të pafundme e të pafundme.

Jo, po , jo, pooooo...

Brenda do të thotë jashtë Jashtë do të thotë brenda

Ne ua kaluam të gjitha gjërave të guximshme.

Çfarë të bëjmë atëherë? Një skenë nga Amerika.

Asgjë nuk kuptohet. Pse? Askush nuk do të kuptojë asgjë. Pse të kuptojnë, atëherë, kur nuk duan të kuptojnë, aspak? Për çfarë vlen kuptimi? Për asgjë. Kuptimi vetë është disi një lodhje e kotë. Një humbje don kishoteske e kohës. Kuptimi nuk duhet kërkuar. Ai paraqitet vetë me dëshirën e tij.

Guximi është kredoja e brendshme e një shkrimtari të madh. Shkrimtari i madh guxon të paguxueshmen. Arti i madh është i paimagjinueshëm pa guximin artistik. Pa guximin e fuqishëm. Pa shkeljen e rrugëve të pashkelura nga askush tjetër.

Kadareja ishte me të vërtetë i guximshëm. Ai e njihte mirë artin e guximit. Asnjëherë nuk ndoqi rrugë mediokre ose boshe. Guximi i tij shfaqej në një prekje të nervit të botës. Ai trajtonte temat e mëdha duke i parë ato në një dritë tjetër, dhe në një vizion të vetin, derisa gjithçka paraqitej e re dhe e freskët, e sidomos origjinale. Aalternativat e mundshme e të pamundshme nuk mungonin kurrsesi. Ai zhytej në thellësitë më të mëdha. Ai depërtonte në zonat më të turbullta e të frikshme. Kadare prekte atje ku nuk guxonte askush tjetër. Guximi i tij merrte përmasa madhore. Me fjalë të rikrijuara dhe me pak gjeste njerëzore, që mund të elektrizonin gjithkënd. Ai mund të arrinte atje ku dukej e paarritshme. Kadare ishte edhe një kryengritës modern, i cili nuk pranonte ekuivokë as kurrfarë dyfytërsie. Metafora, elipsi, simboli dhe alegoria, kishin një shkëlqim të veçantë. Ai shkruante me lehtësi, edhe për gjërat më të vështira. Ai kishte lindur për të shkruar bukur.

Ai kishte lindur, për të sfiduar kohën dhe vetveten, për të pushtuar gjithë zonat yjore.

Vepra e tij i kaloi shpejt të gjithë kufijtë e mundshëm. Ajo depërtoi gjithkund, me cilësinë e vet gjeniale. Ai ishte një epik i madh, por edhe një lirik i përveçëm, fin, dhe i papërsëdytshëm. Fjala e tij është fjala e re që e ka lindur dhe e ka sjellë tek ne, vetëm ai vetë. Ai ishte jo vetëm një artist i madh, por edhe një titan. Kadare kaloi gjithnjë tutje, në majë të brisikut.

Ai iku tutje përmes rrufeve. që nuk pushonin për asnjë çast, Ai bënte sikur nuk i shihte.

Çdo gjë është përjetim, thoshte filozofi gjerman, Martin Heidegger, por ndoshta , vijon ai, përjetimi është elementi , në të cilin arti vdes. Vdekja ecën kaq ngadalë saqë ka nevojë për disa shekuj.

Disa shekuj kërkon vdekja. Vdekja mashtron. Dhe arti i madh fshihet në bukurinë e një morri suprem. Zhurmë në sallë. Dikush ulërin. Dikush qan. Dikush qesh. Dikush qesh dhe qan. Joyce, Joyce, joyce !

Dikush që është më i keq se vdekja dhe më i mirë se një mollë flakë e kuqe.

Kur e shikojmë këtë mollë lakuriq, ajo na duket si një eliksir. Por bota nuk i do mollët, edhe pse ato janë më i bukuri frutë i tokës. Mbi mollën mund të filozofojë gjithë njerëzimi. Por ai nuk e pëlqen filozofimin. Kurrsesi. Kurrsesi. Kurrsesi!

Unë jam shkrimtar, ngulmon ai, jo filozof. Unë dua t'ju tregoj për mrekullitë e njeriut të bërë njeri. Mjaft, por shko shihe me sytë e tu, gjithçka. Emocionet kanë vdekur para dymijë vjetësh. Emocionet kanë dalë tashmë nga



moda. Emocion, kjo fjalë është harruar që prej kohërave që nuk mbahen mend. Emocion, emocion, emocion... s'ka pasione, s'ka zakone, s'ka sineritet. Për çfarë flet ti, o idiot gjenial? Për bishtin e qenit. Aleluja.

Ai shkruan kryevepra. Por këtu mungon sineriteti sublim. Diçka më e keqe se vdekja, ka një pasuri përrallore. Kjo diçka ka një pushtet magjik mbi botën dhe njerëzimin.

Ajo kishte vënë një hije, që të më gjurmonte mua këmba - këmbës. Ditë natë. Pa pushim.

M'u bë akrep. M'u bë akrep. M'u bë akrep Kadare zbuloi artin e ëndrrave absurde. Ai e zhveshi ëndrrën lakuriq. Vetëm ëndrra ta tregon të vërtetën. Vetëm ëndrra. Vetëm.

Çdo gjë është përjetim i artit të madh. Apo jo? Kadare kërkonte pa kërkuar. Si, kështu? Si mund të kërkohet pa kërkuar?

Ai gjente gjithmonë një perlë. Ah, ajo është e gjitha një emocion. Mjaft! Thoshin që nuk ka më, madje as pasione.

Ndoshta...

Çfarë?

Thuaje të gjitha çmimet e rëndësishme të botës, për letërsinë, ai i fitoi.

Hm! Gjithmonë në veprën e Kadaresë, kemi një perceptim të jashtëzakonshëm të botës dhe njerëzimit. Ky perceptim krejtësisht vetjak, shpalos një kuptim shumë më të ri dhe më të guximshëm. Kadare kridhet në thellësitë më të mëdha të fjalës dhe antifjalës. Por, po ashtu, gjithmonë në një hapësirë të stërmadhe duket e zhduket "tymnaja e dyshimit". A mos po shkojnë hebrejntë kundër vetvetes? A mos po rrotullohet bota mbrapsht? Kush po e shkruan kumtin e ri për gjithë njerëzimin? Për të gjithë botën.

A nuk u bë lufta gjëja më qesharake dhe më absurde? Kush kujtohet më për kuptimet e dyta?

Dhe bota nuk merr dot frymë lehtësisht. Bota vuan nga astma.

Kadare është gjithashtu i përveçëm dhe një sovran i artit të madh.

Ai perceptoi nga kjo botë gjërat themelore të jetës dhe të vdekjes. Në perceptimin e tij madhor ndodheshin të gjitha perceptimet e mundshme. Por perceptimi në fjalë, nuk mbetet asnjë herë vetëm perceptim, por bëhej ndijim dhe emocion, për të krijuar kështu një atmosferë inkandeshente universale. Ai bëhet gjithashtu një personalitet universal. Ai ka kuptueshmërinë më të lartë dhe mund të konkurojë edhe me vetë zotin,

Mbrapa çdo fjale mund të zbulohet diçka më e keqe se vdekja, ose më e mirë se gjithçka e derisotme. Një dëgjueshmëri dhe një kuptueshmëri thuaje e pagabueshme, i jepte shkrimit të Kadaresë, një pamje më se të qartë të universales moderne,

E më pas,

një frymë e re

një botë e re

një botë e re

E më pas, mund të zbulohen thesare ose formula të çuditshme. Edhe pa e kuptuar. Mirë bëjmë nëse gjithmonë të kridhemi në botën e emocioneve, të ndjenjave dhe të luftës së fundit. Popujt nuk zenë menë mend kurrë. .

Ai kishte një zë të fuqishëm unik. Me një këndvështrim unik, me një gjuhë unike thuaje personale,

dhe me vizionet dhe me gjetjet e mrekullueshme artistike,

Kadare bëhet Kadare,

dhe ai e pushtoi botën me shpejtësi. Ai zotëronte një mënyrë krejtësisht të vetën, në kapjen dhe kuptimin e diçkaje. Kadare i dha vendit të vet përmasa kozmike. Një kritik i madh vë në në theks qartësisht, "rokjen e historisë me një frymë të fuqishme shekspiriane."

Vlerat e shumëvëçanta universale dhe kombëtare, e bëjnë atë, një nga shkrimtarët më të mëdhenj të botës.

Ai bëri sikur iku nga bota jonë. Në të vërtetë Ai mbeti përgjithmonë tek ne. Tek secili prej nesh.

S'mund të bëhej ndryshe. Ai i takonte kujtesës sublime. Jo harresës! Ai i kapërceu me guxim të gjitha rrethimet dhe ndjekjet barbare. Ai e sfidoi botën madje edhe qiellin. Iku vërtet, por u kthye shpejt dhe nisi sakaq një roman të ri...

Ku ike ti pa folur asnjë fjalë, asnjë fjalë të ëmbël?

Hej, çfarë them unë! A mos jam akoma i çmendur?

Ti je këtu ku ke qenë mbrëmë gjer vonë në mëngjes.

Ti je këtu në vitin dymijë e një, në vitin tremijë e pesë.

Të gjitha shtëpitë e botës janë shtëpitë e tua!

Të gjitha shtëpitë e reja që do të ndërtohen Do të jenë përjetësisht shtëpitë e tua.

ISHTE KADARE, DHE NË KËTË, ISHIM EDHE NE

nga Ballsor Hoxha

Shkruaj për Kadarenë post mortum (megjithëse me shumë vonesë, shih përmbylljen e esesë për këtë!) dhe shoh se software i drejtshkrimit të gjuhës shqipe nuk e njeh emrin e tij – Ismail – nuk e ka regjistruar në emrat e gjuhës shqipe (megjithëse e njeh mbiemrin e tij Kadare). Ndërsa, gjuha e tij, Kadaresë, gjuha e veprës së tij na ndërtoi një udhë dhe udhërrëfim me disa shprehje përmes të cilave ne sot – arrijmë - jo vetëm të kuptojmë por edhe të shprehim kaosin që na ka marrë, mu sikur fiset shqiptare në romanin “Ura me tri harqe” dhe po na bartë në thellësitë e tij.

Kush nuk thotë sot lidhje e palidhje, më është ‘shpërfaqur’, kam ‘shpërfaqur’ etj; kush nuk e thotë sot se jemi të ‘krisur’, është i ‘krisur’, dhe aq më shumë në stil Kadarean ‘jam i krisur’; apo kush nuk e ka në gjuhën e përditshme sot shprehjen Kadareane ‘ndërmjetësi’. Këto shprehje dhe shumë, panumër shumë të tjera, jo që janë shpikur nga Kadare, por aq më shumë kanë marrë dhe kanë formuar një skelet ndërtimi të qenies shqiptare, para dhe pas tiranisë së komunizmit. Kanë mundësuar një ballafaqim të individit tonë, megjithëse jo të shoqërisë sonë, me këtë kaos që po rrëmben çdo përpjekje tonë.

1. “shpërfaqja” (Eng.: revelation, resurrection, remergence, etj)

Nëse i lexojmë me kujdes ‘shpërfaqjet’ në veprën e Kadaresë, prej romanit “Dasma” (roman që ironikisht ai kurrë nuk e deshi, por që BBC e inskenoi si dramë), e tutje në Kronikë në gur, në Ura me tri harqe, etj, etj, saktë këtu gjejmë zanafillën e Kadaresë si shkrimtar, si një Shakespearë i ri i ‘krisur’ që niset për të gjetur konstruktet skeletore të qeniesimit tonë, në ‘ndërmjetësitë’ e kalimit dhe të fshirjes së të tashmeve njëra mbi tjetrën, që u bënë totalitare dhe të pandryshueshme, të padryshueshme dhe të patjetërsueshme. Janë ajo ‘ndërmjetësia’ e të vërtetave që gjallojnë si avuj të një kënete të të vërtetave të mbetura, të ngecura në pamundësinë tonë, njerëzore e kolektive.

Në novelën “Muri i madh kinez” rojës së “ndërgjegjshëm” të murit që e ndanë Kinën nga barbarët, vazhdimisht i shpërfaqet kujtimi i një ndodhie të një vajze të cilës i ishte rritur dora, tuli e mishi nën “bylyzyk” aq shumë sa që nuk mund t’ia hiqnin nga aty, dhe në tërë ‘shpërfaqjen Kadareane’ po e njëjta krisë tërë Kinën në një trup të nxënë, pre e vetë bylyzykut të saj, e rritur aq shumë, Kina, sa që muri i saj është bylyzyku i saj që e prenë trupin e vetë saj. Kadare, arrin

që tërë përmasën e një bote ta ‘shpërfaqë’ në një bylyzyk të një vajze kujtim i rojës së murit të madh kinez.

Në një novelë tjetër të Kadaresë, nise mi nga një kafe e Shkodrës natën vonë, për të arritur në tërë kompleksin e traditës dhe ‘ligjës’ së Veriut të Shqipërisë, për të dalë tutje në shpërfaqjen e kompleksit të Narcisit, lindjes së narcisit, dhe të ‘shpërfaqjes’ së narcisit tutje në kohën relativisht moderne të njerëzimit, mu sikur që kishte ndodhur treguar nga miti, mu sikur që do të ketë ndodhur. E shohim duke ndodhur një nga komplekset më të mëdha dhe më të rrezikshme të njerit, në histori e në psiken tonë. Një narrativ i cili niset nga një natë krejtësisht e zakonshme, me një ritual krejtësisht të ‘krisur’ dhe që përfundon i pastër, i kthjellët në ‘shpërfaqjen e zanafillës së njeriut përballë tjetrit’.

Në një tregim të Kadaresë, ndër më minimalistët, ulur një çift, një burrë shqiptarë dhe një grua, në periferi të Moskës vëzhgojnë fluturimet e aeroplanëve, natën, është nata e fundit e tyre para ndarjes, dhe në këtë uturima e avionëve është uturima e ‘krisjes’ së botës, apo thënë më mirë e botëve, derisa njeriu i pandihmë shikon, në tërë atë që i ka mbetur, dhe pathënshtëm vuan këtë shumëfishim të botëve, të zhvleftësismit të botës ku këta dy janë takuar. Njeriu i harruar vëzhgon ‘shpërfaqjen’ e totalitarizmave, të ngërthimit të tërë këtyre botëve në një “Full Metal Jacket”; ‘shpërfaqjen’ paralajmëruese të pakthyeshmërisë së kësaj ‘krisje’ të botës në panumër botë totalitare.

2. Kadare – Bjeshkë e nemun?

Duke pas zgjedhur këto tri momente, nga vepra krejtësisht të harruara të Kadaresë, këto minimalizma (në raport me ‘shpërfaqjet’ që ai kapë dhe gjen në ndërmjetësinë e të vërtetave) përmes ‘ndërmjetësisë’, ‘krisjes’, dhe ‘shpërfaqjes’ që Kadare bën në këto, gjejmë një obsesion prej autori, prej shkrimtari për të hequr kufomat e vdekura të të vërtetave të këtyre botëve, rënë mbi njëra tjetrën në parg eshttrash të të vërtetës, dhe hapë atë “avullin” e rezonimit të ndërmjetësisë/ve të qeniesimit njerëzor.

Stili i tij, Kadaresë, që në masë të madhe ishte unik, por që e bënte peng i mënyrës leximit global, si trend; dhe aq më shumë ndarja perpetuale (e përpjekur) ndërmjet shkrimtarit dhe tiranisë, së botëve që ishin shumëfishuar, e lexuan stilin e tij sipas trendëve, e kuptuan atë në trendet e po kësaj ndarje perpetuale, të cilës ai edhe iu dha shumë herë, por, kjo hapë edhe pyetjen

e një gjëje krejtësisht unike: cilat do të ishin temat, cilat do të ishin personazhet, dhe cilat do të ishin intrigat në veprat e Kadaresë? Jo që Kadare kishte ndonjë shkarje, apo edhe devijim, apo edhe nënshtrim, “ai shkroi një letërsi normale në një vend jo normal” siç tha shumë herë, por pikërisht sepse universaliteti i veprës së tij do të ishte më i popullarizuar, më pak i rrezikshëm, më pak i cenuar dhe i izoluar pikërisht në të vërtetat e njerëzimit përmes një vendi “zotit prapa shpine” e që nuk ishte në trendin e leximeve masive globale.

Gjithnjë në leximin dhe mahnitjen me veprën e tij, Kadare vazhdon të akumulojë tirani prej autori. Tirani, nga pamundësia e arritjes së ‘krisjes’ së tij, së paku në kohën dhe jetët e gjeneratës sonë. Jo ironikisht, e quaj Bjeshkë e nemun, me seriozitetin më të madh, qoftë si shpërfaqje e tërë asaj që Kadare rrëmihi, apo thënë më saktë ‘krisi’ në varganët e kufomave të të vërtetave, një individ, një Ismail Kadare, si Bjeshkë e nemun, antropologjikisht e historikisht, që duke qenë se sot filozofia (të menduarit) është vetë trualli i njeriut, bjeshka që ngritë, në filozofinë e tij Kadare mbeti si një bjeshkë, si bjeshka më e madhe shqiptare, me fatkeqësinë e të qenit e vetme, e pazotërueshme dhe e paarritshme, e nemun në arritjen e saj dhe në përhershmërinë e saj, dhe në vetminë e saj.

Tirania e Kadaresë, nuk është një dhunë, domosdo edhe pse kjo është e natyrshme në këso përmasash, apo nuk është një totalitarizëm i dhunshëm, përkundrazi, ai u fotografua me gjysmën e Shqiptarëve për hir të tyre në restorantin ku rrinte, morri pjesë në çdo ngjarje, në televizione e shoqërimi e tubime të tyre, e të cilat i ironizonte, por vepra e tij ngjanë si një lundër, që vinte tërë këtë jetë të tij, por edhe jetës sonë, vinte gjithherë duke u zmadhuar në limanin ku ishte nisur, në limanin e vetëm të tij, të Shqipërisë. E shihej e vogël dhe e manipulueshme, dhe e injorueshme, e ‘servisuar’ qoftë edhe, sepse askush nuk mund të imagjinonte prej ku ishte nisur, për ku, dhe nga shkonte. E dimë të gjithë tani, prej ku, dhe nga shkoi, dhe ku edhe u ndalë. Si një lundër me një Uliks.

3. Ismaili dhe shpirtngushtësia e një realeje tonë

Ismail Kadare jetoi në afërsinë tonë, në të tashmen tonë dhe në praninë tonë, si individë e si shoqëri. Kjo fjali ngjanë krejtësisht e zakonshme, e harrueshme apo edhe e injorueshme, por mund ta themi edhe në një mënyrë tjetër, ne, gjenerata jonë jetuam ndan një historie të dhunës, përmbytur tanimë në kaosin e tranzicionit global a shqiptarë, gjenerata jonë jetoi ndan një individ që i doli ballë kësaj historie dhe po ashtu e ‘shpërfaqti’ këtë histori në përmasa globale. Si atë të Shqipërisë si atë kosovare, e po ashtu edhe në tërësi atë shqiptare. Do të na duhet një kohë ta shohim sa të vetëm kemi mbetur pa pararojën tonë, sa i vetëm ishte vetë Ismail Kdare si pararojë e ferrit dhe gjëllimit të të vërtetave të sajua, e pastaj edhe ta pranojmë se jetuam një histori që nuk përsëritet, por në krahun e një Uliksi.

(Personale: Kam takuar disa herë Ismail Kadarenë, por në takime të profesionit, dhe kushedi çfarë ‘krisje’ sarkastike kamë lënë në përjetimin e tij, sigurisht me ankthin tim të takimit të një Uliksi të gjallë e real. Kam edhe të botuar një studim për disa nga veprat e Kadaresë, dhe shumë shkrime për veprën e tij.

Sidoqoftë, në jetë, pas shumë rrokullimave, gjithnjë, si në ritual, jam ngritur duke e rilexuar veprën e tij. Aq shumë, sa që qe një kohë të gjatë, i strehuar nën rreshtat e tij, këshillohem me te, debatoj e pyetem, por po më merr kohë derisa ai të kthehet, si Prometeu, i zgjidhur më në fund, prej shpirtngushtësisë së reales ku jetoi).



Në veprimtarinë shkencore të Dhimitër S. Shuteriqit spikatin thellësia dhe gjerësia. Analizat e tij përfundojnë në sinteza të qëndrueshme, shpesh përfundimtare. Këtë libër, përmbledhje dokumentesh e shënimesh, të shoqëruara me komente për historinë e shekullit XV, për shekullin tragjik të historisë arbërore, autori e përgatiti në vitet e fundit të jetës, kur mendoi se kishte siguruar një material të mjaftueshëm dhe njohuri të sakta për të pasur një vizion pak a shumë të plotë për kohën. Shumica e këtyre dokumenteve, kronikave dhe librave ka fituar vlerat e vërtetësisë shkencore edhe në sajë të punës studimore krahasuese¹ të historianëve tanë të Mesjetës.

Në qendër të shekullit XV qëndronte figura madhore e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Ajo ka ndezur imagjinatën e brezave shqiptarë, sidomos gjatë lëvizjes së Rilindjes Kombëtare, e cila u kurorëzua me shpalljen e Pavarësisë më 28 nëntor 1912. Me figurën e kryeherit, Shuteriqi qe i lidhur qysh në moshë të re, sepse për të flitej shumë në librat e autorëve arbëreshë që kishte në bibliotekën e tij i ati, Simon Shuteriqi, Mësues i Popullit. Pastaj gjatë Luftës Antifashiste, në vitet '40 atë e tërhoqën legjendat e gjalla për Skënderbeun dhe sidomos ato që dëgjonte për Gjorg Golemin në Çermenikë e në vise të tjera lindore të Shqipërisë kur ishte partizan.

I apasionuar pas dokumentit dhe njëkohësisht shkrimtar dhe studiues, ai nisi të grumbullonte qysh në fillimet e punës intelektuale shënime që i radhiti nëpër skeda. Skedat e tij nuk ishin rastësore, ato ishin fryt i një plani konceptual që donte të rrokte me një vështrim tërësor, zanafillën e shkrimit dhe të kulturës shqipe. Këto kërkime dhe studime e futën pastaj detyrimisht edhe në burimet e rrjedhat e historisë së viseve arbërore.

Po ta shohësh veprën e tij të botuar, e cila ka marrë formën e një monumenti për kulturën shqipe, do të dallosh frymën konceptuale që karakterizon pjesën më të madhe të librave të tij : *Shkrimet shqipe në vitet 1332 – 1850* (1965) dhe ribotuar disa herë, e që u botua (si veper) *postume* më 2005, me titull të rikonceptuar nga vetë autori, me lëndën e re që ngjitej edhe 5 shekuj përpara: *Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879-1800*, me plotësimet që i bëri ai deri në fund të jetës ; Nëpër shekuj letrarë, studime (1973) ; *Gjurmime letrare*, studime (1974); *Moti i madh, postume*, (2006) ; *Dëshmi parabuzukiane të fjalës shqipe, postume* (2010), *Aranitët: historia-gjenealogjia-zotërimet, postume* (2011) ; *Fjalori i Naim Frashërit*, postume (2012), etj. Më herët ai kishte botuar: *Andon Zako Çajupi* (1950) dhe (1957); Kënga e popullit (1955) ; *Historia e Letërsisë Shqipe I*, Universiteti Shtetëror i Tiranës (1959) ; *Këngët e Milosaos, Jeronim De Rada* përshtatur në shqipen e sotme (1964) ; *Autorë dhe tekste (1977) ; Mbi Barletin dhe shkrime të tjera* (1979); *Naim Frashëri, jeta dhe vepra* (1982); *Historia e Letërsisë Shqiptare që nga fillimet deri te Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare*, kryeredaktor, Akademia e Shkencave (1983) ; *Marin Beçikemi dhe shkrime të tjera* (1987). *Nga kënga e popullit*, Mbledhës të folklorit, 9 Akademia e Shkencave dhe Instituti i Kulturës Popullore (1991) ; *Mili e Hajdhia*, Zef Skiro (Giuseppe Schiro), poemë, përshtatur në shqipen e sotme (1992) etj.

*

Dokumentet për Skënderbeun dhe Aranitin në të vërtetë mbushën dosje të tëra, prandaj Shuteriqi ndërtoi edhe një skedar

Botimet Dituria, 2006

“Moti i Madh”, një libër sui generis i Shuteriqit

Nga Feride Pappleka

që ndodhet në dhomën e tij të punës.² Nëpër sirtarët e skedarit ka shënime e të dhëna për shumë figura të shquara të kulturës dhe historisë shqiptare, në të cilat përzihen analiza dhe sinteza. Si erudit i madh që ishte, ai kishte mendimin e tij të pavarur, të mbështetur në teza dhe kundërteza, por edhe në përfundime shkencore.

Në librat studimorë Shuteriqi ka shtruar probleme shumë të rëndësishme, duke u futur thellë në historinë e kulturës me një seriozitet të gjithëhershëm dhe që e karakterizon edhe këtë tekst. « [...] krijimet e tij përcjellin probleme e shqetësime ekzistenciale për vendin e për kombin [...] », shkruan historiani Pëllumb Xhufi (Dr. Prof.) në « Hyrje ».

Puna e tij kërkimore u ngjan kërkuesve të arit. Duke e zgjeruar rrethin e veprimtarisë së tij krijuese, autori u zhyt thellë në histori, sepse dija e tij e gjerë kërkonte shumë hapësirë. Njohja me dokumentet autentike për Shqipërinë e frymëzoi Shuteriqin të shkruante edhe disa tregime historike për figura si Marin Barleti, Pjetër Budi, Dhaskal Todri, Dora d'Istria, Ismail Qemali e të tjerë. Ndër më të shquarit prej tregimeve historike është *Ditët e sprasme të Gjorg Golemit*. Disa tregime të tjera u përdorën për skenar filmash si : *Udha e shkronjave*, kushtuar Dhaskal Todrit, *Nëntori i dytë*, kushtuar Ismail Qemalit dhe Shpalljes së Pavarësisë, *Baltrave të Myzeqesë*, kushtuar Tefta Tashkos...

Qysh në vitin 1965, Shuteriqi, kishte botuar në revistën *Studime Historike, shkrimin* : « Aranitët : Emri dhe gjenealogjia ». « Me Gjergj Aranitin familja e Aranitëve arriti kulmet e lavdisë. Gjergji, vjehrrri i ardhshëm i Skënderbeut dha i pari sinjalin e kryengritjes së madhe antiturke në Shqipëri. Më 1443 me sulmin kundër turqve në Maqedoni ai « i çeli rrugën kthimit të Skënderbeut për t'u vënë në ballë të qëndresës së madhe shqiptare » (*Moti i Madh*, f. 9). Pa atë qëndresë emri shqiptar mund të ishte shuar dhe identiteti ynë mund të ishte shkrirë apo edhe të ishte zhdukur.

Për të krijuar kontekstin historik të veprës çlirimtare të Gjergj Kastriotit, ai i ngjiti kërkimet gjer në vitet 1379-1380 kur nis inkursioni i parë turk në Shqipëri dhe i shpuri ato më tej, pas vdekjes së Skënderbeut, deri më 1479, kur ndodhi Rrethimi i dytë i Shkodrës. Kështu, me një shekull historie që jetonte në 1400 e ca dokumente e shënime, ai e ndieu se mund t'i përmblihte ato në një libër.

Leximi, qëmtimi dhe krahasimi i dokumenteve sidomos për luftërat e Skënderbeut, ishte një punë tërheqëse, shpirtërore për Shuteriqin. Pastaj erdhi libri i Barletit *Historia e Skënderbeut*, përkthyer në shqip nga Kristaq Prifti dhe Henrik Lacaj. Dokumentet që kishte siguruar nëpër Biblioteka dhe arkiva si dhe shënimet apo komentet krahasuese, ishin një pasuri që nuk duhej të humbiste. Prandaj ai zuri t'i

² Autorja e këtyre radhëve ka dërguar në Bashkinë e Tiranës dhe një tjetër në Ministrinë e Kulturës një dosje për kthimin e dhomës së tij të punës në muze që para më shumë një viti e gjysmë ; dhoma-muze të tilla që kërkojnë pak shpenzime dhe administrohen nga Bibliotekat Kombëtare, ka kudo në botë (ato hapen për publikun një herë në javë me një punonjës të bibliotekës). Unë kam kërkuar që edhe skedari i tij, puna e një njeriu, e krahasueshme me punën e një institucioni të tërë, duhet të vendoset në Bibliotekën Kombëtare, në sallën shkencore që të përdoret nga studiuesit e rinj.

hidhte me makinë shkrimi më 17 janar 1993, datë përkujtimore e vdekjes së Gjergj Kastriotit. Në « Parathënie » ai shkruan :

« Një ditë të vitit që kaloi thashë :

Bëj një punë tani në shkurtim të urëve : sistemoje këtë skedar. Do të rijetosh, në këtë thyerje të ditës, madhështinë e diellit që bie. Diell qe Skënderbeu... Ka aty mësimë realizmi, qëndrese, krenarie » (f.10).

Vizioni i tij është largpamës. Me punën e tij, edhe si akt fisnikërie, ai shenjtëronte figurën më të madhe historike të kombit, të vërtetuar e të rivërtetuar tashmë disa herë. Është e kuptueshme, ai ishte bir i një prej familjeve patriotë të Elbasanit. I ati i tij, Simoni, kishte krijuar klubin patriotik *Afërdita më 1908* ; qe sekretar i *Kongresit Arsimor* të Elbasanit, 1909 ; ishte një ndër mësuesit e parë të Normales etj., dhe e kishte shkruar me dorën e vet telegramin që i dërguan Ismail Qemalit në Vlorë patriotët e Elbasanit më 1912. Duke u mbështetur te jetëshkrimi i tij, mund të veçojmë edhe se Shuteriqi ishte nip i Kostandin Kristoforidhit, i cili ka shkruar ndër të parët vepra shkencore për gjuhën shqipe : *Gramatika e gjuhës shqipe* (1882) dhe *Fjalori i gjuhës shqipe*, që u botua në Athinë më 1904. Pastaj, lidhjet rrethanore të familjes Shuteriqi me Mihal Gramenon, Foqion Postolin, Luigj Gurakuqin, Sotir Pecin, Aleksandër Xhuvanin e të tjerë, lanë gjurmë të forta në personalitetin e tij.

Këtë libër Shuteriqi e titulloi *Moti i Madh*, ashtu si e pati quajtur poeti i mërguar De Rada kohën e Skënderbeut. Dokumentet e shekullit të lavdishëm e të përgjakshëm XV, nisin në vitin 1379 me një dokument që autori i vë numrin 1, kur vdes në Shkodër Balsha I dhe pastaj vjen komenti i tij i qartë me një shqipe të rrjedhshme, elegante : « I vëllai, Balsha II (1378-85), që i zuri vendin, u bë më i shquari i kësaj familjeje feudale » (f.13).

Radhitja e dokumenteve ëshë bërë sipas kronologjisë, kjo është e natyrshme, por nxjerrja në pah e elementeve kryesore të tyre me shembuj, komente dhe krahasime, sjellin jehonën e kohës kur u shkruan. Lexuesi « sheh » historinë që ecën me skenat e saj të pamëshirshme : pushtime, vrasje, djegie, shkatërrimet.

4 : 1380, verë. Inkursioni i parë turk, në tokat shqiptare ngjet në zotërimet e Gjin Zenebizit, në viset çame. Ushtrinë osmane e komandonte Shahin Beu ose Lala Shahini. Hron. Joanninon 23. (f.13).

15 : 1384. Turqit përsëritën sulmet mbi viset shqiptare. Timurtashi sulmoi Artën. Gjin Bua Shpata thirri në ndihmë të vjehrrin, Thoma Preljuboviçin. Hron. Joanninon 27. Bozhori, BB 29. Pulaha, në StH 1/1968, 128. (f.18)

16 : 1384-5. Pikturohet kisha e Sh. Athanasit, e ndërtuar nga Muzakajt, në Kostur. Macedonia 415.

35 : 1388. Turqit depërtojnë gjer në Vlorë, Durrës, Lezhë. Fillon kështu pushtimi i Shqipërisë së Jugut. HShq I 241. (f.19).

95 : 1400, rreth. Emri Arbër, Arbëri, përfshin mbarë vendin edhe Janinë e Artë, sipas kronikës së Tokojve. Çabej, në StF 1/1979, 46-7 (f. 29).

110 : 1402, 8.V. Në Shkodër, Drisht e Lezhë ka rënë murtaja, që kishte rënë dhe në Peloponez (në Modon). Po aty 118. (f.31).

Po të vihet re, Shuteriqi sjell edhe ngjarje të tjera, të nxjerra nga dokumentet e kohës.

150 :1406, 2. VI. Gjon Kastrioti ka dërguar në Venedik ambasadorin presbiter Vukatanin (Vulcata), të cilin papa e rekomandon veçanërisht. Ai është ambasador edhe i zotërinjve të tjerë të anëve të Shqipërisë (partium Albanie). AV. III 1197. (f.31).

« Është dokumenti i parë që dimë se flet për t'anë e Skënderbeut » (f. 37).

Autori këtu hedh dritë mbi një të vërtetë orientuese. Pastaj vjen një sqarim i plotë për dokumentin me numër 153, të vitit 1407 që lidhet me një ankesë të Gjonit, të atit të Skënderbeut drejtuar Sinjorisë për të ruajtur disa famulli të Peshkopatës së Arbrit [...] :

« Dihet se Sh. Mëria e Ndërfandës në Gëziqin e sotëm, ishte një qendër e princave të Arbrit të shekullit XIII-XIV. Aty kemi gjetur mbishkrimin që flet për ta (shih në StH 3/1967, 131-158, ku e botojmë atë mbishkrim) ». (f. 38).

Këtu është rasti të riflitet për zbulimin shumë të rëndësishëm të tij në Mirditë, kur shkoi të punonte në bazë. Si ndodhi që « aristokrati » i letrave shqipe, me studime franceze zgjodhi një vend të largët dhe mbase të pazhvilluar për kohën ? Sigurisht, formimi i tij kulturor kërkonte që ai të shkonte në një zonë të panjohur për të. Ai arriti t'i zbulonte mbishkrimet mesjetare mes gurëve të një kishe të rrënuar, se ishte përherë në kërkim të gjurmëve të asaj periudhe që ishte e mjegulluar edhe për shumë vende të zhvilluara të Europës. Dija e gjerë dhe kureshtja shkencore, bashkoheshin me frymën atdhetare që dallonte të gjitha punët e Shuteriqit e që i dhanë frytet e veta edhe me disa punime të rralla për historinë e shtetit të Arbrit dhe të Aranitëve si dhe për historinë e lëvizjeve kulturore-fetare dhe herezinë mesjetare shqiptare, ashtu siç e thekson edhe historiani Pëllumb Xhufi. Studime të tilla janë themelore për kulturën dhe historinë.

207 : 1413-14. [...] Ka autorë që mohojnë vajtjen e Skënderbeut peng që fëmijë. Midis tyre Pastor, Hist. e papëve, bot. fr. 1888, II 399, shkruan : « krejt në të kundërtën, Skënderbeu e kaloi gjithë rininë e tij në malet e vendit të vet » (Jireacek, GB 368, sipas Noli 97, sh.88. Dhe veçanërisht Noli, në HS të tij anglisht të vitit 1947, 29. [...]. (f.49).

Në dokumentin e mësipërm, autori sjell shembuj të ndryshëm për një problem të pandriçuar mirë deri atëherë, lidhur me jetën e Skënderbeut.

271 : 1420, 25. II. Letër përcjellëse, dhënë nga Gjon Kastrioti tregtarëve venedikas që vinë në skelën e tij, [...] Thalloszy-Jireacek, Zwei Urkund, 146. Vendi ku u bë kjo shkresë nuk shënohet.

Sqarimi i mëtejshëm i Shuteriqit : Gjoni zotohet në emrin e tij e të djemve, të cilët duhet t'i ketë në shtëpi. (f. 62).

428 : 1437, 8. VI. Sipas kronistëve osmanë, këtë vit shqiptarët u hodhën në kryengritje [...].

443 :1438. Theodhor Korona Muzaka, në kryengitje që nga viti i kaluar... ; ai u thye nga Turhan Pasha, i cili erdhi me një fuqi të madhe... Myzeqeja u rrënu. Turqit bënë një piramidë me kokat e shqiptarëve të vrarë. Ata vranë të pesë djemtë e Vlash Muzakës, të cilëve ua thyen kockat me çekan. Biemmi 236. Hopf, Chron. 286. Gegaj 52-3. HShq. I 248, bot. Prishtinë. (f.101).

499 : 1443, 3. XI. Huniadi i mundi turqit në Nish. Është koha kur Skënderbeu e braktis kampin turk. Hammer, bot. fr. XVII 286, jep si datë të arratisjes së tij 10 nëntorin.

500 : 1443, 28. XI. Skënderbeu « u shpall zot i principatës së pavarur të Kastriotëve... », HShq. I 274...

Në vitin 1443, në defterin e Sanxhakut të Arbërisë 835H, mungojnë ndryshimet...Kjo tregon se në Shqipëri shumica e krahinave ishin të lira... Pra, Skënderbeu e gjeti të

¹ Studimi krahasues është një shqyrtim që vë përballë dy ose më shumë dokumnte ose vepra për të përcaktuar pikat e ngjashme ose ndryshimet. Në ditët tona ai është shkencë më vete në letërsi, por ushtrohet në çdo fushë të shkencës, në filozofi, në histori dhe në studime shoqërore.

përgatitur vendin mirë për aksionin e tij.

510 : 1444, 2. III. U mblodh Kuvendi i Lezhës.

Shuteriqi krijon një narracion historik dhe e bën tekstin sa më konkret për të realizuar qëllimin e veprës së tij : të transmetojë sa më saktë e rrjedhshëm ngjarjet përmes dokumenteve e citimeve burimore :

Barleti shkruan se në Kuvend morën pjesë : Gjergj Araniti, Andrea Topia, Nikollë Dukagjini (të tre kishin qenë në ballë të kryengritjeve të viteve ’30). Andrea kishte me vete dhe të birin, Kominin. Nga Dukagjinët ishte edhe Pali (Nikolla kishte marrë një vajzë të Aranitit) ... Në Kuvend ishte Gjergj Strez Balsha (nip i Skënderbeut nga një motër). Aty ishte edhe Stefan cërnoviçi i Malit të zi (të cilit Skënderbeu i pati dhënë një motër). Nga Veriu ishin gjithashtu Lekë Zaharia, Pjetër Spani (me të katër djemtë e tij, Aleksin, Bozhidarin, Vruon e Mirkon), Lekë e Pjetër Dushmani (bashkë me fisnikë fqinjë të tyre). Nga Jugu, Theodhor Korona Muzaka i Beratit. ...

Mbi Kuvendin e Lezhës flet edhe Muzaka (Hopf, Chron. 274-5 ; pas tij edhe Frëngu, bot. 1539, 8. Lavardini, bot. 1597, 37, shkruan se atje Skënderbeu u zgjodh mbret i Shqipërisë (Scanderbege esleu roy d’Albanie) ... Cuniberti 35 e vendos mbajtjen e Kuvendit në pranverë 1444. Cvetovka, *La bataille des peuples*, Sofje, 1971, 293, thotë se aty morën pjesë përveç Cërnojeviçit të Malit të Zi « edhe përfaqësues të komuneve të lira serbe, zëdhënese të vullnetit të popullor ». [...]». (f. 116, 117, 118).

518 : 1444, verë : Skënderbeu thyen të parën ushtri turke që sulltan Murati II dërgoi kundër tij (f. 119).

Ka pra, një besimtari patriotike në punën e Shuteriqit si arkitekt i një libri që pas shumë vitesh pune për grumbullimin e lëndës, ka kërkuar zotësinë e tij edhe për ta ndërtuar atë që sot mund të krahasohet me një katedrale.

545 : 1445, 10. X. Beteja e Mokrenës. Ekspedita turke që dërgoi Murati kundër Shqipërisë, ... ishin 9000 vetë, këmbësorë dhe kalorës. Skënderbeu ua kishte vënë pritën në « një luginë të ngushtë... e që ishte e vetmja rrugë kalimi për barbarin »: Barleti, Biemmi, Cutolo, Gegaj, Noli. (f. 129).

Në tekst, ashtu si e kemi thënë, herë pas here ka edhe dokumente të tjera të kohës, që autori i ka hasur gjatë kërkimeve për atë periudhë, si :


552 : 1446, përpara. Një anonim Grek, në një panegjeric mbi Manuel dhe Jani Paleologun VIII, i quan shqiptarët ilirë. « Tani i gjithë ai vend (Epiri) banohet në grupe të vegjël nga arbëreshët, popullsi ilire. Kjo popullsi është nomade dhe bën jetën e mjeruar ». Bozhori, BTB 318 (f.131).

634 : 1450, V. Rrethimi i parë i Krujës. (f.155).

Për këtë ngjarje flitet në shumë kronika të epokës si dhe në studime e libra dhe autori bën një përmbledhje duke përmendur : Kemal, Saddedin, Neshri, Sollakzade, Halkokondila, Kritobuli dhe kuptohet Barleti me librin e tij, Biemmi, Stefano Magno, Fallmerayer, Noli gjithashtu me *Historia e Skënderbeut* (1947), Marinesco, Cutolo, Gegaj dhe të tjerë. « ...

Sulltani që « të nesërmen » i dërgoi Vranakontit, mbrojtësit të Krujës lajmëtarë që të dorëzonte qytetin, duke i premtuar se mund të largohej i lirë bashkë me rojen e me gjithë sendet, duke i falur edhe 200 mijë aspra...Vranakonti nuk pranoi...Krujën, sipas Barletit, Skënderbeu e boshatisi me kohë nga njerëzit... Ai la atje 2 mijë burra për të mbrojtur qytetin. Midis tyre kishte italianë, gjermanë, francezë...

Skënderbeu qëndroi jashtë kështjellës, me rreth 8 mijë, midis të cilëve shumë kalorës. Ai veproi sidomos që nga Mali i Tushemishtit (sot Mali i Skënderbeut) ... duke e sulmuar armikun në befasi... Si



komandantë Skënderbeu kishte me vete Mojsiun...Tanush Topinë...dhe Gjergj Strezin (Balsha).

Turqit kishin 160 mijë ushtarë...e mbajtën të rrethuar Kështjellën rreth pesë muaj dhe pastaj u tërhoqën...sipas Jireacek, GS II 193, « Skëndrebeu u bë një nga burrat më të famshëm të kohës ».

Halkokondila (Bozhori, BB 55-7) i kushton vëmendje Rrethimit të Parë të Krujës... « Shqiptarët treguan një rezistencë që nuk shprehej » ... Huniadi e mori vesh lajmin nga Gjergj Brankoviçi ... Fallmerayer shkroi se me Rrethimin e parë të Krujës « mbaronte akti i parë i dramës së madhe shqiptare ». (f.155, 156, 157, 158).

Libri *Moti i Madh* ngjan si një rrëfim mes zhurmave e flakëve të një lufte të tmerrshme. Aty ndihet fuqia e shkrimit që sjell të gjallë kohën dhe ngjarjet si mjet shpëtimtar kundër harresës.

655 : 1451 fillim. Murati i dytë (ai vdiq në shkurt) qorron Stefanin, të birin e Gjergj Brankoviçit, me gjithë një vëlla të Stefanit. Babinger, Ende Aranit, 33.

Murati i kishte ata kunetër, duke pasur për grua motrën e tyre Marën. (f.164).

663 : 1451, 26. III. Traktati i Alfonsit V me Skënderbeun, i nënshkruar në Gaeta... (f.166, 167, 168).

Komenti : Me traktatin me Alfonsin, Skënderbeu bëri vërtet « një hap taktik ». Ai angazhoi kështu për luftën kundër turqve, përkrah tij, një fuqi të madhe.

670 : 1451, 23. V. Alfonsi i shkruan Skënderbeut, se po i dërgon 100 këmbësorë dhe 2 oficerë. Skënderbeu quhet i « madhnueshëm », « zot i Krujës, i devotshmi ynë i dashur ». Radoniç 45, Shih edhe Marinesco 46-7, sh 3.

Korrespondenca midis dy palëve është shpeshuar pas nënshkrimit të Traktatit të Gaetës. (f.170)

677 : 1451. Kritobuli i Imbrosit, në « Historia e Mehmetit II », shqiptarët i quan vazhdimisht ilirë. (f.173).

689 : 1451-69. Garnizoni aragonez qëndroi në Krujë gjer pas vitit 1468. Noli, Sc 49 (f.175).

705 : 1452, 21. VII. U zhvillua beteja e Modricës, sipas Biemmi 293-4, që pranon HShq. I 296. Turqit u thyen...

735 : 1453, 29. V. Mehmeti II merr Kostantinopolin ; Hammer, bot. fr. XVII 262.

Mehmeti donte ta tejkalonteAleksandrin e Madh, ta bënte Stambollin qendër të një monarkie universale, të vetme. Ai marshoi drejt Lindjes, ky drejt Perëndimit. Babinger, Maometto 608-9. (f.187).

Kur autori ka zbuluar dokumente të reja, i emërton ato me shkronja alfabeti pas numrit përkatës, Për shembull :

740 : 1453,18. IX. Senati i Venedikut i shkruan Skënderbeut. Janë të kënaqur nga çfarë u shkruan konti i Shkodrës...

740/a : 1453, 25. IX. Pal Gazulli e Theodor Jafet-i, ambasadorë të Skënderbeut, janë në Raguzë....

740/b : 1453, 30. IX. Papa lëshon një bulë për kryqëzatë kundër turqve...

740/c : 1453. (f.189).

763 : 1454, 14. VI. Alfonsi dërgon në

Shqipëri « këshilltarin e mëkëmbësin » e tij, Ramon de Ortafa... Letra i drejtohet « të madhnueshmit e të fortit burrë Gjergj Kastriotit, i quajtur Skënderbe... » (f.194).

798 : 1455, 26. VII, Shqiptarët u thyen keq nga turqit në Berat. Barleti shkruan gjatë për këtë në Lib. VIII të HS 323-52.

Personazhet historike i kanë dhënë formë dhe emër çdo kohe. Këtu autori bën një ndërhyrje të gjatë rreth katër faqe, pa iu larguar burimit, ashtu si ndodh në raste të tjera. Disa dokumente janë të kohës kur u zhvillua ngjarja. Ai analizon elementet e tyre të përbashkëta dhe mospajtimet :

Në faqen 208 lexojmë : HShq. I 277, bot. Prishtinë, vë re se, pas disfatës së Beratit « Alfonsi hoqi dorë përfundimisht nga ndihma ushtarake. Venediku « gjeti » rastin për të eliminuar Skënderbeun « duke kujtuar se tashmë i erdhi fundi rezistencës shqiptare » (edhe Ragua e gjente situatën të humbur), Hopf. Griech. II 134. Venedikasin « vrapuan të merrreshin vesh me turqit ose të siguronin strehim për feudalët shqiptarë, që u prishën me Skënderbeun... (f.204-208).

Përsëri dokumenti më poshtë që ka lidhje me ngjarjen e kobshme të Beratit, është sintezë e shumë burimeve të shkruara në atë kohë dhe më vonë.

799: 1455, VII. Duke lënë turqit të kalonin kufirin nga Dibra dhe të vinin të shpëtonin Beratin, ku ishte rrethuar garnizoni i tyre. Mojsi Golemi e tradhtoi Skënderbeun...

Marinesco 101, thotë se : Venediku i nxiste zotërit shqiptarëe, që të ngrinin krye kundër Skënderbeut ... (f. 209, 9).

Në disa dokumente, Skënderbeu del njëkohësisht strateg lufte dhe politikan, ndaj autori kujdeset që në paraqitjen e dokumenteve të tilla, pavarësisht nga shkurtimet e domosdoshme, të ruhet ideja.

830 : 1456, 8. IV. Skënderbeu që nga Lezha, i shkruan kardinalit të Fermos... Vetën e quan « dominus in Albania ». Turku, « thonë » se është « duke u derdhur me 14 mijë, ose kundër nesh, ose kundër Danubit ». Po të marrë rrugën drejt Danubit, shqiptarët do t'i bien pas shpine. Po të vijë këndej, shqiptarët do të rezistojnë. « Të gjithë e dinë se, sikur të hiqej dorë nga plani » (i një fushate kundër turqve, që kishte proklamuar papa një vit më parë 15. V. 1455), « kjo është e dëmshme për fenë e krishterë ». (f.216).

855 : 1456, 14-22. VII. Huniadi fiton betejën kundër turqve në Beograd. Hammer, bot. fr. XVII 268.

Huniadi do të vdiste pas një muaji. (f.225).

894 : 1457, 9. VI. Papa i dërgon Skënderbeut ndihmë 200 ushtarë, ushqime, armatime, duke premtuar dhe të tjera (që nuk i dërgoi). Ai ka marrë 2 letra nga Kastrioti. I shkruan : « Emri yt i lumtur është i përhapur në të gjithë popujt katolikë, për gjithë këto punë të mira që ke kryer për këtë fitore të shkëlqyer » ... (Rainaldi, Radoniç. Burime historike. (f.234).

898 : 1457, verë. Isak pasha dhe Hamza Kastrioti janë nisur kundër Skënderbeut, shkruan Barleti. ...U mundën turqit. Fjala është për betejën e Albulenës. Hamzai u kap.

Skënderbeu urdhëroi të mos e vrisnin, por e dërgoi në burg në Napoli). Piu II e ka ngritur shumë lart këtë fitore. Për këtë betejë flasin edhe kronistët osmanë. (f.237).

Autori sjell dokumente që tregojnë se Skënderbeu mendonte edhe për njerëzit e thjeshtë që përballeshin me luftën, jo vetëm për luftëtarët. Nuk janë të pakta rastet kur ai i kërkon sulltanit paqe për 3, 5, apo edhe 10 vjet.

1078 : 1462. 4. II. Në Raguzë merren vendime për pritjen e përcjelljen e Skënderbeut, si dhe për shpenzimet. Në dorë do t'i jepen një mijë perperë. Radoniç, 230. (f.280).

1087 : Skënderbeu blen grurë në Trani. Ducellier në Etudes Balk. 1/1978, 64, sh. 91... (f.284).

1204 : 1465. Barleti, HS 445-66 përshkruan të 3 ekspeditat që bëri kundër Shqipërisë turku më 1464-5.

Shuteriqi bën një përmbledhje : Pasi theu ushtrinë e Sheremet beut në afërsitë e Ohrit më 1464, vitin që erdhi ai theu edhe Ballaban pashën në Vajkal (në fushën e sotme të Bulqizës) dhe Jakub Arnautin në Kashar (Tiranë) ; Jakubi u vra...

Kur Mehmeti II mori Kostandiopolin, Ballabani ishte ngjitur i pari në muret e kishte hyrë brenda... (f. 312,3,4,5).

1247, 1466, verë. U zhvillua fushata e madhe e Mehmetit II kundër Shqipërisë, duke rrethuar Krujën e duke ndërtuar kështjellën e Elbasanit. [...]

Këtu autori bën një panoramë të situatës : Barleti shkruan se Mehmeti vuri njerëz që ta zhduknin Skënderbeun me helm ose me hekur...Krujën e mbronin shqiptarë dhe italianë... Rrethimin ia bëri Ballabani. Skënderbeu sulmonte çdo ditë nga jashtë kampin e sulltanit. Mehmeti duke parë se po kishte humbje të mëdha, vendosi të largohej për Bizant e la aty Ballabanin...

Skënderbeu u nis për Romë për të kërkuar ndihma. Ndihamat qenë aq të vogla, gjë që « nuk mund të zihet në gojë pa u skuqur çdo i krishterë nga turpi », shkruan një autor i kohës.

Dhimitër Frëngu, historiani tjetër i Skënderbeut, që ishte atë kohë (1466-7) arkëtar i tij, në kap.36 të veprës së tij, bot. 1539, shkruan se papa i dha Kastriotit « vetëm 3 mijë dukat » që iu doëzuan Dhimitrit vetë ; « Skënderbeu, i cili pak u turbullua nga kjo gjë (...) u kthye shëndoshë e mirë në vendin e vet » ... (f. 324,5).

1258 : 1466. Letër e sulltan Mehmetit II dërguar të birit, Bajazitit :« Të pafetë shqiptarë - zoti i shfarostë », shkruan sulltani, « kishin shpërthyer në kryengritje », duke « shkelur marrëveshjen » (e paqes që ai kishte me ta). [...] Një ndër komentet e Shuteriqit : Kjo letër e rrallë e Mehmetit, duhet të jetë e vitit 1466 dhe ndofta u dërgua nga Shqipëria... (f.330).

1312 : 1467, 1. V. Nga Baroli (Barleta), i shkruajnë mbretit të Napolit se Skënderbeu me 16 mijë vetë, gjendet në kampin e tij (duket pranë Lezhës) që përditë shtohet, se « shqiptarët rendin te ai (che li Albanesi concorreno a luy). Ballabani duke sulmuar... « u plagos vetë nga një ushtë në grykë (et epso farito da una lanzata ne la gola), prej së cilës vdiq ». Atij, « katër ditë më parë i ishte kapur i vëllai në një fshat dhe i kishin prerë kokën » (et decapitato). Pall, Rapportit it.-alb. 84. (f.344).

1354 : 1468, 17. I. Vdiq Skënderbeu i sëmurë fare pak ditë në Lezhë, me ethe. Autori jep disa ndryshorë me mospërputhjet e dokumenteve apo librave për vitin e vdekjes. [...] :I pari që e dha të saktë vitin e vdekjes së Skënderbeut, është autori bizantin Sfrances, që e vendosi në « janar 6976/1468 » (Bozhori, BB 108). Strances-i, bashkëkohës i heroit, jetoi në vitet 1401-78. [...] Sipas Frëngut, kap. 40, Skënderbeu vajti në Lezhë për nevoja të shtetit të tij dhe të Venedikut, që të shkatërrohej kështjella e

(*Vijon në faqen 10*)

(Mbi librin “Mbledhësi i mjegullave” të poetit Sami Velçani

Një dhembje nga toka për qiellin

Nga Dhimitër Pojanaku

I.

Bukur madje, fort bukur kjo gjetje “mbledhja e mjegulla”, po, përse i mbledh? Po prit njëherë se sikur po e nis nga fundi.

A nuk është një thagmë letrare metafora “mbledh mjegulla”?

A nuk mbetesh i habitur, gati i trullo-sur kur ndeshesh me këtë magji që shpik mendja njerëzore?!

“Mbledh mjegull” thotë poeti dhe na shtang që në fillim, sikur na vë të ecim mbi tokë si në filmat me magjira. Dhe kur e pyes nga e gjete këtë mrekulli ai hesht, gati me një heshtje olimpikë! Të isha unë do thërrisja nga gëzimi sa të zgjoja edhe pyjet më të fjetur. Do u vija një kurorë tekave e kapriçiove, edhe pse i kam me aq bollëk. Dhe kjo bëhet shkak të bëj një pyetje që ende më torturon nëse duhet ta bëj edhe nëqoftë një lajthitje mendore e çastit, pra sa të më mbetet merak për kushedi sa vjet përse nuk e thashë po e plas tani : A mundet metafora, meqë ngjizet në shpirtin e poetit, të na tregojë edhe portretin e Tij, ndoshta edhe karakterin ashtu si shprehja “çka zemra e tregojnë sytë?”

II.

Tani mund të kthehem tek pyetja si dhe përse i mbledh mjegullat, që unë u nxitova rrëmbimthi në fillim. I gjuan kur janë ende lehona në shtratet e luginave, kur brerojnë majat e maleve, kur trazojnë sjetullat e pyjeve?!

I mbledh mos mbulojnë diellin në një vend, i dend e i kthen në shi për toka të zhuritura? Po prit, prit, do thoni ju, këtë e kryen vetëm dora e Zotit! Po unë i përjetoj mirësitë nga dora e njeriut. Nuk ish mirësi dora e tim eti tek piqte bukë avuj të ngrohtë, e nëna e Vasës, që i jepte çdo fëmijë që i kalonte para portës mollë nga qilari, s’kanë mirësi doçkat e Asherit, pinjollit më të vogël të fisit Tim, tek të përkëdhelin? Nëse i mbledhim gjithë këto mirësi nga një mëhallë në tjetrën, nga një qytet në tjetrin, a nuk formojmë një dorë si ajo e Zotit mbi tokë?! Më kujtohet kur shkonim aksioneve, mbaj mend se kam mbledhur pambuk në Plug. Ndoshta tek i shihja grumbuj-grumbuj mund t’i krahësoja me re të bardha, se edhe unë kam shkruar që aher dhe më parë, por kurrësi nuk do më shkonte muza tek mbledhja e mjegullave.

Sa mistere paska bota e poetit, të jep ca fije ngjyra-ngjyra, e të thotë end në vegjë çfarë të duash: thurr një qilim fluturues e pushtot botën, nëse do pak vetmi, shtro një rrugicë ëndërrimtare në korridoret e shtëpisë, e nëse ke fantazi me tepri, ndërto një pallat të xhamtë me princa e dukeshatë, luaj atje komedi gazmore ose edhe ndonjë skenë makbethiane, bëj gjithçka që hyn e bindur në kornizat e jetës ose dil prej andej mospërfillëse e plot triumf.

III.

M’u bë sikur atë që do u thoja tani e kisha çikur pak më lart dhe u gëzova që nuk isha para një përsëritje që më duket se të shtërngojnë syrin si ca këpucë fringo të reja, që edhe pse na rrinë pak të vogëla, duam t’i veshim se s’bën! E meqë jemi tek këpucët, poeti na çudit përsëri, se “mbath e zbath këpucët e erës”!



Edhe pse e kisha kaq përballë këtë metaforë gati sa s’klitha: Bëj be, vërtet e ka thënë?! Si munda?! Dhe vërtet, si mundet poeti, që kur dëshiroka ja mbath dhe ja zbadh këpucët erës?! Ja heq këpucët kur e sheh që është lodhur duke u endur mbi kurrizet e botës?! Kur parandjen ndonjë stuhi rrëqethëse? Duhet të pyes poetin por mendja ma thotë se do jenë këpucë jo vetëm pa lidhësa por edhe pa numur. Po sikur t’ia kërkoja unë ato këpucë për një shëtitje nëpër atdhe, se kam qënë Manhattan e nuk kam parë magjinë e Valbonës, kam qënë Romë, Milano, e nuk kam parë Vermoshin?!

Qan era për këpucët si fëmijët kur duan të dalin jashtë edhe në suferinë?

Mendoj se nuk do jenë këpucë patinatore apo atletësh, me gjasë të shumta duhet të jenë si ato papucet e balerinave të thurrura me petale lulësh të bardha e vjollcë që i mban të freskëta shpirti krijues.

Ku do shkoja tjetër me këpucët e erës, që në mos m’i dhëntë poeti me dëshirë do bie në mëkat e do i’a vjedh veç për pak? Do e mendoj kur t’i kem...

IV

Mahnitjen që më sjell rënia e një ylli më sjellin edhe metaforat që sikur vijnë tek ne nga hapësirat ku banojnë muzat e poetëve.

“fjollat e tymit,/u japin qiejve dhembje”

Të jetë ky tymi i vatrave njerëzore? Atje ku drutë bëhen flakë e prej ndonjë dhembje të thellë flaka bëhet tym?!

E zemë se qënka kështu po aher, përse poeti u çon këtë dhimbje qiejve?

Patjetër që edhe kjo ka shpjegim dhe nuk çënon aspak teorinë time se metaforat e poetit rrezatojnë mirësi universale.

Qiellit i duhen t’i përcjellë dikush një dhembje nga toka. Kjo do e zgjonte nga ajo gjumësi e thellë, nga indiferenca absolute. Do ja praronte më tepër kthjelltësinë.

Të jetë kjo poet?!

Dhe përsëri poeti veç më sheh e nuk flet. Sytë meditues thonë se t’i japësh dikujt një dhimbje për ta rizgjuar, një dhimbje nga toka si për ta shkundur e për të parë ç’bëhet mbi tokë, a nuk është kjo një mirësi?!

Mund të thosh se avionët i çojnë qiellit dhimbje, por jo!

Poeti kërkon një dhimbje të drejt-përdrejtë, që duke e përshkruar tej e tej, ta ndiejë, përjetojë. Dhimbjet njerëzore që mund të qëllojnë në aeroplan, janë si nën koracë, nuk prekin dot nervin e qiellit. Fjollat e tymit, po! Ato kanë magjinë që duke e përkëdhelur, t’i rrëfejnë dhimbjen.

V.

Metaforat në libër t’i rrëmbejnë sytë ashtu si grimcat e floririt rërës ndanë brigjeve të një lumi të pasur. Por metaforat e goditura, ashtu si sendet me burime drite, nuk duhen vështruar pa ua ndarë sytë për një kohë të gjatë.

Duhen parë kohë pas kohe, çka shton ëndjen.

Ndaj duhet të pushoj pak...

Berat – Pogradec.
Prill, 2018.

(Vijon nga faja 9)

rindërtuar në Valmi : « Scanderbeg venne in Alessio per certi bisogni del stato suo et... ». Pastaj vjen komenti i Shuteriqit : Si arkëtar i Kastriotit, Frëngu duhet të qenë mirë i informuar atë kohë dhe ka të ngjarë të ketë qenë pranë tij, kur heroi vdiq.

Duke qenë edhe sjellës i dokumenteve që i shtohen kulturës shqipe dhe historisë së saj, Shuteriqi shkruan : Këto kohët e fundit është bërë i njohur humanisti prej Kotorrit të Dalmacisë, Martin Segoni, cili ka lënë një jetëshkrim fare të shkurtër të Skënderbeut dhe disa tekste me interes të veçantë për kohën. Segoni jetoi në Kosovë, u doktorua në Padova më 1475, kur atje jetonte Beçikemi dhe me sa duket edhe Barleti... Për ne, ka shumë të ngjarë që Segoni të ishte shqiptar (f.357, 8, 9, 360).

1383 : 1474, verë. Sipas autorit italian Gjergj Marula (1431-94), i cili shkroi një relacion mbi Rrethimin e Parë të Shkodrës nga turqit më 1474, duke u informuar nga të rraskapiturit shqiptarë që erdhën atje, turqit u dukën përpara Shkodrës në maj 1474.

1393 : 1476-8. Rrethimi i Katërt e i fundit i Krujës : Një ushtri e madhe erdhi atëherë në Shqipëri, e komanduar nga Ahmet bej Evrenosi. Krujën e mbronin forcat shqiptare dhe venedikase. Qyteti u dorëzua nga uria më 16. VI. 1478, me kusht që të rrethuarit të largoheshin lirisht. Sullltani

1401 : 1478-9. Rrethohet për së dyti herë Shkodra dhe u dorëzohet turqve. Dokumenti më i rëndësishëm mbi këtë rrethim është libri i vogël i Barletit, i botuar në Venedik më 1504, në janar, « De obsidione Scodrensi ». Shih bot. 2 shqip, përkth. H. Lacaj, Tiranë 1967.

Barleti shfrytëzon kujtimet e veta dhe të bashkëkohësve. Ai thaujse ka mbajtur një ditar të rregullt, me data fakte dhe imtësi. Vetë mori pjesë në mbrojtjen e qytetit, me sa duket si komandant ushtarak, megjithëse nuk ishte më shumë se 18-20 vjeç. [...] :

Më 14. V, nisi rrethimi. Më 15. VII. sulltani dha urdhër që të sillej pranë ledheve një sasi e madhe balistash e katapultash... Arkitekti i qytetit dhe komandanti i artillerisë, Danieli, kishte ngritur « nga të dy anët e qytetit » disa makina që i thyenin ato mjete sado të forta të armikut... Më 19. VII. Mbetën të vrarë kapedani i ushtarëve italianë, Frano Patavini, fisniku shkodran Llesh Begani, pastaj italian i Françesk de Santo Skorbaro, shqiptarët Nikollë Gradisklavi e Nikollë Begani, shkodranë... Përleshje e madhe që më më 19. VII. ...Sulltani, i tërbuar, dha

urdhër « të mos mbesë asnjë shkodran » ... Kur pa ai se qyteti nuk u muar, dha urdhër që të mos pushojë goditja me artileri. Pirgjet u rrafshuan përtokë. « U bë kërdi e madhe nga çdo anë dhe gropat u mbushën me gjak » ...Sulltani vendosi për një sulm « krejt të ri ». Ditën e hënës së re, 5 ditë pas betejës së fundit, turqit zunë t’i ngjiten kodrës. Hoxhallarët nisën të këndonin. Bartolemeu kontrolloi mirë qytetin bashkë me Nikollë Monetën, komandantin e kalorësve « shumë i zoti në artin ushtarak » shkodran (ky, sipas Barletit, HS 76, pati luftuar krah Skënderbeut e Lekë Dukagjinit më 1467, kur u vra Ballabani). Sulmi turk që i tmerrshëm... Qëndrim po aq burrror patën edhe gratë... pjesa më e madhe e ushtarëve përbëhej nga qytetarët dhe nga djelmoshat fshatarë ... U dalluan vëllezërit Jakob e Monçin Moneta, komandantë shkodranë... Thirrja ishte : « Mos i lëshoni në zgjedhë e në robëri familjet e atdheun tuaj ». Luftën Barleti e quan « lufta e drejtë » ... Komandanti Vlash Humoi (familje fisnike e njohur) u hodh mbi stom, kështu dhe i nipi i Jakob Monetës, Luka. Turqit u thyen. Sulltani humb çdo shpresë e jep urdhër për tërheqje. Ai ka lënë 30 mijë të vrarë... U vendos të merren kështjellat përreth. Por bombardimi i kalasë së Shkodrës do të vazhdonte...

Më 2. VIII u sulmua Zhabjaku... Më 27.VIII u pushtua Drishti i rrafshuar... Më 2. IX, 300 rob të zënë atje turqit erdhën e i therën në sy të të rrethuarve, nën muret e në Shkodër. Më 8. IX u nis kundër Lezhës pasha i Rumelisë ; qyteti u dogj ...Kishin vdekur 3 mijë vetë nga të rrethuarit e Shkodrës, ushtarë e popull... Flor Jonima u mbushi mendjen atyre që mbetën gjallë (rreth 1500) që të mërgohen e të mos qëndrojnë nën zgjedhë.

Dhe kështu « shkodranët lanë qytet e atdhe » (...) edhe thonë, - shkruan Barleti, i cili dëshmon në këtë mënyrë, tërthorazi, që nuk u tërhoq bashkë me popullin, - se ku me vela e ku me lopata, dolën (nga Buna) në det të hapët », derisa arritën në Venedik, pa u ndalur kundi. (f.372, 3, 4, 2).

Barleti e mbyll tregimin, shkruan autori, duke iu drejtuar dogut, të cilit i kushtoi veprën : « Për madhësinë e Venedikut ata (shkodranët) do të kalonin ditë të bardha e të gëzueshme » (...). Në fakt, komentoni Shuteriqi, kur shkruante historiani, fati i tyre ishte ende i vështirë, siç tregojnë dokumentet e kohës. Shumica vuanin. Dhe kjo ishte një arsye kryesore përse e shkroi Barleti veprën e tij mbi Shkodrën, që të tërhiqte vëmendjen e dogut vetë dhe



të autoriteteve venedikase mbi hallet e të rraskapiturve shqiptarë. Në parathënie ai shkruante : « Nuk mjafton t’ua qajmë hallin të vuajturve, po duhet edhe t’u japim dorën e t’u lehtësojmë vuajtjet... ». (375).

*

Teksti i Shuteriqit përfundon me dokumentin numër 1409, viti 1479, kur ra Shkodra, kështjella e fundit e qëndresë heroike të Shqiptarëve, dhe kështu me rënien e Shkodrës, ra krejt Shqipëria. Reja e zezë e pushtimit e errësoi horizontin anë e kënd viseve arbërore. Identiteti shqiptar i vuan ende pasojat e rënda të robërisë që zgjati thua jse pesë shekuj.

Pavarësisht nga kryengritja shqiptare e vitit 1481 me të cilën u bashkua edhe i biri i Gjergj Kastriotit, Gjoni, që shqiptarët e zgjodhën princ e udhëheqës të tyre (ata korrën një fitore kundër turqve dhe kapën të gjallë Sulejman Pashën që kishte rrethuar Shkodrën 3 vjet më parë), ushtria osmane, më e madhja e kohës, vazhdonte ta forconte rendin e saj në Shqipëri. Më 1485 Gjon Kastrioti u rikthye në Itali.

Duhet të ndalemi edhe njëherë te « Parathënia » e Shuteriqit, e cila është si një testament :

« Dhe ti, lexues, që do ta shfletosh këtë libër, në se do të ketë fatin të botohet ndonjëherë, më fal të metat, cilatdo qofshin, dhe mungesat. Ndërsa unë e di se je duke lexuar diçka « edifikuese », për ndërgjegjen e kombit. Do të më ndjesh pranë vetes, tek të pëshpëris :

E sheh se sa të egër kanë qenë bota me ne, sa të pabesë, sa të pafytyrë ? E sheh se sa të duruar kemi qenë ne, sa të paepur ? E sheh sa i kemi dhuruar botës [...] ? (f.11).

*

Vepra e Shuteriqit mbetet si një gur i madh e i qëndrueshëm në ndërtesën e kulturës kombëtare.

Librin, që përbën një formë të veçantë ligjërimi shkrimor, autori e përgatiti për botim më 1993, por atëherë as bëhej fjalë që të botohej; elementë të së djathtës ekstreme shkruanin pareshtur kundër figurës së tij. Ka ndonjë gazetë që riboton edhe sot ndonjë nga ato shkrime, dhe ç’është e vërteta, ky gjest ka bërë gjithnjë efekt të kundërt, i ka sjellë shumë dëme personit që e ka shkruar.

Përmes thurimës me dokumente historike, dëgjohej edhe një thirrje patetike dhe dramatike njëkohësisht, e cila nxit, jo kërkim të kohës së humbur, por një apologji të historisë tragjike shqiptare për ta parë të ardhmen me optimizëm. Vetëm kështu vepra e brezave që sakrifikuan jetën për lirinë, transmetohet me përgjegjësi historike.

Në tekst shprehet në mënyrë metaforike edhe lëvizja shkrimore që niset nga fakti dhe hulumton brendësinë, ai tregon edhe një pasion duke paraqitur kështu unin e një shkrimtari të lidhur fort me fatet e atdheut. Prandaj, kjo vepër e Shuteriqit është një ndërmarrje e pakrahasueshme, që nuk mund të ketë imitatorë. Ai ka realizuar me këtë libër edhe një punë që lidhej me vertikalitetin e veprimtarisë së vet. Disa libra të tij janë libra jete ! Ai i ka mbajtur dorëshkrimet e tyre në duar deri në fund të jetës për t’i plotësuar sa më shumë. Kjo gjë ishte shndërruar në ligj të punës së tij.

Pasuria e tekstit lidhet, së pari, me punën e palodhur dhe ndriçuese që bënte përherë Shuteriqi. Por, origjinaliteti dhe veçanësia e tij qëndron te kërkimet e paepura rreth identitetit kombëtar. Libri i përgjigjet kredos së tij : që të jetë bindës dhe i përkryer në çdo punë. Para së gjithash, një tekst i tillë me dokumente dhe komentat mbetet një vepër e fuqishme, sepse hedh dritë mbi figurën më të madhe të historisë sonë, mbi Gjergj Kastriotin. Përveç interesit shkencor, teksti paraqet edhe një interes tjetër kapital për zhvillimin e mendimit të përparuar, sepse rreshtohet me veprat që ndikojnë për forcimin e ndërgjegjes kombëtare.

MBI GJENINË, DISTANCËN DHE VETMINË E KADARESE

Nga Dr. Skënder Karriqi

1-Momenti i Gjeniut.

Në një moment gjeniu ndien dhe përjeton talentin brenda vetes, si një Urdhër Hyjnor, për ta realizuar domosdoshmërisht atë. Kjo ndjesi dokumentohet që në antikitet me Hesiodin, si moment ceremonial i legjitimitit të së së drejtës për të rrëfyer. Përkundrejt Homerit, të cilit koha ia megjullon një ceremoni të tillë shugurimi, tek pasardhësi i tij didaktik kjo ndjesi letrarizohet për herë të parë në historinë e letërsisë në poemën “Teogonia”, pra prej vetë atij, Hesiodit nga Kuma, si një moment fatlum i përzgjedhjes prej Muzave hyjnore, pagëzimit prej tyre me një degë ulliri, për t’i frymëzuar një zë hyjnor, që të rrëfejë të vërtetat dhe gënjeshtat mbi hyjnitë dhe njerëzit. Mungesa e referencave për ceremoni të ngjashme, qoftë ndaj parakut Homer, qoftë ndaj rapsodëve të tjerë, bashkëkohës me të, apo pak më të vonë se ai, i jep të drejtën e origjinalit Hesiodit, i cili, ndër të tjera, subjektet homerike të Trojës do t’i shndërronte në komedi, sidomos me poemën e vogël komike “*Lufta e minjve dhe e bretkosave*”, të cilën studiuesit ia atribuojnë pikërisht atij, Hesiodit nga Kuma dhe shkollës së tij hesiodike. Kjo vetëdije legjitimuese mbi dhuntinë është realizimi maksimal, i përtejme, i sentencës parimore greko-antike : “Njeri, njih vetveten!”, gdhendur në muret e Orakullit të Delfit.

2-Dykuptimësia e mesazhit të Orakullit të Delfit.

Është i njohur fakti i dykuptimësisë së mesazheve të Orakullit të Delfit. Në këtë kuptim sentenca e mësipërme:“Njeri, njih vetveten!” lexohej prej njeriut të zakonshëm si një mesazh që duhet t’i kujtonte atij masën e kufizuar, për të hequr dorë nga aventurat e matjes me zotat. Në një mënyrë apo në një tjetër, në kulturat e qytetërimeve, në doktrinat e tyre fetare do të stimuloheshin dhe do të përhapeshin, duke u përfshirë edhe në libra me status hyjnor, si Bibla, rrëfime mbi aventurat e dështuara të njeriut, që deshi të matet me zotat, siç është rrëfimi mbi Kullën e Babelit, apo rrëfime të tjera mbi gara letrare e muzikore ndërmjet njerëzve dhe hyjnive, ku këta të fundit, në të gjitha rastet, dalin fitimtarë, madje hakmarrës të ashpër pas fitoreve ndaj njerëzve.

Ndryshe lexohej sentenca e mësipërme nga njerëzit me premisa gjeniale. Përtej kuptimit kufizues, ata e lexonin sentencën si thirrje për ta njohur përmasën e vet gjeniale pa paragjykime kufizuese, duke e përjetuar kumtin sentencial si një moment të mrekullueshëm të njohjes së gjeniut brenda vetes. Kështu në një buzë mbrëmjeje, apo në një moment tjetër të ditës, teksa ecnin në kërkim të fatit të tyre, qoftë edhe në ëndrrën mesazhsjellëse apo momente meditimesh, ata shihnin të gdhendur në muret e Orakullit fatthënës apo në eterin e ëndrrës, fatin e tyre të Gjeniut , duke e përjetuar këtë moment si moment zgjimi dhe kthjellimi, vetvetiu edhe distancimi. Në fakt ishte sentenca që testonte kalimtarët sipas masës së tyre.

3-Distancimi dhe vetmia i Gjeniut.

Pikërisht, në një moment të tillë gjeniu Kadare, pasi ndien dhe përjeton gjeninë brenda vetes, plot dhunti, i përzgjedhur hyjnorësisht, distancohet prej botës ku u gjend, sidomos ndaj urdhrit moral mbi të Mirën dhe të Keqen, duke e vendosur veten përtej atij momenti historik (sepse morali është kategori historike), në një hapësirë dhe



kohë amorale (aspak imorale). Kështu gjeniu ynë gjen mënyrën e përshtatshme për të realizuar Urdhrin Hyjnor, talentin, dhuntinë e vet. Por, në hapësirën dhe kohën amorale ku e vendos veten, gjeniu Kadare është i vetëm. Ai ka përpara një botë të kufizuar historike morale dhe politike, me të cilën është në konflikt dhe i keqkuptuar, madje i pakuptuar, i paragjykuar dhe shpeshherë i shenjestrar nga politika dhe shërbëtorët e saj. Ndërkohë, nga ana tjetër, në raport me këtë botë të tillë, ai do të ushtrojë talentin e vet për emetimin e mesazheve universale. Kështu funksionalizohet distanca e gjeniut Kadare, vetmia e tij, jo si një i braktisur, por si një i vetëdistancuar, në pozicion kontradiktor me botën historike morale, i keqkuptuar, madje i pakuptuar prej saj. Në këtë botë historike morale të tillë, Gjeniut Kadare i duhet të jetë besnik ndaj Urdhrit Hyjnor mbi talentin dhe dhuntinë e tij, për ta përmbushur këtë Urdhër dhe realizuar veten, por i duhet të jetë edhe një lojtar i shkathët në këtë botë të kufizuar morale dhe politike, me rregullat e së cilës ai do të luajë lojën më të vështirë të jetës së tij, tashmë jo virtuale: lojën e mbijetesës. Nëse ai, që nga koha dhe hapësira amorale ku e vendosi veten, do të dijë t’i përshtatet si një lojë botës historike morale dhe politike, e siguron mbijetesën, nëse jo, ai e ka humbur këtë lojë të ankthshme mbijetese. Është ankthi ekzistencial i Gjeniut në një botë të tillë, ku trimëria, përveç se është një kategori naive në vetvete, është edhe një qëndrim i rrezikshëm për veten, përkundrejt diktaturës djallëzore në marrëdhëniet dhe sjelljet me Gjeniun. Në këto rrethana Gjeniu Kadare nuk i druhet vdekjes fizike. Ankthi i tij nuk ka të bëjë me këtë lloj vdekjeje. Në të kundërt ankthi i tij ka të bëjë me frikën e mosrealizimit të talentit, dhuntisë, Urdhrit Dekretues Hyjnor.

4-Zgjidhje të Gjeniut.

Plot vuajtje në shkathtësi dhe mençuri, Gjeniu gjen zgjidhje shpëtimi. Ai vendos “t’i propozojë” një maskë korrigjuese diktatorit. E di që do të jetë përsëri i keqkuptuar, madje i pakuptuar, por të paktën nuk do të jetë në konflikt me vetë diktatorin, të cilit maska korrigjuese e propozuar nga Gjeniu do t’i pëlqejë dhe do t’i duket si portreti i njëmend i tij, pa asnjë mundësi refuzimi nga të tjerët, shërbëtorët...Kështu ai do të arrinte ta shndërronte në mbrojtësin e vet armikun e tij më të madh: vetë diktatorin. Edhe kësaj radhe atij do t’i vinin në ndihmë autorët antikë, të cilët shpeshherë, i zbukuronin portretet e tiranëve, si haraç që duhet ta paguanin në botën e kufizuar morale historike, ku u duhej të ushtronin talentin e vet. Sa për keqkuptimin apo më keq akoma, moskuptimin, do të kishte një moment sqarimi, me anën e një intervistë (me kritikë parisianë) apo me anën e sprovave eseistike mbi atelienë e shkrimtarit, ku ai mund të

sqarohej drejtpërdrejt. Një tjetër zgjidhje e Gjeniut do të ishte transferimi i subjekteve në periudha të mugta historike apo edhe në periudha më të afërta, historikisht të qarta, siç është periudha otomane, ende me shenja dhe pasoja të dukshme në shoqërinë bashkëkohore shqiptare. Përveçse kjo periudhë historike 500-vjeçare ofronte mundësinë e një portreti sa të veçantë, po aq universal të diktaturës shqiptare dhe diktatorit, ajo, më së shumti, do të ishte një alibi shpëtimi, e gjetur mjeshtërisht me një intuitë gjeniale, për të thënë të vërtetat mbi diktaturën dhe diktatorin, nëpërmjet figurës danteske të përgjimit dhe përndjekjes së njeriut deri në sferën subkoshiente të ëndrrave, ku njeriu në fakt, nuk mund të distancohet nga fajësia e vet e pafajshme.

5-Për një gjykim objektiv.

Për një gjykim objektiv duhet që mendimi kritik dhe kritika historike, para së gjithash, të njohin faktin e dyzimit të pashmangshëm të gjeniut (të vetëdistancuar në një botë amorale, përkundrejt një bote morale historike politike) dhe në përputhje me këtë referencë, të vlerësojnë qëndrimin e tij, mënyrën e lojës së tij të shkathët me botën morale historike dhe politike. Në këtë kuptim, gjeniu Kadare del prej këtij dyzimi i pastër dhe madhështor: si besnik ndaj Urdhrit Hyjnor dhe si lojtar i shkathët i lojës së mbijetesës për përmbushjen e këtij Urdhri. Kështu ndriçohet vetmia e gjeniut tonë Kadare, distanca e tij ndaj njerëzve, alergjia e tij ndaj tabuve morale, krupa ndaj hipokrizisë. Kështu kuptimësohet edhe mendimi për ta vendosur gjeniun tonë Kadare në një vendprehe me vete, si një figurë e kohës dhe hapësirës amorale, ku ai pati kushtet e lirisë për të thënë të vërtetat. Kështu gjeniu ynë Kadare shndërrohet në një universale, përtej hapësirës dhe kohës morale historike dhe politike, mbi të cilat ai ishte thirrur të triumfojë, siç triumfoi me shkëlqimin e Gjeniut.

6- Në fund.

Në periudhën e fundit të jetës Gjeniu Kadare, pasi artikulon si në një ritual hyjnor të përmbushjes së misionit, frazën lakonike: “I thashë të gjitha!”, si një figurë e gjithpërfshirjes (globale) të tematikës së veprës së vet letrare, duke lajmëruar se nuk do të shkruajë më, heq dorë nga distanca dhe vetmia, për ta kaluar këtë periudhë të fundit të jetës së tij mes njerëzve të thjeshtë, të cilëve, ashtu si Prometeu në fillim të herës, u dha dritë në terrin diktatorial, i mësoi të jenë krenarë, të lirë dhe të mençur, u dha zë dhe dinjitet në Evropë dhe Botë. Gjatë kësaj periudhe, përditshmërisht Gjeniu shihet në mjediset e kështjellës me emrin letrar “Juvenilja” (ndoshta si simbol i distancimit të tij të pakmëparshëm), i shoqëruar besnikërisht nga botuesi i mirënjohur Bujar Hudhri dhe në takim me miq të shumtë. Aty ai takohet përditë me njerëz të ndryshëm, nga të gjitha profesionet dhe nga të gjitha shtresat sociale, i ngazëllyer nga dashuria e tyre, me zemrën e mbushur plot. Ashtu, tokësor në mjediset e kështjellës “Juvenilja”, në kontakt të drejtpërdrejtë me njerëzit, ai përjeton së fundmi edhe çlirimin prej distancës, keqkuptimeve dhe moskuptimeve, i pajtuar plotësisht me njerëzit që e adhurojnë pa masë dhe pa kushte vetë atë, Gjeniun, dhe veprën e tij. Me siguri duhet të ketë patur edhe një moment apo shumë momente të tilla, kur ai, me peshën e mundimeve të Gjeniut dhe peshën e viteve mbi supe, e ka ndërjerë se nuk i përkiste më kësaj bote. Nëpërmjet një poezie, kohë më parë, u kish folur njerëzve për një ikje në vuajtje e sipër nga pengu tragjik i mosthënies, prej së cilës duhej të çlirohej sa më parë:

*I menduar gjer në çast të fundit
Nga mosthënia, nga pengu tragjik,
Një shenjë ndoshta të pakuptueshme
Do t’ju bëjë të gjithëve e do ik.*

Përpara ikjes përfundimtare në amëshim, Gjeniu ishte i qetë, i çliruar prej mosthënies dhe pengut tragjik, i adhuruar prej njerëzve si një Prometeu.

Libri “Rreth disa kryeveprave të letërsisë sonë” i autorit Anton Nikë Berisha është dëshmi dhe sublimim i punës shumëvjeçare e të përkushtuar të këtij studiuesi për t’i interpretuar e ndriçuar vlerat e disa prej veprave më të rëndësishme të letërsisë sonë në vijën vertikale, të cilat dëshmojnë për cilësinë dhe nivelin e ngritur të saj. Është vepra e vetme e këtij lloji e botuar deri me tani në botën tonë.

Përmes këtij libri voluminoz përmbushet një zbrazëti e deritanishme në studimin e letërsisë sonë dhe njohjen më të përafërt të disa nga veprat më kryesore poetike që janë krijuar në gjuhën tonë. Pra, janë zgjedhur veprat letrare poetike të autorëve të periudhave të ndryshme, duke përfshirë edhe ato të letërsisë gojore. Pra, Berisha i zgjodhi dhe i interpretoi ato vepra që sipas shijes dhe dijes së tij hyjnë në rrethin e kryeveprave të letërsisë sonë. Pra, në këtë libër autori u është qasur dhe i ka interpretuar ato vepra që dallohen “[...] si tekste poetike, si mënyra të lartësuar shtjelluese dhe si shumësi shprehëse dhe kuptimore...”.

Në *Fjalën paraprake* të librit autori shkruan se në qoftë se nisemi nga fakti tashmë i pranuar nga një varg studiuesish më të shquar botërorë se tekstin poetik e cilësojnë kuptimësi të shumta e të ndryshme ndonjëherë të pafund, atëherë mbështetesh në diçka mirëfilli të qenësishme, ndërsa t’i përcaktosh gjerat në tekstin e një veprave letrare poetike si mundësi e vetme, t’i sjellësh në një kuptimësi, domethënë ta sjellësh tekstin e tyre në një rrafsh që nuk i përket atij, të zhbësh atë. Për këtë arsye “[...] teksti i ndërtuar përmes gjuhës poetike ngërthen kuptime të shumta dhe nxit një komunikim shumëor që nuk ngjet vetëm te lexues të ndryshëm, po edhe tek i njëjti lexues në kohë dhe rrethana të ndryshme”.

Berisha thekson se veprat të cilave u është qasur dhe i ka interpretuar i çmon kryevepra, qoftë brenda krijimtarisë së autorit përkatës, qoftë të letërsisë sonë në përgjithësi. Pra, qëndrimi dhe përcaktimi i tij për këto kryevepra lidhet para së gjithash me vlerat poetike të teksteve të tyre e jo për emrin e autorëve: “Mund të ndodhë që për dikë që ndonjë nga veprat që në interpretimin tim përligjen si kryevepra, për atë të mos jenë të tilla. Kjo ndodhë ose për arsyeve të shijeve që i kanë studiuesit (edhe lexuesit), për përgatitjen profesionale ose lidhen me botën e tyre mendore dhe shpirtërore. Dikush në veprat letrare parapëlqen (dhe kërkon) dukuritë, tematikën, ndërmjetësimin e jo artin, pra në veprën letrare parapëlqejnë atë çka thuhet, e jo mënyrën si thuhet e shprehen ato”.

Libri “Rreth disa kryeveprave të letërsisë” i Anton Nikë Berisha është i konceptuar në dy pjesë, pjesa e parë: *Vepra në poezi* dhe pjesa e dytë: *Vepra në prozë*.

Poezia gojore e arbëreshëve të Italisë me vlera të mëdha

Në fillim të librit Anton Nikë Berisha ka vënë interpretimin e dy kryevepra të poezisë gojore: për rapsodinë e Pal Golemit dhe për lirikën gojore “U zu djali rrogë me ‘i vashë”, dy thesare poetike të poezisë sonë, e cila është përcjellë gojarisht shekuj me radhë para së të lindte letërsia e shkruar. Ky veprim nuk është i rastit: shumë shkrimtarë tanë të veprave të shkruara i hartuar ato duke u mbështetur edhe në traditën e pasur letrare që u përcoll gojarisht te shqiptarët nga kohë të lashta.

Duke folur për rapsodinë arbëreshe *Pal Golemi*, studiuesi Berisha thekson se poezia gojore e arbëreshëve të Italisë cilësohet me një sistem të ngritur e shumëor shprehës poetik e kuptimor. Që të bindemi për këtë nuk duhet mund i madh: mjafton të shfletohet cilido prej botimeve të deritashme të rëndësishme me poezi gojore arbëreshe ose dorëshkrimet e ndryshme siç është, fjala vjen, ai me rapsodi i Françesk Anton Santorit, ku janë disa nga variantet më të plota dhe artistikisht më të vlefshme të këtij lloji të

Anton Nikë Berisha, *Rreth disa kryeveprave të letërsisë sonë*. Botoi SHB “Faik Konica”, Prishtinë 2023

LIBËR QË DËSHMON STUDIMIN CILËSOR TË KRYEVEPRAVE TË LETËRSISË SONË

nga Mikel Gojani

krijimtarisë shpirtërore arbëreshe.

Rapsodia “Pal Golemi” është dëshmi e pandërmjetme e kësaj pasurie dhe e vlerave të mëdha artistike, për shumëçka të papërsëritshme, qoftë për strukturën tekstore, qoftë për mesazhin poetik dhe për shumësinë kuptimore. Këtë poezi gojore së pari e shënoi (e vuri në formën e shkruar) prifti arbëresh, Nilo Katalano, nga Munxifta (Mezzoiuso) e Sicilisë, të mbledhur para vitit 1693 dhe të gjetur në Fjalorthin e tij në dorëshkrim të shek. XVII “Lessico italiano albanese e albanese-italiano”. Pra, kjo rapsodi jo vetëm është dëshmia e parë e poezisë gojore arbëreshe, që na ka arritur në formë të shkruar, po ajo është një nga krijesat letrare më të ngritura poetike.

Edhe krijesa tjetër e letërsisë sonë gojore e interpretuar “U zu djali rrogë me ‘i vashë” cilësohet me vlera poetike të mëdha, që shpalosen me shkathtësi nga studiuesi Berisha.

“Këngët e Milosaut” – kryevepër poetike

Interpretimin e kryeveprave të letërsisë sonë të shkruar Berisha e nis me *Këngët e Milosaut* (1836) të Jeronim de Radës, që shënon kthesën kryesore të letërsisë sonë drejt të shprehurit modern poetik.

Duke e vlerësuar këtë kryevepër, Berisha shkruan: “Pra, një numër autorësh, sidomos të kohës sonë, në këtë vepër me strukturim modern shprehës poetik, me perceptim e shqiptim kompleks të botës e të dukurive të saj, të meditimeve e të ndjenjave, me ç’rast në rrafshin thelbësor bëhet një ndërlidhje e botës së brendshme të poetit së pari me botën arbëreshe e pastaj me atë të përgjithshme; vepër që shpreh fatkeqësinë dhe tragjikën e individit si genie, ku struktura tekstore tejte e ngjeshur i lë vend të ndjeshëm nëntekstit; ku ndërlidhjet, ballafaqimet dhe kundërvëniet bëhen njëkohësisht dhe në disa mënyra e rrafsh dhe ku, koha e hapësira, janë më tepër subjektive sesa konkrete (historike), kërkuan dhe morën në shqyrtim elemente që ishin tipike për vepra me shtjellim tradicional të objektit artistik e që nuk bënin qenësinë e

“Këngëve të Milosaut”.

Vargu i De Radës është artistikisht i ngritur dhe i veçantë, që ndodh edhe me mesazhet poetike, ku dëshmohet një aftësi e rrallë. De Rada kishte mësuar nga poezia gojore arbëreshe, e cila dallohet për pasurinë e të shprehurit poetik dhe për komunikimin e veçantë që nxit, siç ndodh, fjala vjen, në (Kangjelit VIII):

Mniz e vërës bardhulóre
biu një re monosáqe
për ndë mest gurévet:
kan ghare te shtrush’ i ljumit.
Pa një re malji me bor
i buthétónet njerézet;
ata ljúténjën të korrat.

Një kryevepër tjetër e letërsisë së shkruar të arbëreshëve të Italisë, të cilën e interpreton Berisha, është vepra e Françesk Anton Santorit “Il canzoniere albanese” (Këngëtorja arbëreshe), e cila shpreh “[...] dashurinë e lexuar në libra e jo të përjetuar nga ai, përligj përcaktimin se krijesa letrare artistike nuk është imitim i pandërmjetme i asaj që përjetësohet në jetën e përditshme, por fryt i mendimeve dhe i përsiatjeve që pastaj shndërrohen në veprën artistike, në tekst”.

Për hartimin e kësaj veprave Santori shfrytëzoi disa tradita letrare: atë gojore dhe të shkruar arbëreshe, traditën letrare evropiane, sidomos veprën e Petrarkës “Il canzoniere”, pastaj “Këngën e këngëve” të Biblës së Vjetër dhe vepra të letërsisë të kohës së tij. Ky poet arbëresh e hartoi këtë vepër në mënyrë që *përmes gjuhës arbëreshe - shqipe të përjetësohej dashuria si qenësi jete e mendimi, qoftë kur ajo është konkrete, qoftë shpirtërore dhe hyjnore*:

“Ti je zemër kuqulore
Vajzë që faqen mos e fsheh,
Të dashurt si nëng e njeh?
Çë vetë krahët gjelbjlore
me buthton e disheron
Se te glanj, e ngë ndërron
Ma hadhi lipin njinjë (Odhi e I).

Ciklin e kryeveprave të letërsisë arbëreshe, studiuesi Berisha e përmbyll me veprën me titull: “Te dheu i huaj”, një vepër poetike me vlera të mëdha e të shumta.

Në vijim janë interpretimet e veprave “Andrra e jetës” e Ndre Mjedës dhe “Jerina ase Mbretnesha e luleve” e atë Gjergj Fishtës, ku autori ndriçon botën e pasur dhe vlerat kryesore poetike.

Sipas autorit “Andrra e jetës” është fryt i një konceptimi dhe përfytyrimi të veçantë poetik; fryt i një aftësie e përkushtimi të madh krijues si edhe një dije e përvojë të pasur”. Në të Mjeda përligj në mënyrë të mirëfilltë e të plotë konceptin e tij për artin në përgjithësi dhe për poezinë në veçanti”.

Ndërkaq duke ndriçuar vlerat e veprës së atë Gjergj Fishta “Jerina ase mbretnesha e luleve”, Berisha thekson se kjo vepër është më përfytyruesja, më imagjinativja që është shkruar nga Fishta, ku si objekt trajtimi poetik bëhet hijeshia - bukuria e luleve, përkatësisht bukuria e vashës Jerinë.



Kur, qe, i a behë si rrezja,
Jerina atëherë te dera,
E këndshme porsi shpresa,
E hijshme si prendvera...

Në vijim Berisha i interpreton veprat “Posta e porositur” (1964) të Mark Krasniqit, poezinë e Azem Shkreli, Mirko Gashit, Frederik Reshpjes, Ali Podrimjes, Ramadan Musliu, Prend Buzhalës, Sabit Rrustemit etj., të përfshira në përmbledhje me poezi të zgjedhura të bëra nga vetë Anton Nikë Berisha.

Arti i madh i veprave në prozë

Pjesën e dytë të librit *Rreth disa kryeveprave të letërsisë sonë* e bëjnë një varg interpretimesh të veprave të prozës sonë, ku autori me shkathtësi i ka vërejtur dhe i ka ndriçuar disa nga vlerat kryesore që i bëjnë ato kryevepra të letërsisë sonë të shkruar. Edhe në këto punime shpaloset sistemi i të shprehurit poetik, gjuha poetike dhe mundësia e ndikimit estetik. Kjo gjë vërehet në interpretimet që u bën veprave *Pasqyrat e Narçizit* (1936) të Koliqit, novelës “E madhe është gjëma e mëkatit” (2000) të Mitrush Kutelit, romaneve “Qyteti i fundit” (1960) të Petro Marko, “Lumi i vdekur” (1965) të Jakov Xoxe, prozës poetike “Dranja” (1881) të Martin Camajt, tregimit “Kulla” (1968) të Anton Pashkut, romaneve “Kronikë në gur” të Ismail Kadareës, “Ana Zh”, “Të gjallë dhe të vdekur” (2013) dhe “Kishim një ëndërr” 2016 të Nasi Lerës, “Shpendkeqja” të Ymer Shkreli, “Funerali i pafundmë” (2003) i Visar Zhitit etj.

Në vend të përfundimit


Vepra studimore “Rreth disa kryeveprave të letërsisë” e Anton Nikë Berishës është një libër që të tërheq jo vetëm me veprat dhe dukuritë që autori i ka trajtuar, por edhe për mënyrën dhe thellësinë e interpretimit të cilësive dhe të veçantive të tyre.

S’do mend se kjo vepër e Anton Nikë Berishës është fryt i punës dhe i përkushtimit shumëvjeçare. është një libër tepër i nevojshëm për studentë, për profesorë të universiteteve që letërsinë e mbajnë si lëndë mësimi dhe për studiues të letërsisë, pastaj për shkrimtarë dhe për të gjithë ata që duan të mësojnë për disa nga veprat më të rëndësishme të letërsisë sonë dhe për mënyrës se si ato mund të interpretohen, pa e mbyllur mundësinë e varianteve të tjera interpretuese, gjë që shkaktohet nga gjuha poetike dhe shumësia e kuptimeve që i cilëson fjalët në tekstin letrar të hartuar me përkushtim.

Mendoj se libri “Rreth disa kryeveprave të letërsisë sonë” mund të shërbejë edhe si model për qasjen dhe interpretimin edhe të veprave të tjera e të veçantive të tyre poetike shprehëse.

Në fund dua t’i shpreh mirënjohjen time studiuesit Anton Nikë Berishës për hartimin dhe botimin e këtij libri të rëndësishëm me vlera të shumta.

Korrik, 2024



Shkenca letrare është një labirint pasqyrash. Shkrimtari pasqyron jetën, studiuesi pasqyron shkrimtarin, një tjetër studiues pasqyron sivëllanë e vet.

Ndërkaq, nëse shkrimtari e pasqyron realitetin duke e shndërruar, studiuesi që e analizon atë synon drejt një objektiviteti sa më të lartë dhe të njëjtën gjë bën autori që shqyrton kritikën e kritikës. Tani po e vëmë veten në këtë rol të fundit duke thënë fjalën tonë, ashtu si mundim, për një studiues që analizon një autor bashkëkohës në një monografi të gjerë.

Roli ynë nuk është natyrisht ai i një gjykatësi, po më tepër i një dragomani që e çon studiuesin te lexuesi, ose i një deshifruesi të kodit shkencor të autorit që është vetë deshifruesi i kodit artistik të shkrimtarit.

Spiro Gjoni në monografinë “Udhëtimi letrar i Sazan Golikut” që vjen si kurorëzim pas disa veprash të tjera shkencore (monografi apo përmbledhje studimesh), “udhëton” në brendësi të botës së një autori bashkëkohës, Sazan Golikut alias Pandeli Koçit, rreket për të depërtuar në poetikën e këtij autori, në fijet e çuditshme që e lidhin mesazhin me formën dhe i japin jetë.

Një tipar me të vërtetë i veçantë që kapet nga studiuesi është *shumëllojshmëria*, një shumëllojshmëri gjinish dhe llojesh ku mbizotërojnë llojet e shkurtra si skica dhe parabola që janë të parapëlqyerat e shkrimtarit dhe gur prove për talentin e tij. Larmia tipologjike në veprën e Koçit është tepër e madhe, kalohet vazhdimisht nga proza te poezia, nga poezia për të rritur te poezia për fëmijë. Shkrimtari e provon talentin e vet, ndonëse më rrallë, edhe në llojin e novelës dhe në një rast të vetëm, në atë të romanit. Në të dyja llojet shënon arritje.

Edhe tematika dhe problematika dallohen për një gjerësi të veçantë që s’e përfshijon thellësinë, një gjerësi që shtrihet në dy rrafshë, në histori e në gjeografi.

Studiuesi vë re një konstante në krijimtarinë e Golikut, një vatrë të ndezur që e ndriçon tërë krijimtarinë, temën e *lirisë*. Kjo temë shtjellohet, qoftë në plan patriotik, qoftë në plan social dhe etik. Në këto dy plane të fundit vihet re një kushtëzim historik.

Spiro Gjoni e ka parasysh çështjen e angazhimit të detyruar që rëndonte mbi shkrimtarët në periudhën gjysëmshkulllore të diktaturës dhe rrezikonte lirinë e shprehjes dhe zhvillimin e lirë të individualiteteve krijuese.

Studiuesi Gjoni pohon me të drejtë se “liria kombëtare është e cinguar në vlerat e saj për aq kohë sa nuk shoqërohet me lirinë individuale dhe shoqërore” dhe kjo për Golikun është “e qartë dhe e kuptueshme”, prandaj, pas trajtimit të konfliktit të shqiptarëve me pushtuesit, ai e shtrin më tej nocionin e lirisë. Po, në kuptimin e vet të plotë, kjo temë do të mund të shtjellohej, siç ndodhi në fakt, vetëm në krijimet e Golikut të shkruara në periudhën e pasdiktaturës dhe që përfshihen në përmbledhjet “Aventurat e lirisë”, “Trekëndëshi i qiellit të zi”, “Aksion në shkumën e vaskës” dhe “Pas heshtjes”.

Format e reja të lirisë zbulohen dhe pasqyrohen te liria e të burgosurve në diktaturë, te pohimi i të drejtave universale për liri individuale. Goliku nënvizon studiuesi, nuk është për një liri kaotike, por për një liri të mendjes dhe të shpirtit që respekton lirinë e tjetrit.

Nënvizohet pra se tema e lirisë, e përhershme në shkrimet e Pandeli Koçit, gjeti shprehjen e vet të plotë dhe u bë shkak për një hop krijues në veprën e autorit vetëm në periudhën e pasdiktaturës që i solli një lulëzim të ri krijimesh në lloje të ndryshme, në krye të të cilave janë skicat dhe parabolat aq të dashura për të.

Një tjetër tipar që zbulohet me mprehtësi nga Spiro Gjoni, i cili përpiket të hyjë në brendësi të botës poetike të autorit është *paparashikueshmëria* e cila, sipas tij, e detyron gjithnjë studiuesin të korigjojë dhe plotësojë klasifikimet e veta.

Gjithashtu studiuesi vëren me mprehtësi një lloj dinamizmi që e ndjek Golikun, alias Koçin, në tërë krijimtarinë e vet më shumë se shtatëdhjetëvjeçare, një lloj “vrapi” të figurshëm që ka nisur qysh në rininë e vrrullshme të autorit dhe zgjat ende në pjekurinë e tij të vonshme që e ka ruajtur çuditërisht vrullin e rinisë, një aftësi e

Spiro Gjoni, *Udhëtimi letrar i Sazan Golikut*

UDHËTIM NË POETIKËN E NJË AUTORI BASHKËKOHËS

nga Prof. Dr. Klara Kodra

përhershme për të rinuar vetveten.

Pandeli Koçi, si nënvizon edhe studiuesi dhe kjo përbën një nga karakteristikat më të veçanta dhe të rëndësishme të krijimtarisë së tij, nuk rrezikohet nga ajo “ftohtësi” e pleqërisë që do të krijonte një shkëputje midis mesazhit dhe formës, duke parapëlqyer thellimin në mjetet teknike, formale, atë shkëputje së cilës iu tremb Mjeda kur e la përgjysëm poemthin “Scodra”, i cili kishte arritur vërtet një përsosmëri formale, po mund të humbiste lëngun e valë të frymëzimit, tharmin jetësor.

Për çudi, Sazan Goliku e ruan të paprekur atë tharm dhe e derdhi në krijimet e veta në poezi e në prozë. Për një “rini” shpirtërore mund të dëshmojë edhe fakti që Pandeli Koçi, edhe në moshë të vonë, i qëndron besnik poezisë.

Një tjetër tipar që zbulohet nga studiuesi Gjoni, të cilit Pandeli Koçi i qëndroi besnik deri në fund, është *fryma shqiptare* që dallon çdo krijim të tij, një tipar i rëndësishëm ky në kohën tonë, të prirur ndaj kozmopolitizmit, një tipar që vërteton rrënjët etnike të autorit, identitetin e tij kombëtar.

Gjithashtu, një veçori që e përshkon tërë krijimtarinë e Koçit, siç pohon studiuesi, është *autobiografizmi* që nis nga autobiografizmi naiv i skicave të para poetike për të vazhduar dhe për t’u thelluar në krijimet e viteve të pjekura.

Autobiografizmi do të paraqiste rrezikun e egocentrizmit. Po studiuesi nuk e zbulon asgjëkundi një kufizim të tillë. Autobiografizmi i Koçit është dëshmi singjeriteti dhe i jep ngrohtësi veprës së tij.

Një vatrë tjetër e ndezur në krijimtarinë e Golikut që vihet re nga studiuesi, krahas temës së *lirisë* është tema e *dashurisë* që trajtohet prej tij që nga periudha gjysëmshkulllore e diktaturës kur spostohej në plan të dytë në periudhën e sotme ku tema në fjalë ka gjetur vendin e vet. Studiuesi vë re me të drejtë, që poezitë me temën e dashurisë janë nga më të ndjerat e Pandeli Koçit dhe gërshetojnë mjeshtërisht elementët romantike me elementët realiste.

Gjithashtu vihet re që trajtimi i kësaj teme u qëndron larg skajshmërive, mbetet në caqet e një ekuilibri të shëndetshëm, për çka dëshmon lëvrimi nga ana e Golikut të një nënteme të trajtuar rrallë në poezinë erotike, nëntemës së dashurisë bashkëshortore, të cilën ai e lëvron në mënyrën e vet, të papërsëritshme.

Studiuesi synon të zgjidhë disa enigma

të krijimtarisë së Golikut. Një prej tyre, mjaft intriguese është parapëlqimi i tij ndaj poezisë dhe prozës. Spiro Gjoni arrin në konkluzionin se këto dy mënyra krijimtarie përbëjnë dy dashuri paralele për këtë autor, të cilave ai u qëndron besnik deri në fund.

Një enigmë tjetër është ajo nëse ky autor që e realizon plotësisht vetveten në poezinë dhe prozën për të rritur, arrin të realizohet gjithashtu në krijimtarinë për fëmijë. Kësaj enigme studiuesi i kushton një kapitull të veçantë “A është Sazan Goliku shkrimtar për fëmijë?” Studiuesi me të drejtë e thekson *literalitetin* e letërsisë për fëmijë, gabimisht e nënvlerësuar nga disa pseudostudiues që nuk e kuptojnë veçanësinë e saj, e sheh atë si *art të fjalës*, po aq, në mos më shumë se sa letërsia për të rritur.

Gjithashtu, Spiro Gjoni, kur analizon problemin, domethënë, përfshirjen e Pandeli Koçit në bashkësinë e autorëve për fëmijë, nuk mjaftohet me kriterin sasior (njëzet e tre veprat për fëmijë të botuara nga ky shkrimtar), po e përfshin kriterin cilësor dhe zbulon një tipar kuptimplotë në poezinë dhe prozën e tij të këtij lloji, aftësinë dhe mjeshtërinë e tij që të gjendet natyrshëm dhe të shkrihet me botën e fëmijëve, me dëshirat, interesat dhe përjetimet e tyre. Pranë këtij tipari nënvizon thjeshtësinë në komunikimin me të vegjëlit, duke përdorur “armët” e tyre.

Studiuesi ndalet në format zhanrore të zgjedhura nga Goliku dhe shpjegon shkaqet e kësaj përzgjedhjeje. Duke i shpjeguar ato arrin në një thënie sintetike që i ngjan një aforizme. “Çdo poezi e Sazanit është një përrallë dhe çdo përrallë e tij, bart dhe përcjell një frymë poetike”.

Kështu, në mënyrë të natyrshme, studiuesi arrin në përfundimin pohues të pyetjes së shtruar: “po, Sazan Goliku është edhe shkrimtar për fëmijë dhe një shkrimtar që e thotë fjalën e vet dhe komunikon me këtë publik tepër të veçantë dhe nazeqar”. (fjalët janë tonat).

Tre nga kapitujt më të realizuar të monografisë janë ato që i kushtohen tri veprave të veçanta të Pandeli Koçit, tri veprave që i përkasin prozës së gjatë, dy novela dhe një roman, i vetmi i shkruar prej tij, novela për të rritur “Zjarr dhe zjarr”, novela për fëmijë “Kërkimi” dhe romani për fëmijë “Komiteti e Malit të Bardhë”. Janë të tria vepra të pjekurisë së Sazan Golikut.

Studiuesi e quan romanin e vetëm të Pandeli Koçit si kulmin e krijimtarisë së tij, një vërejtje e guximshme kjo, po që ai përpiket ta

argumentojë. Kjo vërejtje dëshmon se Spiro Gjoni ka depërtuar në *thellësi*, jo vetëm në *shtrirje* të veprës së gjerë që analizon dhe që përbëhet prej shumë krijimesh në poezi e në prozë, po për çudi prej një romani të vetëm. Studiuesi Gjoni e sheh këtë vepër si kalimin e Golikut në një stad më të lartë krijues ku veçoritë e tij artistike lartësohen dhe fuqizohen.

Studiuesi analizon imtësisht tematikën dhe problematikën e këtij romani dhe përbërësit e ndryshëm originalë të formës së tij. E përkufizon në mënyrë të goditur si “roman aksioni” dhe përligj dinamizmin e ritmit të rrëfimit në këtë roman që nuk u lë shumë vend përshkrimeve, sheh vlerën estetike të tij edhe në aspektin kompozicional, strukturimin në dy shtylla kryesore që është me të vërtetë i përshtatshëm për lëndën romanore që përmban dhe origjinal, në konçizitetin e karakterizimit të personazheve të cilët ndriçohen edhe në rrafsh psikologjik, në “përshkrimet tepër mbresëlënëse të natyrës shqiptare” në figuracionin e pasur letrar.

Studiuesi vëren gjithashtu që ky roman i menduar për fëmijë dhe të rinj, në fakt i drejtohet lexuesit të të gjitha moshave.

Analiza shprehëse dhe të goditura janë edhe ato të dy novelave që e befasojnë lexuesin qysh në titull “Një zjarr i dyfishtë në mendjen dhe shpirtin ilir” dhe “Dashuria fillon në shtëpi”. E para karakterizohet jo vetëm nga zbehtërimi i brendisë dhe i formës (“Zjarr dhe zjarr”) por nga ndonjë debat i ndezur me ndonjë studiues tjetër, madje edhe me vetë autorin për të përcaktuar risinë tipologjike të kësaj novele që përkufizohet si novelë jotipike filozofike, po me elementë të novelës filozofike.

Në analizën e novelës së dytë “Kërkimi” që nuk bëhet në mënyrë të ftohtë, por me shumë entuziazëm dhe përkushtim, nënvizohet thelbi i saj, lartësimi i dashurisë në familje, i lidhjeve midis brezave që në atmosferën e sotme rrezikojnë të humbasin. Protagonisti është një hero i dashurisë birmore, konkretisht i dashurisë për të atin, që të sjell ndërmend një personazh tjetër të paharrueshëm, Markun e romanit “Zemra”, hero të dashurisë për të ëmën.

Mihali, protagonist i kësaj novele, është katërmëdhjetëvjeçar kur nisat në kërkim të të atit, të internuar nga pushtuesit fashistë. Ai luan në novelë edhe rolin e rrëfyesit të ngjarjeve që shihen në optikën e veçantë të një adoleshenti. Novela, pra, ka një problematikë si social-politike ashtu edhe etike, ka një temë të patrajtuar në letërsinë tonë për fëmijë, çka nënvizohet nga studiuesi Gjoni.

Kapitulli i fundit i monografisë zbulon një aspekt të panjohur të Golikut, e sheh atë si kritik, jo si një kritik profesionist, por më tepër si një shkrimtar që shkruan për sivëllezërit me ndieshmërinë karakteristike të shkrimtarit, që shkruan recensione dhe artikuj dhe madje në një rast ngrihet në nivelin e trajtimit të problemeve teorike. Studiuesi i quan si të arrira shkrimet e tij kritike, duke vënë re që Pandeli Koçi përqendrohet te evidencimi i vlerave për shkrimtarët që analizon.

Po rimarrim tani një shprehje të studiuesit që kemi analizuar dhe po themi “tani që i erdhi fundi udhëtimit tonë”, në “Udhëtimin letrar të Sazan Golikut” (diçka e veçantë: një udhëtim brenda një udhëtimit tjetër!), mund të pohojmë se kjo monografi ka një nivel shkencor dinjitoz, është shkruar me ngrohtësi dhe pasion, me një gjuhë sa shkencore, ashtu edhe të thjeshtë e të qartë, me një stil dinamik, që komunikon me lexuesin.

Edhe nëse ka ndonjë pohim të diskutueshëm, në tërësi studimi është mbështetur në një njohje të mirë të krijimeve të analizuara dhe të kritikave të shkruara për to, autori nuk bie, as në entuziazëm të tepruar, as në qëndrime nihiliste, ruan një drejtpeshim të mbështetur në argumente logjike solide, çka është tepër e rëndësishme për çdo punim shkencor.

Gjithashtu, siç e thamë edhe më lart, monografia zotëron një forcë komunikuese në saje të së cilës, pavarësisht nga ndonjë zgjatje, nuk bëhet kurrë e lodhshme, as e mërzitshme, po mbetet plot tharm jete, si autori i analizuar.



... një

flamurin e lëmë jashtë
në erë e në shi
vetë flemë brenda
mbuluar me jorgan të trashë
kur grisët apo vidhet
vendosim një të ri

...

vdiq
do të vdiste një ditë
megjithatë s'e prisnim
asnjë s'u kujdes t'i bënte varrimin
shpenzimet i mori përsipër bashkia
kush vdiq?
dashuria

...

dhe vdekja është farë
mbin poshtë në zgafellat e nëndheshme
është lulëzim i përmbysur
kopsht krimb mëndafshi
pemë kafshë ujë flutura
pezull mbi humnera
e keni parë diellin kur perëndon
atje shkon të lindë
e keni parë hënën si zhduket në agullimë
zbret atje të lëshojë kandilin
ne presim pa shpresë
megjithatë presim se s'na lë instinkti
askush nuk kthehet më
as nënat

...

sfilatë mode në nju jork
në pasarela kelvin klej, guci, versaçe, klo..
kam një ide gjeniale në kokë
kopjuar nga ludvig van bethoven
të marr një pemë përkrahu
veshur me fustan prej ari
në pasarelë ta çoj
të konkuroj pradan, valentinon, eskadan..
jam i bindur
jo modelja, po pema
do të fitonte çmimin e madh

...

dy

...

një gjilpërë në rërë me një fill peri
s'ia ka dalë dot të lidhë guaskat për të
gjetur perlën
një gjilpërë në rërë me një fill peri
në perëndim të diellit
ndajnatën merr për ta qepur me mëngjesin
një gjilpërë në rërë me një fill peri
vajzat toples me tanga pothuaj s'duan qepje
as kaosi, as recesioni, as depresioni
s'kanë nevojë për gjilpërën me një fill peri
qepja ka hedhur stapin në sup dhe shtegton
nga një vend në tjetrin kërkon punë si
qepës
po vendet janë zënë nga miliona shqepës
që shqepin e shqepin për një milion vjet
një gjilpërë në rërë me një fill peri

...

sa u zgjove ti
qepalla cep më cep prej groenlandës me
akuj në detet e ngrohtë të jugut u hap
qerpiku yt trandi bursat, krisi diçka ne
fasadën e exchange
luani në safari kishte kohën e dashurisë
dhe të dyluftimit me rivalin e vet që ishte i
biri që e mundi
u nisën trenat e mëngjesit prej një shenje të
thithkës tënde bojë manushaqe
vargani i trakeve shkundi me rrapëllimë
autostradën mbushur përplot me apple
avionët u ngritën plot me pasagjerë dhe
armë
vetëm prej një gjesti që bëre me vetullat si
hark
aty kupidi ishte bin ladeni
botës donte t'i vinte flakën
ta marroste me viagër
sa u zgjove ti
bota ishte e seksit femër
pastaj u bë e seksit mashkull
kur lufta filloi, paraja qarkulloi, bashkimi



europian u mblodh, amerika dha ndihma,
të mëdhenjtë u menduan; luftë apo paqe
manjatët e armëve u shkelën syrin
iv montan hapi fizarmonikën dhe këndoi
gjethet e vdekura
zhak prever me cigare në buzë tha se
poezia ishte kurvickë ne sheshin konkord
gjithmonë katërmbëdhjetë
poetët janë pedofilë të poezisë
katërmbëdhjetë dhe për këtë arsye poezia
është kaq
fatkeqe se është përdhunuar që
katërmbëdhjetë
kështu fillojnë marrëzitë dhe këto i zgjidh
lufta
eja mëngjes shpejt
të zgjohesh ti
dhe bota të jetë e seksit femër

...

tre

...

përderisa shpikjet u shpikën ekzistonin
diku
përderisa ajnshtajni teorinë e ralativitetit
shpiku ajo ishte shpikur me kohë po kishte
humbur
kjo është një lojë e arsyes së lartë që
bashkë me imagjinatën e lartë arrijnë të
perfeksionohen
një farë vjedhje e pandërgjegjshme është
dhe të gjithë nobelistët që krijuan më të
veçantën dhe më të lartën humane s'ishin
gjë tjetër veçse hajdutë hyjnorë
dhe qielli i mistershëm që u tregua tuaf dhe
mëndjelehtë merr ndëshkimin e merituar
me ateistë inteligjentë që shtohen
nesër kur teknologjia të arrijë majën dhe të
vetasgjësohet për të dalë një shkencë e re
natyrisht bashkë me shpikjet e mëdha
njeriu do të bëhet m idiot se jo një shkëmb
do të
mbajë mbi sup po njëqind dhe sizifi do të
quhet periudha foshnjore sizifiane
atëherë mund të kundërshtojë vetveten
me një luftë të re botërore që do t'i fshijë të
gjitha nga faqja e dheut dhe historia do të
përsëritet
veç fillimi do të jetë sërish zoti me
shprehjen
le të bëhet!
dhe do të arrihet në përfundimin e
përfundimeve se kjo paskësh qenë shpikja
më e madhe dhe këtu duhet ta lëmë
le të bëhet!

...

ato që humbën lanë fotografitë dhe kjo
pothuaj s'quhet humbje
dashuria e parë është
fotografia ruhet
ndonëse natalia ajo vajza e tetëvjeçares
me kordele të kuqe tani punon në bankë
dhe peshon njëqind kile ha sallatë pi ujë
gogësin fle gjumë
humbën gjërat më të bukura po ruhen
fotografitë
kjo është diçka hyjnore

dhe mëkati ruhet
janë brenda njeriut
si hëna brenda natës
si dielli brenda ditës
e errëta dhe e ndritshmja
prandaj vuan njeriu se kujtesa mundohet
prej fotografive
harresa kurrë sqëlloi një censor i
pamëshirshëm
po një qelbësirë e pa bindur
a mund të bëhet një operacion në moshën e
bilancit kur duhen zhdukur mijëra fotografi
turpëruese
këtë e ka në dorë zoti që vetëm tallet
kujtesën tonë më fort ndriçon natën

...

bota e madhe në një apple
mbajnë radhë njerëzia të blejnë botën sa
një zog
s'ka flatra
ato janë brenda në apple
sot ulisi teknologjik humbi itakën

...

shpesh humbas drejtimin
timonin ia heq rrugës për në shtëpi
dhe ia vendos hënës,
bëj një copë rrugë nëpër qiell të hap portat
e yjeve
gjej gjithçka përveç nënës
atëherë kujtohem se kam ende nënë
po i afrohet të nëntëdhjetave dhe ajo më
pret
është gati t'i bjerë telefonit; bir, ç'ka
ndodhur, ku je?
asaj i duket se diçka e keqe më ndodh
gjithmonë
vetëm e keqja është shija që i ka ngelur që
prej kafes pa sheqer të mëngjesit
po unë ende timonin s'e kam hequr
se një lejlek me këmbë të kuqe ulet në një
pemë dhe luzmë puplash fshijnë pluhurin
e qiellit
prej andej më bëhet se rrëzohen poetët e
vdekur
bashkë me kometat
po nënës nuk i them asgjë
se e kam shqetësuar shumë në vogëli kur
shkruaja vjersha
dhe lija shkollën për të parë te liqeni lulet e
kuqe të kumbullës dhe atë mëllenjën e zezë
brumbullin që e lidhja dhe e rrotulloja për
t'ia bërë
zhu zhu
çiftet e dashnorëve që putheshin
gjuaja me gurë macet në kazanët e plehrave
dhe i thosha nënës marrëzira
prandaj veçan më donte
se i dukesha i marrë dhe kishte frikë mos
më humbte
në fund
timonin marr në duar dhe kthehem
e bukur është shtëpia, nëna
nëna që pret
po më e bukur arratia

...

një flakon penicilinë
ishim të varfër
nena dhe babai infermierë
s'kishim një vazo për lule
po as lulet s'na vinin ndërmend
unë shpesh sëmuresha
dhe babai me gjilpërë më shponte
agen dhe shiringën ziente
në një enë prej xingoje
pastaj ngulte agen në tapën e penicilinës
thithte lëngun e bardhë
shtatë ditët e javës
në mëngjes dhe në mbrëmje
më ngulte agen në mish
dhe unë për ta marrë me të mirë
penicilinën
atë përbindësh prej pluhuri të bardhë
mbyllur brenda
flakonin e bëja vazo lulesh
i kërkoja armëpushim
me një karafil a trëndafil
po e pamundur ish
nëna dhe babai infermierë
atë punë kishin
të më bënin penicilinë

...

një çimkë fle në cep të dyshekut dhe pret
natën të më pijë një pikë tjetër gjaku
mbi tavolinë rrinë zarfet e taksave plot me
çimka brenda
rrokaqiejt e nju jorkut pasi kanë pirë
gjakun poshtë
i janë vërsulur qiellit të pinë gjak zotash
të fundit janë taksitë mizëri që pinë kusurin
që mbetet
ngre dorën dhe marr një taksi për në
operan metropolitan
të shikoj romeon dhe zhuljetën dhe çimkat
që iu hanë zemrën

...

në mes të qytetit janë spitali dhe varreza
më tej janë restoranti, kinemaja, muzikë
holli, moda
përpiqemi që kohën më të madhe të
merremi me këto të fundit
takime të lëmë,
t'i frekuentojmë ca më shpesh
prej frikës së spitalit dhe varrezës
ah, të kishte një perde t'i ndante prej nesh
celulari cicërin si zog;
alo, një biletë
e dashur, të pres në pesë, hamë diçka te
madona pastaj shkojmë nga moma të
shohim pikasonë,
alo, një tryeze për ditëlindje te london me
muzikë të rej charlsit dhe armstrongut
alo, një kostum për nje mbrëmje gala
alo, urgjenca
një tjetër ka marrë për ne kur zemra ka
ngecur
alo, funeral home,
një tjetër ka marrë për ne kur këndohet
requiemi
i kishim harruar, s'kishim pasur kohë,
ose kinse i patëm lënë mënjane
tjetrit ia kishim lënë këtë barrë
dhe ai respektin na e bëri deri në fund
pa marrë asnjë shpërblim

...

kam parë një baba të urryer
prej fëmijëve, se nuk ju la trashëgim asgjë
përveç një dosjeje të hollë me poezi
dhe një shënimi aty brenda;
këto poezi më kushtuan jetën
tani e kuptoj që kam dështuar
s'kthehet koha që s'shijova
po lumturia qe te shkrimi
kur vinte fryma hyjnore
dhe unë i bindesha urdhrit
poezitë s'më dolën gjë
po lumturinë e shijova
dhe pres vdekjen të më marrë
si një poet, me një peng
se trashëgim nuk lashë asgjë
ngaqë u mora me qiellin
kam parë një baba të urryer
prej fëmijëve
m'u kujtua vetja ime
s'pata pendim që letrat
i çova te banka e dantes
pa numër llogarie
një grusht me vargje

Ishte një plakë e kërrusur, me fytyrë fare të heshtur, plot rrudha, e cila, sapo fillonte dhe biente dielli, merrte stolin dhe rrinte e ulur tek pragu i derës. Kokën e mbante gjithmonë të kthyer nga rruga, me sytë e picërruar, të futur thellë në zgavra, ku dalloheshin dy sy, të cilët edhe pse të pikëlluar, ishin fare të kthjellët dhe të zgjuar.

Në rrugën e shtruar me kalldrëm, që prej vitesh, kalonin fshatarët për të shkuar tek qendra e fshatit. Në fillim, kur ato e përshëndesnin, ajo rrinte në heshtje. Por që kur ato kishin këmbëngulur, ajo kish filluar pak sa të lëvizte kokën, thjeshtë për t'i lënë të kuptonin që e kishte marrë mesazhin dhe po i përshëndeste edhe ajo. Vendasit, tek iknin drejt kafenesë apo qendrës së fshatit, i përshpërisnin njëri tjetrit, se ajo tashmë ishte e çmendur. Ndaj, pak nga pak, filluan të mos e ngacmonin më, as edhe ta përshëndesnin. Fëmijët, këmbëzbathur, tek e shihnin ashtu, zhytur në mendimet e saj, me qafën e kthyer nga rruga, ngërthyer nga një frikë dhe kurjozitet i çuditshëm e shtonin hapin. Edhe ato i përshpërisnin njëri tjetrit të njëjtat fjalë që dëgjonin në shtëpi nga të mëdhenjtë. “Është e çmendur! Se ç’i ka ndodhur diçka e rëndë, vite më parë!” Të gjithë e dinin në fshat. Por fjala tashmë kishte marë dhenë, ndaj kur vinin nga fshatrat e tjerë, sapo e shihnin ashtu, tek kalonin mbi kalldrëm, dikush tjetër i pëshpëriste të ardhurit ç’i kishte ngjarë. Ndaj ardhacakët bëheshin serjozë, ulnin kokat dhe shtrëngonin buzët në heshtje. Heshtja, e një tragjedie aq e madhe që i kishte rënë mbi krye. Nëna vishej krejt me të zeza. Fjala kishte marrë dhenë aq shumë sa kishin filluar të interesoheshin edhe gazetarët e qyteteve fqinjë. Vinin ato, ta intervistonin. E pyesnin në muzg duke i zgjatur mikrofonin. Por ajo nuk fliste. Rrinte ashtu, me sytë e mprehtë dhe të kthjellët, rrudhat pa fund. Nuk ja ndante vështirimin xhades së gjatë, e cila zbriste deri poshtë kodrës dhe mbaronte me një radhë plepash anëve të rrugës. Kur gazetarët këmbëngulnin, - rrinin aty me orë, edhe pse i bënin lloj lloj pyetjesh, ajo nuk përgjigjej. I shihte si nga një botë tjetër. Por ndonjëherë, përsëriste të njëjtën shprehje: “Ja andej do të shfaqet. Ashtu siç iku, po ashtu do të vij! E di!” Kishin kaluar njëzet e dy vjet që nga ajo ngjarje.

Ishte maji i vitit të eksodeve. Atë natë, kur biri i saj, bashkë me shokët, fshehurazi, simbas fjalës i ishte bashkuar grupit tek vendi i takimit, ishte habitur krejt. Nuk ishin një grup i vogël djemsh. Kur u mblodhën, ishin bërë një grup prej 25 djemsh. Dikush kishte sjellë fuçia, dikush litarë, dikush dërrasa të gjata dhe lopata deti. Kishin marrë ujë dhe ushqime. Tërë natën, i ishin vënë punës me zell duke i lidhur fuçiat me gjalm përreth trarëve të drurit, në mënyrë që të rrinin mbi ujë. Kstrioti, ishte një djalosh 24 vjeçar, plot zell dhe energji, i cili dëshironte të ikte jashtë dhe të ndiqte ëndërrën e tij të notarit. Truplidhur, i gjatë, plot me vullnet dhe entuzjazëm, por fare i papjekur, e kishte ndarë mendjen me kohë. Do të kalonte kanalin e Otrantos dhe do t ja mbathte në shtetin fqinj. Atje, ku ishte lirira. Atje, do të ndiqte ëndërrën e tij për tu bërë kampjon në not.

Atë natë, tek lidhnin fort fuçiat me trarët, për të ndërtuar pesë lundrat që i nevojiteshin, ndjente një boshllëk të çuditshëm në shpirt. I heshtur si nata, i zymtë dhe krejt i ngrysur, ndërsa lidhte fort një litarët, kujtonte fjalët e nënës thënë atë mëngjes dhe ndjente një lëmsh të frikshëm në gjoks. “Zoti e bëftë mirë!” i kishte thënë ajo. “Shihja në ëndërr sikur një mërgatë korbash futej në odën tënde!”

“Të gjitha ëndërrat dalin në të kundërtën!” ia kishte kthyer ai. Por ja që shpirtin e kishte pus të zi, nga pikëllimi. Bënin dritë me zjarre, por nga larg, përtej detit, në dukje të qetë, disa rrufe dhe vetëtimat e çuditshme, për një çast e



zbardhnin qiellin krejt. Nuk rreshtën duke e ndriçuar botën gjatë tërë natës.

Djemtë e kishin vendosur. Donin ta kalonin kanalin e Otrantos. Ora shtatë e mëngjesit, si shokët e tij, Iliri, Gjergji, Arbëri dhe shumë të tjerë, i gjeti me lundrat gati. Kishin kaluar pyllin përmes rrugës së pishave, dhe tani ishin buzë detit nga ku shihnin Karaburunin. Nga aty e kishin vendosur të niseshin. Në orën shtatë e gjysëm, shtynë lundrat e sajua në ujë dhe filluan t’i jepnin lopatave drejt detit të gjërë. Ishin disa lundra, me nga pesë vetë sipër. Frika ishte e madhe, por edhe entuzjazmi se do t ja dilyn mbarë, shtoej në proporcjon me frikën. Gjithçka shëmbëllente me një lojë të bukur. Nga ato lojrat që kishin bërë shpesh kur ishin fëmijë, por ende ndoshta nuk ishin të ndërgjegjshëm se kjo, ishte një lojë e një lloji tjetër. Një lojë shumë edhe më e rrezikshme. Këtu luhej me jetën. Deri sa kaluan Karaburunin gjithçka shkoi mirë, por pastaj dolën në det të hapur. Deti ishte fare i qetë, paqedashës, mikpritës. I jepnin lopatave me shpejtësi. Ishin pesë lundra. Dëgjohej veç pllauritja e ujit krijuar nga lopatat e drurit që shtynin fuçiat, lëkundja e lundrave, dhe dielli që binte pingul mbi krye si saç.

Por ja që mbas nja një ore e gjysëm qielli u mbush me re të zeza, deti u nxi, filloi të fryj erë e ftohtë, dhe dallgët u rritën. Fuçiat në mes të detit filluan të uleshin dhe të ngriheshin duke u lëkundur keqas. Kastriotit kish filluar ti rrihte zemra fort. Tek mundohej ti jepte fort lopatave duke shtyrë fuçiat, dallgët e zeza po e rrisnin intensitetin e tyre. Tani ai përpara tij, i shihte ato si kodra të lëvizshme, të cilat, një herë e ngrinin në ajër, pastaj e ulnin krejt gati duke e fundosur nën ujë. Edhe pse dinte mirë not, prap filloi ta kapte paniku keq. Po sikur dallgët ta shkërrmoqnin krejt lundrën e tyre lidhur me litarë? Disa nga fuçiat filluan të mbusheshin me ujë. Tashmë në atë batërdi kërcënuese dallgësh, nuk i shihte më lundrat e tjera. Atëherë e kuptoi që pak nga pak, po shkonte pa kthim, drejt një aventure fare të frikshme, të pashpresë. Një aventure, ku ai, fare papritur, mund ta gjente veten, si përpara dyerve të së panjohurës. Tani po e kuptonte budallallëkun që kishte bërë. Të kalonin detin në ato kushte?! Ai det, që fare pak më parë, i ishte dukur bujar, i ëmbël, si një shtrojë e qetë, ku ai mund të shkiste deri tutje, tek toka e ëndërrës; tani po i bëhej kërcënues, krejt i zi dhe fare i pamëshirshëm. Ai i kishte ndjekur parashikimet e motit. Nuk pritej as shi dhe as kohë e keqe. Por ja tani, gjithçka po ndryshonte shpejt. Tani ndjente kripën në qiellz, ndjente egërsinë e dallgëve, dhe ato lidhjet që i kishin bërë fuçiave me litar, tani po hapeshin. Dërrasat krejt të lagura, kllaçitja kobndjellëse e

stërkalave të ujit; gjithçka, ishte aq e brishtë, aq e pafuqishme, përpara tërbimit të një deti krejt të zi. Një deti, i cili, në çast, ishte bërë mizor dhe ndjellakeq.

Sa hap e mbyll sytë, era e fortë, ja flakëroi tutje çarçafin e bardhë që kishte vënë sipër si velë për tu mbrojtur nga dielli. Dallga e dytë e fuqishme ia hodhi tej trastat me ushqime. Pastaj iu zhduk uji i pijshëm, dhe kështu me rradhë, ndërsa ai krejt i torollepsur, si në një ëndërr të keqe, tani mundohej të vinte rregull në mendime. Lundra e tij primitive, shpëlahej nga ca dallgë të fuqishme, të cilat e çiklonin dhe e lagnin krejt. Deti u nxi akoma edhe më shumë. Qielli u mbush krejt me re të zeza, skëterrë. Era e shtoi fërshëllimën e saj ndjellazezë. Kastrioti me shokët, nuk dinte më se si të dilte nga gjithë ky makth. Shikonin fytyrat e njeri tjetrit me tmerr dhe frikë. Do të dëshironte shumë të ishte në ëndërr dhe ai të zgjohej vrik, i larë në djersë duke marrë frymë thellë dhe duke u qetësuar. Por ja që nuk ishte makth. Fatkeqësisht, gjithçka ishte reale. Dhe ai, për herë të parë në jetë të tij, edhe pse ende 24 vjeç, po e ndjente hijen e mortit, sfidër ogurzezë, kapriçoze dhe të pafalshme, të saj. Si kishte qenë e mundur që kishin bërë një idiotësi të tillë? Tani nuk ishte koha për pyetje të tilla. Tani ishte koha për lutje Qiellit me dhëmbët që i kërcisnin nga tmerri, panikun në zemër, gjunjët që i dridheshin nga tmerri. Frika e kishte kapluar krejt, si të ishte një dreq me brirë dhe sytë si thëngjinj. Si do ti bëhej? Po sikur një dallgë tjetër tia shqyente krejt litarët shtrënguar një, të cilët mbanin lidhur 6 fuçiat me dërrasat e lundrës. Ngrinte kokën me llahtarë. Rrufetë, si firma të frikshme plot dritë të zezë, shkruanin ndoshta pa fund, mbi letrën e jetës së tij, fjalën vdekje? Me fytyrën e lagur, krejt i mpirë, si në një ëndërr të keqe, i dilte para syve fytyra e ngrirë dhe e tharë e nënës së tij atë mëngjes. “Ruhu bir. Korbat sjellin mort!” Nuk i hiqej nga mendja shprehja e fytyrës së saj. Ajo gjendje dhimbje dhe preokupimi, të cilën, nënat shqiptare e kanë në gjak. “Oh nënë ku je? Eja më shpëto!” klithte ai.

Me kalimin e viteve, familjarët kishin emigruar të gjithë. Kush në Greqi, kush në Amerikë, kush në Itali, por ajo s kishte dashur të lëvizë. Rrinte ende aty, edhe pse kishin kaluar 22 vjet. Muaj mbas muaji, stinë mbas stine, vit mbas viti, ajo, në shi, në erë, në diell, në të ftohtë, në të ngrohtë, sapo dielli fillonte të kërrusej, ajo, merrte stolin, ulej tek pragu i derës dhe mbante kokën e kthyer nga rruga me kalldrëm. “E di që do kthehet!” mërmëriste. “Më tha do të vij në aksham!” Tashmë e dinin të gjithë. Plaka ishte çmendur.

Një herë, një bashkëfshatar, i cili e njihte që kur kishin qenë fëmijë, i ishte afruar, ishte

ulur në gjunjë fare pranë saj, as gjysëm metri nga ajo dhe me keqardhje i kishte thënë: “Plaka Margo. Kanë kaluar shumë vite. Ai nuk kthehet më!”

Në fillim plaka Margo, krejt e zymtë, si e mbështjellë me një çarçaf si qefin, s kishte folur.

“Futu në shtëpi dhe flije mendjen. Dorzonju fatit. S kthehet më! E din edhe vetë që është e kotë që pret!”

Ajo e kishte parë me një shprehje mes përbuzjes dhe gati padurimit: “Do të kthehet, e di!”

“Kanë kaluar kaq shumë vite. S ke asnjë lajm!”

“Ma ndjen zemra. Ndoshta atje ku punon i japin leje dhe ai kthehet!” i ishte përgjigjur ajo.

Plaku s kish ditur ç ti thoshte më. Ishte një i moshuar i mbajtshëm. Veshur me kostum, kollare, një kapele republike, i thatë dhe i dobët, por krejt elegant në vetminë e tij prej të moshuari plot dinjitet. Jo vetëm ai. Të gjithë pleqtë e mëhallës, edhe pse të vetmuar, e mbanin dinjitetin e tyre. Në fshat, tashmë kishin mbetur veç më të vjetrit. Të rinjtë kishin ikur, kishin krijuar familje nëpër udhët e botës. Dhe aty, mes gurit dhe drizave. Strallit dhe kaçubeve, kish mbetur veç heshtja e shekujve, era e marrë e tetorit dhe jehona e largët e gurëve. Të gjitha shtëpiat ndërtuar me rrasa dhe gurë, të cilat kishin qenë teatër jete dhe pasjonesh të fuqishme njerëzore, tani banoheshin nga heshtja dhe harresa. Tek tuk, shihje ndonjë plak kurrizdalë, të vetmuar, tek ecte me shkop mbi kalldrëm. A ndonjë çoban me kope dhensh, këmborët e të cilëve tërbonin dynjan.

Akoma Kastrioti luftonte me dallgët e zeza dhe të tërbuara. Lundra ishte çarë dhe coptuar, ndaj ai tani mbahej tek një fuçi e cila pak nga pak po mbushej me ujë. Tani, as pendesa, as mendjelehtësia, as parandjenjat ogurzeza të nënës së tij, nuk do ta ndihmonin dot. Ndaj vetëm në mes të dallgëve, me një qiell si në janar, luste Perëndinë të shpëtonte i gjallë. Kripa ja digjte gojën, dallgët e zhytnin, por ai ngrihej rishtaz nga fundësiat e ujit. Hapte krahët, mundohej të notonte, por sa fillonte ti jepte krahëve, një dallgë tjetër e egër e fundoste rishtaz. Uji ishte krejt i ftohtë. “Oh nëna ime!” tha, “si nuk e dëgjova parandjenjën tënde!” Filloi të notonte në një det drite. Tani shihte ngjyra, dëgjonte tinguj, mbushej me aroma. Një paqe e rrezikshme e kaploi krejt. Nuk u kthye më nga ai udhëtim.

“Bir, po lodhem duke pritur!” kishte mërmëritur një darkë. Kishin kaluar 22 vjet që kur ai kishte ikur. “Ndaj, po s erdhe ti, do të vij unë atje të të gjej!” kishte vazhduar të mërmëriste.

Ishte maji i vitit dymijetrembëdhjetë. Nëna, veshur krejt me të zeza, qëndronte ende ulur tek pragu i shtëpisë. E mbante kokën kthyer nga rruga me kalldrëm. Tani nuk e dinte a shihte ëndërr apo vërtetë po i ndodhte. Ishte ngritur, dhe si duket e lodhur nga pritja, kish marrë vetë rrugën e kalldrëmtë. Poshtë të tatëpjetës. Plepat në fund të saj i kishin sharruar vite më parë. Buzë rrugës kishin ngritur disa vila me qiparisa përreth. Tek largohej, e shihte veten ende ulur, krejt të ngrirë. Ecte, me hapin e erës, me kujdes se mos rrëzohej. Po errësohej dhe plaka Margo, këtë herë, nuk po futej në shtëpi. Rrinte akoma aty me shpinën mbështetur tek muri i ftohtë dhe kokën e kthyer nga rruga. Disa fëmijë që loznin aty afër, e pikasën që po errësohej dhe ajo s po lëvizte më, ndaj vrapuan që të thërritnin më të rriturit. Kur prindërit erdhën, pikasën se plaka Margo rrinte pa lëvizur. Ishte krejt e ftohtë dhe e ngrirë. Nuk merrte më frymë, pulsën e kishte akull dhe vazhdonte të rrinte mbështetur tek muri i pragut të shtëpisë. Nga goja nuk i dilte asnjë frymë jete. Siç dukej qartë, ishte nisur për larg. Për shumë larg.

Një muaj nga mbërritja në qytetin shumëmilionësh po e ndiente veten gjithnjë e më të humbur. Kishte ardhur në Nju-Jork nga një qytezë e Mesdheut të largët, që s'i kalonte tetë mijë banorët. Qenë aq të paktë në numër sa, gati të gjithë, si në një familje të madhe, njiheshin me njëri-tjetrin, shiheshin e përshëndeteshin në rrugë si të njohur të vjetër. Ky intimitet, gati fisnor, e bënte bulevardin “Mediterraneum” të këndshëm. Rruga ziente nga të rinjtë e të rejat që bisedonin gjallërisht dhe herë-herë, shpërthenin në të qeshura e thirrje të hareshme. Edhe kur s'njiheshin e s'kishin këmbyer fjalë më parë, shiheshin në rrugë miqësisht, sy më sy dhe shpesh i buzëqeshnin njëri-tjetrit. Qyteza bënte kështu një jetë të paqtë, të qetë, të lumtur dhe pa andralla. Më të rriturit merreshin me peshkim, kurse më të rinjtë ndiqnin shkollat dhe zbaviteshin mbrëmjeve në klube argëtimi e sportive.

Të gjitha këto i kishte lënë pas një ditë të muajit maj. I kishte hipur avionit dhe i mbushur me shpresa për të ardhmen, kishte udhëtuar për në qytetin e ëndrrave.

Të nesërmen e mbërritjes qe e shtunë dhe Rubi e shfrytëzoi këtë ditë pushimi për të shëtitur në më të famshmen rrugë të Nju-Jorkut, Broadway. Pothuajse u shokua. S'po u besonte pamjeve gati-gati ireale. Iu duk se po shihte një ëndërr tronditëse. Njujorkezët s'ia hidhnin aspak sytë njëri-tjetrit. Nuk shiheshin ashtu si në qytezën e vet. Dukej se askush nuk bëhej kureshtar, nuk interesohej dhe as që donte t'ia dinte për tjetrin. I kalonin pareshtur përbri, majtas e djathtas, dhjetëra, qindra kalimtarë dhe askush s'e vërente, si të mos ishte.

Ditët e para, kur në njëfarë mënyre u mësua, një fenomen i tillë iu duk deri-diku i pranueshëm, madje edhe i këndshëm. Të jepej rasti të kundroje lirshëm, pa më të voglin kompleks, mijëra portrete njerëzore, njëri më i ndryshëm e më interesant se tjetri: të bardhë, të zinj, kinezë, spanjollë, meksikanë, arabë, indianë, o perëndi, larmi e pafund! Kësaj s'ia kishte mbërritur kurrë në qytezën e tij, sepse, sapo i vinte ballas një banor i saj, ishte e pamundur të mos shiheshin sy më sy e, në kësi rastesh, është e vështirë, në mos e pamundur, të përqendrohesh në të veçantat, intësitë e fytyrës së tjetrit. Kurse këtu, në Nju-Jork, ishte ndryshe.

Ja! Ia ka ngulur sytë një vajze zezake rreth të njëzetave: e gjatë, belhollë, e zhdërvjellët, krenare, simpatike dhe seksi. Kryelartë, e sigurt në vete, joshëse, ajo shkon drejt tij; po afrohet me grupin prej dhjetëra njerëzish që sapo kaluan semaforin në një kryqëzim të Time Square.

Ai pandeh se mund ta shohë shpenguar, lirshëm, siç ka bërë gjer tani me qindra të tjerë, pa u vënë re, por... Ja, këtë s'e kishte pritur. Zezakja u ndal befaz mu te këmbët e tij dhe i hodhi një vështrim të rreptë e gortues.

- Zotëri, kishit ndonjë gjë për të më thënë? E dini ç'është privatësia? Mos duhet të thërras 991-in?

Rubi, që s'i kishte mbushur të njëzetepestat, shtangu. I shokuar, tha vetëm një “Më falni!” me gjysmë zëri dhe bëri tutje, pa guxuar të kthente kokën pas.

Kishte marrë goditjen e parë të beftë në qytetin e huaj. Kishte cenuar privatësinë e një personi të panjohur dhe kjo duhej ta bënte më të kujdesshëm në të ardhmen.

Kështu, pra, po mësonte atë që s'e kishte ditur më parë (por as qe paralajmëruar nga kurrkush): qyteti nuk shihte dhe as pranonte të shihej. Mendjemadh, krenar, narcizist, egoist, i ftohtë akull, gjiganti merrej vetëm me veten. Nuk ekzistonte tjetërkush (dhe as që mund të ekzistonte) përveç atij vetë.

Më i përqendruar, më i vëmendshëm, më i kujdesshëm, Rubi vazhdoi të shëtiste në Broadway, ndërkohë që e anashkalonin qindra kalimtarë. Ai mund të përbetohej se, në fundin e asaj dite, as edhe një njujorkez i vetëm s'denjoy t'ia hidhte sytë, gjë që tani po e bënte të vuante, mbase diç më shumë se uria që kishte nisur ta merrte.

“Ushqimi i shpirtit! Ja, çdo të më munguaka këtu!” - mendoi trishtueshëm dhe ktheu në të parin McDonald's që i doli përpara, për të mbushur të paktën stomakun që kishte nisur t'i gërryente dhembshëm.

Sikur qiellgërvishtësit të kishin rënduar më shumë në psikikën e tij me përmasat gjigante, e sidomos me lartësitë e frikshme marramendëse, duke e bërë të ndihej edhe më i shtypur, edhe më depresiv, edhe më i dobët, në Washington D.C. pati ndjesinë e një lehtësimi të gazmendtë dhe çlirimit prej ankhtit që mend po i merrte frymën. Ndërtesat e tij shëmbëllenin (dhe i kujtonin sakaq) qytetet e vendit të vet, qytezën mesdhetare ku qe lindur, rritur e burrrëuar. Rrallë e tek mund të të shihnin sytë ndërtesa të larta.

E megjithatë, njerëzit qenë thuajse të njëjtë, si ata të Nju-Jorkut, me një ndryshim të lehtë e të parëndësishëm; të ftohtë, seriozë, shpërfillës, krenarë, të vetëkënaqur, të cilët kalonin pranë dhe as që denjonin të të hidhnin një vështrim sado të shpejtë e kalimtar. Në kësi rastesh i vinin ndër mend njerëzit e qytezës së vet, që i shfaqeshin në përfytyrime kurdoherë të ngrohtë si dielli i tyre, të afërt, të përzemërt, të dashur,

Homo Sapiens në qytetin që nuk sheh

Tregim nga Flamur Topi

të respektueshëm e miqësorë, tepër miqësorë.

Ditët shkonin dhe ai s'po mësohej dot me qytetin e huaj. Në fund të fundit, nuk mjafton vetëm të hash e të pish, të kesh një vend të rehatshëm për të fjetur. I kishin dhënë aq para sa për të shtyrë dy a tre muaj, deri në marrjen e asistencës.

Rubit i mungonte shumë ngrohtësia njerëzore, lidhjet e reja miqësore, komunikimi, dashuria... Ishte gati të hante një herë në ditë, veç të provonte sërish atë ndjenjë të veçantë, atë humor të mirë, atë kënaqësi, atë gjendje dehëse, si në shëtitjet e mbrëmjes në qytezën e vet të lindjes. Por s'i mbetej veçse të priste me shumë durim e të mësohej të përshtatej me jetën e re. A nuk i kishin thënë që më parë të njohurit se mjaft të rezistosh e të mos jepesh një gjysmë viti, se pastaj gjiganti s'të lëshon më nga duart. Të lidh me ca fije të papërshkrueshme shpirtërore, të shndërron në robin e vet të magjepsur e ty as që të shkon mendja të largohesh, ta braktisësh atë e të kthehesh përgjithnjë në vendlindje.

Mësoi rastësisht se të nëntëmbëdhjetë muzeumet dhe galeritë e Smithsonian-it ishin *free*, domethënë pa pagesë, gjë që, sipas bindjes së vet, do t'ia ndryshonte disi rrjedhën e jetës monotone të deriatëhershme.

Ai lëshoi një pasthirmë habie porsa lexoi shifrën marramendëse të tridhjetë e shtatë milionë artefakteve që u ofroheshin vizitorëve dhe vuri gishtin në muzeumin e parë, që përshkruhej si ndër më interesantët në guidën orientuese të Smithsonian Museums. Ishte e qartë tashmë, s'do të kishte kohë as të merrte frymë.

The National Museum of Natural History! lexoi i përqendruar gerrat e mëdha të gurta, të skalitura në faqen ballore të ndërtesës, me një arkitekturë të përzier, por tërheqëse, greko-romake.

Nxitoi të ngjiste shkallët, sepse jashtë ishte tepër nxehtë.

Mori frymë i lehtësuar kur hyri brenda në sallën e freskët dhe rrumbullake të muzeumit. Vizitorë, shumë syresh me pamje të hutuar a të çoroditur (si ai që s'di kë të shohë më parë), hynin a dilnin pareshtur nga sallat e mëdha, ku qenë ekspozuar mijëra genie të balsamosura: kafshë, shpendë, zvarranikë, insekte, që vetëm emrin ua kishte dëgjuar dhe ua kishte parë në filma dokumentarë të programeve të ndryshme televizive; luanë, tigra, leopardë, shimpanze, orangutangë, dinozaurë, krokodilë, gjarpërinj, o perëndi, pa mbarim!

Sado hijerëndë, serioz, fjalëpakë, egoist, krenar, fodull, shpërfillës a mendjemadh të ishte jashtë muzeumit, qe e pamundur t'u rezistojë mrekullive që të linin gojëhapur.

Vizitorët, ngado që kanë ardhur, duken të ndryshëm nga ata të rrugës, qoftë edhe të së famshmes Broadway. Të tjerë njerëz, bashkëbisedues të ngrohtë, të përzemërt, miqësorë, të interesuar për të mësuar diçka të re, të gatshëm për t'iu përgjigjur atyre që pyesnin. Në fytyrat e vizitorëve shprehej dukshëm dashuria, dhembshuria, deri edhe pikëllimi për kafshët a shpendët e balsamosur, të fiksuar përgjithnjë nga mjeshtër të zotë, në një pozicion sulmi të egër ndaj viktimave më të dobëta apo në pozicionin e pritshëm të mbrojtjes së pashpresë.

Në ditët që pasuan, Rubi vizitoi gjithë muzeumet e tjera, njëri më i bukur dhe më interesant se tjetri. E prapë, ai iu rikthye shumë herë të parit, The National Museum of Natural History. Po ta pyesnin se përse po e bënte këtë, për ç'motive, për ç'arsye a qëllim vinte këtu çdo ditë, nga mëngjesi deri në mbrëmje, pa u lodhur aspak, pa ndier mërzitjen më të vogël, s'do të ishte në gjendje të jepte një përgjigje bindëse. S'po mundej të shpjegonte se ç qe ajo forcë e mistershme, tërheqëse, që e thëhtinte pareshtur në gji të saj, në një gjendje të veçantë të tijën, të përngjashme me atë të somnambulit, të të magjepsurit, të besimtarit...

O perëndi! thoshte tërë frymëzëim sapo shkëputej prej elefantit afrikan tetëtonësh dhe ndalej pastaj para krijesës më të vogël të muzeumit, Tinodon Lepidus, njëqind e dyzet

e pesë milionë vjet të vjetër, që, për t'u bërë qartësisht e dukshme, e kishin vendosur nën një lente me fuqi të skajshme zmadhimi. O krijues i madhërishtëm! Të falem, të përkulem thellësisht për mrekullitë e tua, për çdo gjë hyjnore tënden! Pa shih si t'i kanë ngulur sytë e përvaishëm e të trishtë, sytë e ngrirë përjetësisht. Si të kundrojnë, si të shohin të gjorat, sikur të ishin të gjalla.

Kishte vizituar për ditë të tëra një tjetër mjedis, National Zoological Park; kishte parë qindra kafshë të gjalla, të vogla e të mëdha. Të gjitha në lëvizje të pareshtur, mospërfillëse, indiferente, të painteresuara për vizitorët, që, me sa dukej, u qenë mërzitur e u kishin ardhur në majë të hundës. Të mbyllura në botën e tyre vetmitare, monotone e të pashpresë, të linin përshtypjen e krijesave depresive, që s'u interesonte asgjë tjetër në atë botë përveç vetes. Dhe ishte aq e vështirë t'ua fiksoje tiparet në gjendjen e tyre gjiththerë të lëvizshme e të ndryshueshme.

Kurse kafshët e balsamosura të The National Museum of Natural History ishin krejt tjetër gjë. Edhe pse të pajeta, dukej sikur miliona, miliarda vështrime të vizitorëve (që s'reshtnin së ardhuri këtu prej dekadash) i shpirtëzonin, u jepnin frymë, jetë, i gjallonin. E ndoshta më mirë ashtu, të ngrira, të akulla, sepse lehtësisht mund t'u afroheshe, t'u qëndroje fare pranë, deri edhe t'i prekje, t'i përkëdhelje, t'i studioje deri në imtësi, t'i shihje qetësisht drejt e në sy, t'i vështroje me nge, derisa të lodheshe.

Eh, me të gjallat e National Zoological Park s'mund ta kishe atë komoditet e lirshmëri pa kufi. Sapo e nuhasnin, e ndienin, e kuptonin se po merreshe disi gjatë me to dhe po e teproje, ose largoheshin si të bezdisura a të lodhura prej teje, ose të hidheshin befaz egërsisht përmes ulërimash të thekshme, teksa përplasnin turinjtë e çakërryer në rrjetën e sigurisë.

Tek i vështronte gjatë e mendueshëm, Rubi gjykoi për një grimë se nuk qenë aq të pafata. Miliarda pa fund të sërës së tyre qenë zhdukur ndërkohë, pa lënë gjurmën më të vogël në këtë jetë. Ato, të balsamosura, edhe pse të pashpirta, ekzistonin ama, ishin dhe do të ishin kështu edhe qindra vite të tjera, pra ende në jetë, edhe pse të pafryma. Trupi i tyre thëhtinte në çdo sekondë energjinë e fuqishme të vështrimeve njerëzore, që depërtonin, infiltronin thellë në galaksinë e qelizave dhe të indeve vetëm në dukje të pajeta, sepse Rubi besonte se pikërisht prej asaj force ato gjallonin e përtëriteshin pareshtur.

Vallë, sa vështrime njerëzore ngërthehen gjatë një viti mbi trupat e balsamosur? Po energjia e shikimeve, forca, fuqia gjalluese e tyre, a është llogaritur ndonjëherë? Do të kishte qenë një studim vërtet interesant. Do të besoja se kafshët e balsamosura vetëm sa duken të pafryma, sepse brenda tyre gjallon doemos një jetë ndryshe. Një lloj tjetër jete.

Fuqia e vështrimeve njerëzore është e pahamendësuar, e paimagjinueshme. Vështrimi i një njeriu të vetëm mund të ketë efekt të paparashikuar mbi një person tjetër. Energjia e vështrimit njerëzor, valët elektromagnetike të trurit, mund të të depërtojnë, të përshkojnë tejprtej, të shkaktojnë një çrregullim tërësor, të çekuilibrojnë, të trondisin, të marramendin, të hutojnë, të konfuzojnë, gati-gati të rrëzojnë përdhe.

Kishte dëgjuar për një rast dramatik në qytezën e vet, kur kishte mjaftuar vetëm vështrimi i një të moshuare për ta sëmurur, madje edhe për të rrezikuar seriozisht jetën e një të vogli.

Po energjia e miliona, miliardave shikimeve? A mund të mos e konsiderosh dhe të mos e çmosh? Vallë, për këtë shkak apo për ndonjë arsye tjetër amerikanët s'ia hedhin sytë njëri-tjetrit në rrugë, duke e gjykuar këtë (a ndoshta duke kamufluar arsyen e vërtetë) si shkelje të privatësisë së tjetrit? Hëm! Hajde gjeje! Hajde e kuptojua zakonet dhe huqet këtyre!

Befas, si i përmendur prej një ëndrrë të çoroditur, i regëtiu në mendje pyetja e pritshme, krejt e natyrshme për t'u bërë në një muze të klasit të parë, si ai i The National Museum of Natural History: Po njeriu, ku është në këtë muze? Ku është, vërtet? Si nuk e kam parë? Si s'ma kanë zënë sytë gjer tani?

Ah, ja, më në fund! Ja, tek qenka! Man! Homo Sapiens! Homo Sapiens! përsëriti me vete.

Kërshtërar, iu afrua eksponatit ku binte në

sy fotografia e një burri rreth të pesëdhjetave. Personi i zgjedhur për të përfaqësuar simbolikisht Homo Sapiens ishte i veshur me një kostum ngjyrëkafe, me këmishë të bardhë dhe kollare po ashtu të kafenjtë. Një shami e bardhë i lëshohej poshtë xhepit të xhaketës. Pranë, fare pranë, në brinjë i qëndronte trupi i balsamosur i një shimpanzeje me pamje të frikshme. Më tej rreshtoheshin pranë e pranë orangutangu, xhiboni, për t'u mbyllur ky varg gjitarësh të balsamosur me majmunët.

I përhumbur, Rubi po i vështronte si i shastisur, ndërkohë që mendja i punonte ethshëm.

Në fundin e javës së parë të vizitave të përditshme në The National Museum of Natural History, Rubi kërkoi të takohej me drejtorin e saj, zotin Riçardson. Por s'kishte për të qenë e lehtë, siç pandehu në fillim. Iu kërkua arsyeja, qëllimi i takimit dhe në çdo rast djali përsëriste ngulshëm se të fshehtën mund t'ia besonte vetëm dhe vetëm zotit Riçardson.

Në ditën e dhjetë të kërkesave të pandërprera, gati-gati psikopatike, Rubi vendosi të bënte një lëshim.

- I thoni zotit Riçardson, - iu drejtua sekretares së tij, së cilës, për hir të së vërtetës, ai djalë i kishte ardhur në majë të hundës, - se muzeumi ka një mangësi të rëndësishme, të cilën dëshiroj t'ia bëj të njohur atij vetë, personalisht. - Dakord. Do t'ia them këto fjalë. - ia preu shkurt, dukshëm e bezdisur, sekretarja, një vajzë e re dhe tërheqëse, teksa mbante një shënim të shpejtë mbi një bllok të hapur.

Nuk besoi edhe aq se çupëlina (që iu duk e lehtë dhe koketë) do t'ia thoshte fjalë për fjalë shefit të saj kërkesën paksa të mistershme. Por ajo, përkundër hamendjeve, ia bëri të njohur, pas përshkrimit të detajuar të personit (i cili e kishte shqetësuar së tepërmi me vizitat e tij të përditshme dhe që, së fundi, ishin bërë vërtet të padurueshme).

- Çfarë?! - gati kishte ulëritur Riçardsoni. - Muzeumit i munguaka diçka e rëndësishme që unë ende nuk e ditkam? Është e pamundur! E pamundur! Më i madhi, më i pasuri, më i famshmi muze natyral i botës dhe përsëri i mangët, i pakompletuar?! - ironizoi ai, dukshëm i nervozuar me shprehjen provokuese të vizitorit të huaj. - E megjithatë, do ta pres, po, po, do ta pres! Jam me të vërtetë kureshtar ta mësoj nga i huaji...

- Çfarë?! Munguaka Homo Sapiens?! - gati ulëriu zoti Riçardson. - Djalë! Mos jeni tallur gjer tani? Mos po bëni një shaka të hidhur? Më thoni se jeni vizitor thuajse i përditshëm i muzeumit tonë dhe se paskeni vënë re në seksionin Man, Homo Sapiens?!

- Pikërisht! Si një vizitor i vëmendshëm, munda të vërej një mangësi të rëndësishme të seksionit “Man and the manlike apes, order primates”.

- E ç'na qenka kjo e metë, ky defekt, kjo mangësi?! - pyeti me cinizëm Riçardsoni, duke e përmbajtur veten me zor.

- Zoti Riçardson! Çdo genie në muzeumin tuaj, që nga më e madhja e gjer te më e vogla, që nga elefantit afrikan tetëtonësh e deri te Tinodon Lepidus, mezi i dukshëm, përfaqësohet fizikisht dhe denjësisht, edhe pse e balsamosur, kurse njeriu, genia më e lartë e planetit, thjesht me një fotografi të rëndomtë. Madje, është fotografia e vetme, krejt e vetme e të gjithë muzeumit, sepse, e përsëris, gjithë geniet e tjera u paraqiten vizitorëve me trupat e tyre.

- Sipas jush, ç'duhej të bënim? - pyeti Riçardsoni, duke e humbur dukshëm qetësinë. - Të vendosim një trup njeriu të balsamosur?! E kujt do t'i ngjallte interes kjo? Vetë vizitorët janë Homo Sapiens-ë dhe ata nuk kanë jo vetëm kuriozitetin më të vogël, por as edhe dëshirën për të kundruar vetveten. Pra, Homo Sapiens-i nuk do të shohë Homo Sapiens-ë. Kështu që, në një atmosferë të këtille, varianti i fotografisë është më i gjeturi, më i godituri.

- Dhe më pak dinjitozi, më pak i respektuari. Përderisa keni gjetur vend në muzeumin tuaj për Triceratops Horridus-in, Stegosaurus-in, Latouchella Merino-n, Eurypterid Pincer-in, dinozaurin Tyrannosaurus e gjer për kobrën Naja Naja, kaq e pamundur paska qenë për Homo Sapiens-in?

Riçardsoni, tek psherëtinte thellësisht, u shkëput lehtas nga shpinorja e kolltukut dhe me bërrylat e mbështetur mbi tryezën e punës, iu afrua me shumë Rubi.

- Çfarë propozoni ju, zoti Rubi? Në fund të fundit, këmbëngulja e pazakontë për të më takuar ka një qëllim, ka një arsye të fortë, një shkak. Nuk dua të besoj se tërë këto përpjekje të mundimshme, gati të dëshpëruara, i paskeni bërë thjesht sa për të më thënë se Homo Sapiens-i nuk është në vendin e vet të natyrshëm, të merituar. Atëherë, flisni hapur, më thoni sinqerisht. Si e keni hallin? Çfarë ideje keni? Ç'më propozoni? Ç'duhet të bëjmë me këtë Homo Sapiens-in tuaj?

Një çast, Rubi ngurroi të hapej. Propozimi i tij do të keqkuptohej. Do të merrej nga Riçardsoni si i motivuar nga arsye personale. E megjithatë,

duhej doemos të fliste. S'kishte ç'të humbiste. As që mund të mendohej një takim i dytë, i afër, me zotin Riçardson, ndërkohë që për të parin kishte hequr aq shumë.

- Zoti Riçardson, zotëroj mjeshtërinë e shëmbëllyesit të monumenteve njerëzore. Besoj, të tillë i keni ndeshur shpesh në sheshe kryesore, madje gjer në platformën e Statujës së Lirisë. Mund të qëndroj gjatë, krejt i ngrirë. S'më lëviz as edhe një pjesë, sado e vockël, e trupit dhe anësive. Do të lija kështu përshtypjen e padyshimtë të një Homo Sapiens-i të balsamosur, madje edhe më interesant, më pak tronditës e traumatik, sepse shpejt të gjithë do të mësojnë se s'kanë të bëjnë me një kufomë, por thjesht me një imitues, shëmbëllyes. Jam vetëm njëzet e pesë vjeç, i ri e i fuqishëm. Fitues i një konkursi bukurie në vendin tim. Kështu, do të përfaqësoja denjësisht racën njerëzore. Do të isha një simbol i parapëlqyer i Homo Sapiens-it.

Riçardsoni heshti një copë herë. S'ia ndante sytë e mprehtë. Bluante ethshëm me mendje, duke përfytyruar gjallësisht se si do të dukej një Homo Sapiens i vërtetë, i gjallë, përbri gjitarëve të tjerë të balsamosur, shimpanzesë, orangutangut, xhibonit, gorillës, majmunit. Në fund, dukshëm i vendosur, duke mohuar me kokë dhe duke hapur krahët, tha prerazi:

- Jo, djalë! Punë që s'bëhet! S'ka asnjë interes! Edhe kështu, Homo Sapiens-i qëndron me dinjitet në krah të gjitarëve të tjerë, për të mos shtuar se jeni i pari vizitor dhe deri tani i vetmi, që vini në dukje kinse mangësinë e paqenë të muzeumit tonë. Megjithatë, zoti Rubi, do të vazhdojmë t'ju presim me kënaqësi. Jeni pa asnjë dyshim vizitori ynë më i apasionuar dhe... ju falënderojmë për këtë.

Me fjalët e fundit në gojë, Riçardsoni u ngrit në këmbë, në shenjë përcjelljeje të pashpresë e deziluzionuese për Rubin. Zgjati dorën e fishkur, të cilën djali e shtrëngoi lehtë dhe ftohtë pa ia hedhur më sytë.

Ishte ai tani që nuk shihte, që nuk donte të shihte, por... as edhe ta shihnin.

Gati po dremiste. Ishte në gjendjen e ndërmjetme midis gjumit të sipërfaqshëm dhe të qenit zgjuar. Një grimë kohe, iu duk se brenda eksponatit Man, Homo Sapiens, vërejtí atë vetë, pra Rubin, trupin e tij të balsamosur. Ngaqë nga larg nuk po e shquante qartë, iu afrua i marramendur, si në gjendjen e veçantë të të hipnotizuarit, tranzit. Kur qe fare pranë, vetëm dhjetëra centimetra larg, shtangu. Qe ai. Po, po, ai vetë. Trupi i tij i ngrirë, i pajetë, i balsamosur. Nën të, me germa të mëdha, që binin lehtë në sy, qe shkruar: “Homo Sapiens, Rubi! Me vullnet të lirë, i dhuroi trupin e vet The National Museum of Natural History..”

Gojëhapur, vështronte si i magjepsur vetveten. Mjeshtërit e mumifikimit qenë përkujdesur të fiksonin përgjithnjë në fytyrën e tij një buzëqeshje të lehtë, që e bënte të dukej përherë një Homo Sapiens jo vetëm i bukur e tërheqës, por i lumtur e babaxhan. Sytë e ngrirë (edhe pse të ngurtësuar e të palëvizshëm) të shihnin ngultazi, gjallërisht. Dukej sikur të ndiqnin të vëmendshëm e vigjilues në çdo lëvizje a pozicion tëndin.

Një çast të shkurtër iu bë se depërtoi, fuzionoi dalëngadalë brenda asaj qenieje të klonuar dhe u njësua me të, u shkri, u bë një trup i vetëm.

Vargu i vizitorëve (për të cilët kishte qenë aq shumë i dëshiruar) nuk reshtte: të bardhë, të zinj, të kuq, të verdhë, vendës e turistë, fëmijë e të moshuar. Oh, Zot! Më në fund! Mijëra, dhjetëra-mijëra, qindra-mijëra shikime ngërtheheshin mbi të. Pikërisht ai, që kishte vuajtur e ishte përgjëruar edhe për një shikim të vetëm njujorkez, tani soditej, vështrohej prej të gjithëve.

Në fytyrat e vizitorëve, mumia Rubi shquante qartësisht dhembjen, tronditjen, pikëllimin, trishtimin për moshën e re të të flijuarit, por në ndonjë rast edhe simpatinë e hapur, ngazëllimin, mahnitjen, mirënjohjen për aktin e lartë sublim në nderim e respekt të thellë të species njerëzore. Vështrimet e tyre dukej sikur thoshin: Ah, tani po! Çdo gjë ka vajtur në vend të vet. Të kishte një eksponat të përhershëm në muzeum për Tinodon Lepidus-in e padukshëm e Homo Sapiens-i të mungonte?! Bah! Një padrejtësi e këtillë s'kishte për t'u pranuar e për t'u duruar kurrë, kurrë.

Një çift të moshuarish ndali gjatë përpara mumies Rubi. Një copë herë e vështruan në heshtje e plot dhembshuri prindërore.

- Të vjen keq! - dëgjoj pas pak zërin e dobët, si të humbur, të plakut. - Është flijuar në moshën më të bukur. Veçse brenda kësaj drame ka edhe një të mirë të perëndisë. Si mumiet egjiptiane, ka për të qenë i përjetshëm. Një ditë ne do të shkojmë, të gjithë sa sheh përreth do të shkojnë. Do të tretemi, do të harrohemi, sikur të mos kishim qenë ndonjëherë. Por Rubi do të jetë. Do të mbetet përgjithnjë kështu, njëzetepesëvjeçar, përherë i ri dhe simpatik. I adhuruar, i dashur prej të gjithëve.

- E çfarë i vlejnë tërë këto ditëziut?! Çfarë i hyjnë në punë, çfarë i duhen, çfarë i nevojiten, kur s'është fare në këtë jetë?

- E prapë është! - ngulmoi plaku i vendosur. -



Nuk është i njëllojtë, nuk ngjan me një të vdekur të zakonshëm, nuk është si të gjithë të vdekurit e tjerë. Përveç skeletit eshtor, këtyre s'u mbetet asgjë në këtë botë. Të zë tmerrri t'i shohësh. Kaq të shëmtuar e të frikshëm janë. Kurse këtë ta ka ënda ta vështrosh. Një mumie mistër bukurie, jo shaka.

Pas çiftit të të moshuarve, që largohen prej tij duke u ngrënë me fjalë, përpara eksponatit Homo Sapiens ndalen ca çaste një grua me të bijën katërvjeçare.

- O mami! Mami! Ky burri pse është aty brenda? Pse e mbajnë aty? Ka bërë ndonjë faj? Pse nuk lëviz?

Mumies i vjen paksa për të qeshur me fëmijën naiv. Ngre lehtë çuditërisht krahun e ngrirë kallkan dhe përshëndet vajzën e vogël, që e trembur nxiton të fshihet pas trupit të së ëmës.

Një çast të papritur, pamja turbullohet, sqarohet fill, si mjegull e shpërndarë dhe Rubi shquan sërish, në vend të vetes, burrin Homo Sapiens të fotografisë.

Ç'po ngjet kështu me mua?! pyet teksa përmendet i llahtarisur. Mezi hap kapakët e rënduar plumb të syve. E sheh veten në dhomën e tij të gjumit. Merr thellësisht frymë, si të mos ngopej. Vështroon orën e murit. Dy e natës. Ende tepër herët për t'u ngritur. Kthehet në anën tjetër. Por gjumi s'e zë.

Rubi e sheh sërish veten të ulur ballë për ballë Riçardsonit. Çuditërisht, këtë herë, ndryshe nga ç'kishte pandehur, nuk ka vuajtur për ta takuar. Vënë në pritje, Riçardsoni s'ia ndan sytë e picërruar, si të mos shihte mirë.

- Pa hë! - i drejtohet pas një pauze të paqetë.

- I mungon gjësendi tjetër muzeumit tonë emërmadh?

- Ah, jo, - nxitoi ta ndërpresë Rubi me një lëvizje mohuese të krahut në ajër. – Jo. Kam ardhur për tjetër gjë sot.

Riçardsoni, si të ishte një hetues i regjur, s'ia ndan sytë.

- Zoti Riçardson! Për kauzën e madhe të Homo Sapiens-it, kam vendosur të flijohem. Ofroj, pa asnjë shpërblim, trupin tim. Jam krejt i gatshëm të më balsamosni, të më bëni pjesë të eksponatit “Man and manlike apes, order primates”.

Propozimit tronditës të djalit Riçardsoni nuk shpejtoi t'i përgjigjej, thua se qe në kërkim të frazave të përzgjedhura, që i përshtateshin natyrshëm solemnitetit të situatës së pazakontë, në të cilën qe përfshirë papritur e pa kujtuar.

- Miku im, Rubi! Jua kam thënë e përsëritur gjithnjë në takimet tona.

Djali mprehu veshët për të dëgjuar më mirë.

- Homo Sapiens-i, - vazhdoi Riçardsoni, - është qenia më pak interesante, më pak tërheqëse, më pak e kërkuara, më pak e dëshiruara e muzeumit tonë. Nga ana tjetër, vizitorët, ata vetë, Homo Sapiens-ët, janë më të interesuar, duan më shumë, madje adhurojnë kafshët, shpendët, zvarranikët dhe çdo qenie tjetër, përveç vetes, natyrisht. Besoj keni dëgjuar për testamente në shumë milionë dollarë që të pasurit u lënë qenve të tyre, maceve, majmunëve, krokodilëve, deri edhe gjarpërinjve boa, në vend që ta bënin këtë për Homo Sapiens-ët fëmijë, jetimët a të sëmurët e vegjël. Pra, kuptimi i kësaj që po ju them është i qartë. Të kishe qenë ti, bie fjala, një shimpanze, orangutang, gorillë, majmun a çfarëdo kafshe tjetër, do të të kishim mumifikuar, do të të kishin balsamosur menjëherë, në çast, pa mëdyshjen më të vogël, madje me kënaqësinë më të veçantë. Së dyti, ligjet e këtushme janë tejet të ashpra. S'do të lejonin kurrë mumifikimin e një trupi të gjallë, qoftë edhe të dhuruar prej vetë personit. Gjërat vështirësohen edhe më shumë kur është fjala për një djalosh që sapo ka mbushur njëzet e pesë vjeç. E megjithatë...

Riçardsoni ndryshoi befas ton kur viktima

e pritshme shpërvoli fill turinjtë, u pezmatua thellësisht, u ngrys frikshëm, a thua se nga çasti në çast do të vraponte drejt kanatave të hapura të dritareve e do të hidhej përtej tyre, nga lartësia e frikshme prej disa dhjetëra katesh.

- E megjithatë... *Dum spiro spero!* Mund të shpresojmë në ndihmën e miqve të mi të drejtësisë! Mbase na lejojnë... Ku ta dish?

Leja qe dhënë. Do ta mumifikonin. Do ta vendosnin përgjithnjë brenda eksponatit të mamiferëve në The National Museum of Natural History.

Ndërsa po ia lidhnin fort duart e këmbët me kaishë të mëdhenj prej lëkure, djali dukej shumë i prekur, shumë i tensionuar, rënë në depresion të thellë. Tani që ideja, vendimi, dëshira, ëndrra, po mishërohej, po bëhej reale, e prekshme, e besueshme, e padyshimtë, ai nisi të frikohet. Mos në gjendjen e rënduar të të sëmurit psikik, të të deprimuarit a gati të marrëzisë, skizofrenisë, kishte marrë një vendim fatal të pakthyeshëm?

Kur u siguruan se viktima s'mund të bënte as lëvizjen më të vogël, mumifikuesit (tani më të shkujdesur) nisën të flisnin lirshëm, të shpenguar dhe pa drojë përpara njeriut që do të balsamosej pas pak.

- Në fillim, si procedurë, heqim zemrën, pastaj mushkëritë, - foli i pari i mumifikuesve.

- Jo! Do të ishte më mirë të hiqnim së pari të brendshmet. Mëlçi, shpretkë, stomak e zorrë. Përndryshe, fusha operatore do të kontaminohej dhe procesi do të ndërlikohej. Pak a shumë, le të ndjekim të njëjtën procedurë me atë të balsamimit të kafshëve. Kemi goxha eksperiencë, apo jo? - ndërhyri me takt, i kujdesshëm në tonet e shpjegimit, mumifikuesi i dytë.

Mjeshtërit e balsamimit, krejt të ftohtë emocionalisht, vazhduan bashkëbisedimin profesional, për hir të së vërtetës traumatik e shokues për viktimën (edhe pse i ofruar vetë për flijim), pa e vrarë mendjen, pa u shqetësuar shumë se ajo qe ende zgjuar, pra ende jo nën narkozë dhe se i dëgjonte të gjitha. Por ç'rëndësi kishte tani ky fakt i rëndomtë?! Djali qe lidhur paq duar e këmbë dhe shpejt do ta vinin në gjumin e vdekjes.

Ankthi i Rubit, si një vërshim i papërmbajtshëm, i vrullshëm, po rritej frikshëm nga sekonda në sekondë. Një kohë nisi të dridhej fort si nën elektrohok e të mbulohej nga djersët. Oh, si po i rrihte zemra! Pushtuar nga paniku, mend po i çante gjoksin, e tmerruar edhe ajo, si të kërkonte t'i shpëronte bisturisë së mumifikuesve.

Oh, Zot! Çfarë bëra! Në djall vështrimet e munguara të të tjerëve! Jam tepër i ri për t'u larguar nga jeta! Sa vite humbas kështu?! 60? 70? 80?...

I erdhën ndër mend, i veguan, iu shfaqën krejt të gjalla, rrugët e qeta, të bardha, plot diell të qytezës së vet. Shëtitorja buzë Mesdheut. Vargu pa mbarim i të rinjve që shëtisnin, bisedonin të hareshëm e qeshnin të lumtur, shend e gaz, pareshtur.

O perëndi! Ata do të jenë. Do të rrojnë. Do të mbarojnë shkolla, do të burrërohen, do të martohen, do të lindin fëmijë, do t'i rrisin e do t'i martojnë ata, do të plaken. Kurse unë? Përtësisisht brenda ekspozesë, në seksionin “Man and manlike apes, order primates”. I vështruar nga të gjithë, i admiruar, a ndoshta edhe i përbuzur, nga miliona vizitorë (A nuk deshe, a nuk ëndërrove pikërisht këtë, a s'përgjërohesh e luteshe qoftë edhe për një shikim të vetëm njujorkez?!), por sidoqoftë i pafrymë, i pajetë. E di. Ruajtur mirë, konservuar optimalisht, fiksuar përgjithnjë në moshën e ngrirë tashmë të të njëzet e pesë pranverave. Një mistër bukurie, kallkan i ftohtë, si një skulpturë mermeri e përjetshme. I shikuar, i kundruar, i vështruar nga të tjerët, por pa mundur vetë ta bësh këtë. Të të kuptojnë, të ndiejnë thellë në palcë tragjedinë tënde, t'u dhembë ajo tmerrësisht, të vuajnë e të pikëllohen për këtë e me siguri edhe të përloten dhe ti të mos shohësh, të mos dëgjosh e për këto arsye të mos kuptosh, thjesht sepse je i pajetë, i vdekur, një kufomë e balsamosur. Një mumie që buzëqesh, përjetësisht buzëqesh.

Vështrimi i ishte mjegulluar prej lotëve. Shqoi turbull, si prapa një velloje, bisturinë fatale që infermierja e instrumenteve ia zgjati kryemumifikuesit. Ky, teksa fishkëllente një melodi hit të kohëve të fundit, ngriti lart krahun që mbante shtrëngueshëm bisturinë, si shenjëtari që matet të qëllojë nga çasti në çast.

Bëheshin gati ta prisnin për së gjati, nga koka te këmbët, t'i hapnin gjoksin, barkun, t'ia nxirrnin jashtë të brendshmet dhe pastaj t'i flaknin tutje, si të pavlera, në ndonjë kazan të ndotur mbeturinash të spitalit. Djali u tmerrua.

- Mos! Mos! - klithi i llahtarisur. - Mos! Më zgjidhni! Më lini të shkoj! Dua të jetoj! Jo! Jo! Nuk dua të vdes!

Me përpjekje skajshëm të dëshpëruara, bëri ç'ishte e mundur të gllrohej nga kaishët e lëkurte që e shtrëngonin paq, por s'mundi. Krahu i kirurgut po ulej mbi gjoksin që i hidhej përpjetë. Ndali një çast, pak centimetra mbi të. Bëri fill dy-tri lëvizje gjatësore që shëmbëllenin dukshëm me një provë saktësimi të prerjes, incizionit të afërm. Djali ulëriu thekshëm, plot dëshpërim.

Oh, Zot! Oh, tmerr!

Infermieri i narkozës së kafshëve i ngjeshi edhe më fort mbi fytyrën e zbehtë, mbytur në djersë akull të ftohta, maskën e gazit gjumësjellës.

U përpëlit fort nën të. Po i merrej fryma. Po mbytej. Ndjeu prerjen, incizionin e gjatë (çuditërisht të padhembshëm) nga sternumi e gjer në pubis, gjakun t'i vërshonte, të qeshura doktorësh mumifikues, biseda tmerrri dhe... asgjë më. Humbi përgjithnjë.

Psikanalisti ishte përhumbur në rrëfimin drithërues të djalit, që shprehte ende qartazi ankth, shqetësim e vuajtje të thellë të brendshme.

- Të tillë ëndërr të tmerrshme s'kam parë kurrë në jetën time. Ende vazhdoj të jem i terrorizuar, - shpjegoi djali, sikur t'i përgjigjej pyetjes së heshtur të profesorit.

- Të këtilla, të frikshme, kanë qenë ëndrrat e kohëve të fundit?

- Po. Të tilla. Tërë drojë e ankth, shtrihem të fle. E shpesh zgjohem i llahtarisur në mesin e një ëndrrë makthi, gjithnjë të frikshme. Mezi e mbledh veten paskëtaj.

Profesori, teksa mendohej, bëri disa ecejake nëpër dhomë, sikur të donte të përqendrohej më shumë ashtu.

- Dëgjo, djalë, - iu drejtua pas pak. - Brenda teje, në thellësi të subkoshiençës sate, janë në një konflikt të ashpër, ndeshen egërsisht për jetë a vdekje, qyteza jote e dashur, gjithçka përmban brenda kujtesës së saj të gjatë dhe qyteti 12-13-milionësh, hëpërhë i ftohtë, shpërfillës, indiferent e ndoshta, pikërisht për këtë shkak, edhe më tërheqës, edhe më joshës, por gjithsesi krejt i bindur se këtë betejë ka për ta fituar ai. Vetëm ai. Përpjekjet e qytezës janë skajshëm të dëshpëruara, të dhembshme. Bën të pamundurën mos të të lëshojë nga duart, të të mbajë fort në gji të saj edhe për shumë vite të tjera, por, në të njëjtën kohë, vetë ajo e ndien nga dita në ditë se do ta humbasë pashmangësisht këtë betejë, këtë luftë shpirti. Ky konflikt, i dhembshëm në palcë, akumuluar në subkoshiençë, sa vjen e rritet nga dita në ditë, potencohet, bëhet kërcënues, terrorizues, shantazhues, i frikshëm, zmadhohet për nga dimensionet dhe... mbërrin çasti fatal i shpërthimit gati-gati apokaliptik. Në një situatë të tillë të rënduar psikologjike janë gjithnjë të pritshme vuajtjet e sferës psikike, që nga shfaqjet neurotike dhe deri te krizat e depresionit apo skizofrenisë. Atëherë, për mos të të lodhur më shumë, se edhe kështu je boll i ngarkuar emocionalisht, lër hëpërhë qytetet e mëdha shumëmilionëshe, gjithnjë të zhurmshme, të ndotura e stresuese. Shko disa muaj dhe jeto në fshatin amerikan, në Country... Kur një ditë të ndiesh se të ka marrë malli për këtë gjigant, gjithsesi të sertë, të ftohtë, mospërfillës, si një bukurosh i përkëdhelur dhe i llastuar, kthehu dhe mbase ëndrrat e tua kanë për të qenë të bukura.

- Po barna, është e nevojshme të marr? - pyeti djali, ende me ankth.

Profesori mohoi i vendosur.

- Ah, jo. Janë të panevojshme. Jeta në fshat do të të ndihmojë. Njerëzit atje janë ndryshe nga ata të metropoleve. Të dashur, të ngrohtë, të hapur, miqësorë, të ndjeshëm, komunikues, të ngjashëm me njerëzit e qytezës sate. Ti shpejt do të mësohesh me jetën e re, jam i bindur dhe po aq shpejt do të rikthehesh në metropolin amerikan, do të kthehesh, bir, sepse je i ri. Mosha e re, ky është avantazhi yt. Vetëm djemtë e vajzat e reja mund ta përballojnë këtë vend, këtë gjigant të sertë e të vështirë për të të pranuar. Mbaj mend! Amerika është një planet tjetër, me ligjësi të shkruara a të pashkruara, që s'ngajnë me pjesën tjetër të botës. Është toka e shenjtë e të rinjve.

Para se të linte qytetin shumëmilionësh, djali mendoi të bënte shëtitjen e fundit. Si edhe më parë, e njëjta pamje, e njëjta atmosferë. Përreth, edhe pse jo fundjavë, gjithnjë njerëz të shumtë. I kalonin pareshtur në brinjë, majtas, djathtas, përballë. Të ftohtë, siç qenë. Indiferentë, shpërfillës, krenarë, narcistë, të pandjeshëm, të gurtë. Megjithatë, për çudi, këtë herë nuk po i linin përshtypjen e parë.

Atë mbrëmje do ta linte gjigantin zhurmëmadh. Do të udhëtonte për në *country*. Qe i dëshiruar të rigjente qetësinë e mbase edhe vështrimet e humbura, si atje, në qytezën e largët, që e përkëdhelnin ëmbëlsisht erërat e fladat e ngrohta të Mesdheut.

Atje, në *country*, thua do t'i kujtoj, gjithnjë e më shpesh, këto rrugë, këto grataçuela, këto drita vezulluese? Manhattan, New Jersey, Brooklyn, Capitol, White House, Statue of Liberty, Wall Street, Washington, The National Museum of Natural History...

Përpara syve, si në një film, po i kalonin pamje pa mbarim. Vallë, nisi të më marrë malli qysh tani? Thua? Mall?! Dëshirë?! Dëshirë për t'u rikthyer?!...

Janar 2009

Marrë nga libri me tregime dhe novela “Një natë jetë” (Onufri, 2009).

Po të due unë

Ba me dashtë unë
pranvera zgjohet në mes të dimnit.
Andrrat jargaviten si lule kacavjerrese
ndër muret tuej të naltë.
Ba me dashtë unë liria jote
del prej guackës
e shndrit perlë në qafën teme
të bardhë.
Ba me të dashtë fort unë
jehona e stuhisë tonë
ndihet deri në agim.
Dielli lind në gojën tande
e vdes në gjinjtë e mi.
Por unë nuk due
se poetja në mue, fle nën borën e trishtimit
e të rrëshqet shpinës
veç kur ti e shkrin.

Prit

Para se të shkërmoqet
qenia jeme ndër duer, prit.
Më thuej, a të shkrep andrra ndër sy,
po buzët, a belbëzojnë
fjalë të pakuptimta?
A e din si m'zhvoshket shpirti?
A i kena na t'dy të njëjtat frikëna?
Prit, para se të rrëshqasin
manteli i mndashtë,
më thuej a e din si lkura
gërvishtet?
Çmendja asht gjendja ku strehohem
ndonji natë ,e para se të shembesh
mbi mue, prit...!
Pse me m'vra e me m'dashtë
të duhen armët e mia,
shpirt.

Jam grueja e dashnive t'marra

Jam grueja e dashnive të marra,
puthjeve të thella,
pasioneve të çmenduna.
Jam grueja që duhet me m'dashtë
e me m'drashtë
jam ferr e parajsë bashkë.
Më shih, më njih e m'lut
jam pema ma e lashtë
me rranjë në kohë të vjetra,
as gjallë, as e vdekun nuk bahem tjetra.
Jam grueja që të shoh drejtë n'sy
e prej se s'mundesh me m'pasë
shkrumbohesh fill njaty!

Si mundem me ta shpjegu vetminë
kur mes dy pemësh të egra
bien gjeth të brishtë?!

E kena ditë mirë se bota zhurmon,
se njerëzit mbrenda shtëpive
u ngjajnë historive
të përditshme.
E kena ditë se stinët ndërrohen,
që vitet kalojnë,
lëkura tkurret,
andrrat bymehen.
E kam ditë që një vehte e jotja
kthehet, më gjen e ka frikë
se mos kam harru si shknitë
kujtimi jot në mue
një zjerm të pashuem.
Veç një gja kurrë nuk e dite,
se ti nuk ishe dashnia,
por dashnia e tana dashnive,
I dashtun!

Si me t'folë?

Tash që kryet m'peshon,
mbi supe.
Jam e zemrueme me vedin,
me kët' grue
që mbart valixhe me andrra mbi shpinë.
A të flas si unë,
që s'pushoj tue përtypë mendime,
apo veç për një herë, po ta l'shoj thirrmen,



ARJOLA ZADRIMA

Po të due unë

poezi

që s'kam me e thanë kurrë ndër sy...

Hape shpirtin.
Kam nevojë për ty!
Perlat

A e mban mend kur me frymë t'marrun
pushtueshëm m'veshe gjijtë,
e ndër flokë t'artë
i gjarpnove gishtat,
mbi buzë t'lagshta
zgjove meloditë,
tue rrokullisë çastet
që flejshin ndër andrra?!

Janë perlat që nuk i thamë!

Hukatje
Asht ende dimër,
sado i kuqërremtë të jetë qielli
dashnia e hukatun ngrin.
Tash dhimbjen jam mësue më ia
ngjitë jastëkut
ku prehen andrrat
që pashë,
e prej gjumit m'asht çue vetja
ajo që fle trishtë,
ende pa zbardh,
tuj më këshillue pa bzâ,
mbështille mirë zemrën
asht ftohtë jashtë.

A po t'bjen n'mend për mu?

Me ndje mungesën e një përqaqimi,
e mos me e kërku,
me ndje dëshirë me folë
e mos me bzâ,
me ndje një ofshamë në gji,
e mos me kja,
më ndje një mall prej larg,
pa mujtë me e shu,
me ndje tue rrjedh një plagë
pa gjakue,
me ndje kohën tue shku
e mos me iu vu mbas,
me ndje kaos
pa zhurmue,
me ndje stuhi,
ortek në shpirt e mos me u ndi,
me ndje një kputje pa çilë sytë
e kurrë mos me u anku,
me ndje një frikë të thellë
me të lanë pa frymu,
me ndje një dashni të naltë
e mos me e kallzu,
me ndje, me të ndje
me të dashtë e në gjys të natës
me u zgjue sa më të lshue za
veç pak,
tash qi trishtimin e kam në prag
a po të bjen në mend për mue?

Ta dijs...

Kur e ndjen se nuk i përket kësaj bote,
arratisu dhe merr me vedi diellin,
ik dhe merr me vedi qiellin,
zhduk u buzëqeshjen tande
lenu si jehonë
zemrave që pëshpërisnin.

Ik
dhe mos prit dromca dashniet
kur prej teje
ke dhanë shpirtin.

Më thuej!

Më thuej si ulërihet,
pa i thy xhamat, pa i përkul vitet mbi lot,
ma thuej, po pres.
Du me e ditë si shkundet shpirti
pa ja shkëputë degët kësaj peme
me rranjë jashtë,
po thahet,
po fiket,
po vdes,
tash nuk bjen ma as shi,
as zjarr,
as hi,
askush...
Këndeje s'ka ma hapa të randë me lanë
gjurmë,
veç stinët kalojnë mbi shpinë,
çelin lule,
digjen male,
thahen liqene të tanë e mandej bien gjethet,
veç stinët prekin nudon e një grueje,
që s'din me ulëritë!

Peshkatarit

A i keni kallzue atij
për velën e flokëve të mi?
Për rrjedhën e pandalshme të Bunës,
e tërbimin e saj.
Baticat e lëkurës
metafizikën e lundrimit tim të pambrritshëm
në amë të shpirtit tij.
I thoni se ka një urë në përfundim
sa me kalue
kufinin e vetmisë.
A i keni kallzue se kam krisë?

Ekziston një andërr e çeliktë
ku të pres çdo natë,
tue pëshpëritë me vedi,
“eja darka asht gati,
lene n'qoshe lamtumirën...!”

A po m'len?

Ndjej se due me t'i dashtë
bulat e gishtave,
ahtin e parë,
vjeshtën e artë,
deri gjethin që t'ka ra.
Po due me ta çelë mbrenda buzëve
gonxhen e fjetun,
gjumin due me ta ndukë në gushë,
borën e kërcellit me e shkri në
gjuhë.
E tash që qielli yt përkundet
në djepin e andrrave,
ndiej se due me të dashtë,
ngadalë,
deri në fund.
A po m'len?

MUNGESË

Kur i Zoti i shpisë nuk asht ma
merimangat mblidhen qoshesh,
nuk ke kohë me pa rrjetat e uluna deri
poshtë.
Dyert kërcasin,
bravat hingëllijnë,
dritaret rrinë të avituna.
Nji në fund nuk mbyllet.
Qeni leh natën vonë e ti shkërmoqesh
prej dhimbës.
Gjithçka mbi kry,
nji qiell të vranët mbi supe,
nji kalë mërzi mbi shpindë.
Pa dalë drita shihesh n'pasqyrë
dikush duhet me të pa tue qeshë.
Sa veshë maskën e butë,
ndin mbas krahëve
“Mam si ke njuhë?”
Kur i Zoti i shpisë ikë
zemrat rrinë ndezë.

Arlekin

Jam grueja e atij që s'më njeh e s'din
se andrrat e mia
ngjallin shpirtën t'vdekun.
Jam nana e parë dhe e fundit e tim biri.
Parmaku i time bije.
Isha dashnoria e burrave që s'ekzistojnë,
e s'dinë si kapërcehen male me një frymë.
Atyne që më deshtën u fala
veç nji poezi.
Boheme fatesh lidhun.
Zgidhun mendsh, ogur i fatit tem.
Isha, jam dhe do te jem
ajo që mbys veten,
veç mos me kenë arlekini i dramave
pa autorë.
Jam grueja e pamarre,
që dashnisë ia ka mbjell farën bash në bark
të vet.
Vdes e ngjallem
nanë e Tim biri.

ROBIN

Kisha me i ndalë
avionët e gjithë botës
nëse aty udhëton dashnija.
Por dashnia asht rritë
e ban dritë
veç nji zemër e vogël mrenda saj.
Dashnija të sheh në sy e ka frikë,
të rrokë në gji dhe ikë
e heshtun,
më një buzë të plasaritun
e mendje të pendueme,
ikë e ti kthen krahët
e ti veç i buzëqesh,
vesh më vesh zemër copëtueme,
me dorën në ajër
tuj u lutë mos të jetë e fundit, lamtumirë.

Gjallno

Në zhguallin e dhimbës,
heshtja je ti.
Ska ma fjalë të sigurta,

as hapa të randë.
Nji hap para, tri mrapa.
Mësohesh me i hesht vitet,
tuj zgju shekujt e vetmisë mortore.
Janë ceremoni të vogla pa fjalë.
Lutesh pa fjalë,
dhe pa u lutë ikë prej kësaj bote të ligësht.
Tanë presin që ti me ra,
tue i thy kocat e shpirtit.
Njatë çast zgjohesh,
ndjen shiun ftyrës,
Stuhitë mbi shpatulla
dhe ecë ne krahun e kundërt të erës.
Një pëshpëritje prej nëntoke
I mbush aortat me jetë.
-Gjallno n'se ende s'ke vdekë!

Ndonjherë

Në kjoftë gjallë
e i ke lexue këto rreshta,
dije se kjo poezi kje mënyra e vetme
me t'ishue za
përmes territ...

I dashtun

Ti veç më kallzo
si e çmend kohën pa ne,
si i përpin me sy stuhitë që msyjnë,
sa uragane të flenë në shpirt,
sa tallaze përmytin zemrën tande.
se unë,
heshtja jote pagane,
unë, grueja mjerane e fatit,
me të strukë një grimë në gji,
bahem liria jeme
e vij!

N'gjysë shtizë

A e ke provue me të lidhë jeta për krahësh?
Tue të zhvendose në polin e saj te veriut,
e ti ecë zdashë në malet me borë,
tue u gjakosë.
Gishtat e shpirtit të mërdhasin aq fort,
sa mes hapësina diellore,
krijohet morth, e në mendim mort,
e ske me çka me e kuru,
veç të duhet me ecë,
me gjoks para tue e sfidu kjoftë për hatër..
Në kjoftë se nuk e ke provue
me u zgjue e ngrime,
e me përtyt akujt e heshtjes tande,
hesht,
se nuk e din si jeton njeri në gjysë shtizë.

...edhe unë i kam dashtë burrat e bukur,
me flokë valë,
shpatullgjanë,
buzëpërdredhun e nazeli.
Por mbas tyne ishte gjithmonë vjeshta,
mbas tyne kishte rrebesh,
stuhi,
mbas tyne vinte dreqi e i biri.
Mbas tyne porta nuk mbyllej ma,
brava heshtte,
çelësi nuk tringëllinte nëpër natë.
E ti vdes kah pak,
si qiri shkrihesh territ pafund,
e s'pyt pse trishtimi ka një mbretni aq të
popullueme.
Ata s'janë,
s'dinë,
s'bajnë.
Ata veç të pushtojnë,
prej atyne pushtimeve shekullore
sa të ndryshojnë e ti ma nuk ngjan as me
Marinë
e as me vedin.
Ikin mbas çdo fundi të shkurtë
e të vjedhin kohën.
I kam admirue burrat e bukur,
por ti erdhe vonë, bash at'herë kur msova
me u dashtë.



HENRY MOORE, *Të fjetur rozë dhe jeshilë*, 1941. COLLECTION TATE, LONDON.

Në mbremjen e 11 shtatorit 1940, Henry Moore dhe bashkëshortja e tij, Irina, u larguan nga shtëpia e tyre Belsize Park dhe u drejtuan për në qendrën e Londrës për të darkuar me miq. Çifti e bënë rregullisht këtë, por rrallë merrnin London Underground në vend të makinës së tyre (e cila ishte duke u riparuar).

Rrugës për në shtëpi, çifti Moore u

habit kur pa londinezë të grumbulluar mbi platformat e secilit stacion. Ishte nata e katërt e sulmeve ajrore naziste që tani njihet si Blitz, dhe civilët ishin mbledhur nëntokë për të qenë të sigurt.

“Kur arritëm në stacionin e Belsize Park”, kujton Moore vite më vonë, “nuk na lejuan të dilnim për një orë për shkak të bombardimeve. E kalova kohën duke parë



HENRY MOORE, *Vizatimet e Strehës: Mama e ulur me fëmijë*, rreth 1941.

radhët e njerëzve që flinin mbi platforma. Nuk kisha parë kurrë kaq shumë figura të shtrira... Mes tensionit të zymtë, vura re grupe të panjohurish të formuar bashkë në grupe intime dhe fëmijë duke fjetur pranë trenave që kalonin”.

Kjo skenë do të frymëzonte një prej arritjeve më të mira të karrierës së Moore-it: vizatimet e Strehës. Këto vepra e mbajtën të zënë për rreth dy vitet e ardhshme. Shfaqin masat londineze duke u strehuar në stacionet e Underground prej bombave sipër. (Blitz-i vazhdoi deri në Maj 1941, duke i lejuar Moore-it mundësinë të vizitonte më shumë stacione të tjera përgjatë rrjetit përveç Belsize Park.).

Vizatimet shënohen me dhembshuri dhe njerëzi të madhe. Trupat e figurave ndonjëherë duken të ndërthurur me njëri-tjetrin, bashkuar nga ritmet e valëzuara të bojës, lapsit, dhe bojërave të dhjamt të Moore-it.

Kur artisti i tregoi një dy shembuj të hershëm Kenneth Clark-ut, drejtorit të Galerisë kombëtare, ky i fundit gati u përlot. Clark-u, i cili në atë kohë ishte edhe kryetar i War Artists' Advisory Committee (WAAC), i kërkoi Moore-it të prodhonte një seri të tërë vizatimesh të së njëjtës temë.

Moore pranoi – pjesërisht sepse shpërthimi i luftës kishte ulur mundësinë për të siguruar materialet e nevojshme për të punuar në mediumin e tij kryesor: skulpturën. Pa kaluar shumë kohë, ishte përhapur fjala për vizatimet e Strehës, dhe filluan t'i lakmonin koleksionistët privatë. Moore vëreu në Mars 1941 se “në këtë moment, ka më shumë kërkesë se ofertë. Nuk ka qenë kurrë kështu më parë me veprën time”.

Vitet e fundit, kanë përparuar një numër teorishë që sugjerojnë se frymëzimi i Moore-it për vizatimet, në fakt, kishte ardhur përtej London Underground. Disa kanë cituar një ngjashmëri me fotografitë e Robert Capa-s të republikanëve të mbledhur në platformat e metrove të Madrid-it gjatë Luftës Civile Spanjolle. Prej atmosferës spektrale, të tjerë i kanë krahasuar strehat me mumiet egjiptiane, ndërkohë që vet Clark tha se i kujton trupat e zhvarrosur në Pompeii.

Në raste të veçanta, subjektet i bëjnë jehonë skulpturave të vetë karriera e hershme e Moore-it. Te *Vizatimet e Strehës: Mama e ulur me fëmijë*, për shembull, iu kthye motivit të tij më të parapëlqyer: një mama me fëmijën e saj.

Një pjesë e madhe e rolit të Clark-ut te WAAC ishte të inkurajonte artin që përforconte moralin civil në një kohë kur ishte i lartë kërcënimi i pushtimit gjerman. Ishte gjithashtu për të krijuar një qëndrim të dhembshur në Shtetet e Bashkuara për telashet e Britanisë në një kohë para se Amerikanët t'i bashkoheshin luftës (që ndodhi vetëm në Dhjetor 1941).

Është e vështirë të thuash saktësisht sa sukses pati Clark-u te të dy këto qëllime, por historiani i artit, David Alan Mellor, ka argumentuar se “pikturat e strehës filluan të ishin të dobishme si formuese opinionesh”. Publiku britanik i pa për herë të parë kur një përzgjedhje e tyre u paraqit te Galeria Kombëtare në Prill 1941, të njëjtin muaj kur katër shembuj të tjerë u çuan në New York për një ekspozitë të organizuar nga WAAC në Muzeun e Artit Modern, të quajtur *Britania në luftë*.

Paqja u arrit në 1945, dhe në vitet në vazhdim Moore u mbajt si një prej artistëve kryesorë të botës. Ama, vizatimet e Strehës ishin po aq të njohura sa çdo skulpturë që prodhoi më vonë.

Vizatimet kapnin fabulën e ‘shpirtit të Blitz-it’ – të britanikëve që i rezistonin stoikisht çdo gjëje me të cilën i sulmonin nazistët, dhe me kohën, përforcuan idenë e këtij shpirti për brezat e ardhshëm.

Më shumë se specifik për një konflikt të vetëm, vizatimet e Strehës shërbejnë, më gjerësisht, si imazhe universale të njerëzve që bashkohen në kohë fatkeqësie: momente qëndrese të brishta, por në fund, të forta.

Ushqimi është një sjellje njerëzore po aq ekskluzive, sa gjuha. Sipas Claude Lévi-Strauss¹ gatimi, ashtu si gjuha, është një formë universale e veprimtarisë njerëzore. Nëse nuk ka shoqëri pa gjuhë, nuk ka as shoqëri që nuk gatuan. Kështu ushqimi mund të konsiderohet si një ansambël tekstesh karakteristike për një shoqëri të caktuar. Çdo përbërës, çdo pjatë, mënyra e organizimit të vakteve, gjithë elementet e një kuzhine specifike tradicionale, janë të lidhura reciprokisht, ndikohen si nga mënyra e mëparshme e ushqimit ashtu dhe nga dukuri te reja, interpretime të reja të një pjate apo recete te caktuara².

Në Testamentin e vjetër, te “Gjeneza” gjithçka nisë rreth një molle, kurse te “Zanafilla” shkruhet “Çdo gjë që lëviz dhe ka jetë do t’ju shërbejë si ushqim.”³ Gjenden shumë proverba te librat e shenjtë që përbëjnë këshilla të vlefshme për ushqimin dhe të ushqyerit, megjithëse të gjithë e dimë se te Zoti nuk shkohet nëpërmjet të ngrënit. Megjithatë është interesante se, për të formuluar shprehje sa më të sofistikuara estetikiisht për dashurinë, janë përdorur gjithnjë struktura gjuhësore që kanë lidhje me marrëdhëniet tona me ushqimin dhe me shijet në përgjithësi. Kështu përshembull te “Kënga e këngëve”, thuhet: “Më mbani me pite rrushi, më përtërin me mollë, sepse unë vuaj nga dashuria”.

Vepra letrare më e moçme e botës përëndimore “Punët dhe ditët” e Hesiodit ka të bëjë kryesisht me marrëdhënien midis drejtësisë dhe rregullimit të jetës bujqësore. Në të, lufta për ushqim është ajo që përcakton jetën, dhe uria është një realitet i egër që i shtyn gjërat të ndodhin.

Te “Odisea” e Homerit ka vargje të tëra ku përshkruhen ushqimet që gatuheshin e që konsumonin kandidatët, në shtëpinë e Ulisit.

Letërsia romake fokusohet kryesisht në zakonet e ngrënies së klasave të larta të shoqërisë. Përshkrimi më i famshëm i një vakti romak është ndoshta darka e Trimalkios në poemën “Satyricon” të Petronius Arbiter. Aty gjendet një ekstravagancë e tillë që pak mund t’i ngjasojë edhe realiteti gastronomik i më të pasurve të sotëm.

Martiali, por edhe Katuli në veprat e veta poetike përshkruajnë servirjen e darkave që nisin me sallata me marule, presh, nenexhik, rukola, skumbri, vezë të prera në feta dhe sisë dose të marinuar. Pjata kryesore kishte copa mishi keci, zarzavate, fasule, dhe një pulë me proshutë, e ndjekur nga një ëmbëlsirë me fruta të freskëta dhe verë të cilësisë së mirë.

Por për t’u njohur më në imtësi me këtë traditë, duhet konsultuar koleksioni i pasur i recetave romake që i atribuohet Apicius⁴, i cili qe shëndërruar në sinonim të gustatorit.

Në letërsinë mesjetare mbetet simbolike dreka *pantagruelike*. Kështu quhet ajo drekë që është e denjë për Pantagruelin, protagonistin e romanit “Gargantua e Pantagruel” të Francois Rabelais (1494-1553). Dreka pantagruelike është përfaqësuesja e këtij personazhi gjigant, me një oreks të frikshëm.

Kurse te “Titus Andronikus”, Shekspiri tregon për hakmarrjen më të nxehtë të servitur nga gjenerali Titus, që shfaqet si kuzhinier dhe që i fton mysafirët e tij të hanë një ushqim që “do t’ju mbushë stomakun”. Në fakt, byreku që ai i ofron është bërë nga kockat e bluara, gjaku dhe kokat e pjekura të dy djemve të Tamorës. Pasi Tamora ka ngrënë, Titus deklaron se ajo sapo ka ngrënë “mishin që ajo vetë ka rritur”.

Po kaq e tmerrshme është edhe receta që gatuajnë shtrigat në kazanët e tragjedisë “Makbeth”.

Por le të kthehemi te hedonistika e të ngrënit dhe të pirit në letërsi dhe veçanërisht te letërsia e gjuhëve neolatine, e cila mbetet e famshme për tonet e larta në të kënduarit që i bën ushqimeve, pijeve, aromave dhe erëzave të ndryshme.

Shfaqen kështu në letërsi, personazhe dhe situata të lidhura kryekrejt me mënyrën e të ushqyerit. Kështu përshembull në veprën “Il

¹ Claude Lévi-Strauss (1908-2009) antropolog francez.
² Parasecoli, Fabio. Culinary cultures of Europe” Identity, diversity and dialogue. Council of Europe, 2005. F.11
³ Zanafilla 9:3
⁴ Apicius, i njohur gjithashtu si De Re culinaria ose De Re coquinaria është një koleksionist i recetave romake të gatimit, të cilat mund të jenë përpiluar në shekullin e pestë të erës sonë.

Nga parathënia e antologjisë (Botime Fishta, 2024. Mbështetur nga Qendra Kombëtare e Librit)

“SHIJE, PIJE DHE AROMA NË LETËRSINË DHE ARTIN SHQIPTAR”

nga Elektra dhe Stefan Çapaliku

giorno“ të Giuseppe Parinit⁵, protagonistin i saj shkon për drekë në shtëpinë e një zonje, ku është rasti i duhur për t’i dhënë shpjegim ushqimeve nga më të rafinuarat. Nga ana tjetër, Jorge Luis Borges i kushton vargje të paharrueshme verës, pijes së gëzimit.

Kurse Pablo Neruda, nga ana e tij, në odet e veta i këndon ushqimeve të thjeshta, si bukës, qepës, mollës, limonit dhe domates, pra produkteve të tokës mëmë që pushtojnë kuzhinat, hyjnë nëpër dreka, ulen, pushojnë ndër dollapë, mes gotave, dhe kriporeve të kaltra. Këto janë vargjet me të cilat pena e Amerikës së Jugut arrin t’i bëjë poetike dhe të rafinuara edhe drekat fshatare.

...asht një rropulli e kuqe
nji diell
i freskët,
i thellë,
i pashtershëm,
që mbush sallatat
e Kilit,
E martohet e gzueme
me qepën e bardhë,
dhe që të festojë,
len të rrjedhë
vojin,
djalin
e dishirit të pemës së ullinit,
mbi hemisferat e saj gjysmë të mbylluna...⁶

Guido Gozzano⁷ është përgjegjës për një vepër të vërtetë arti kushtuar ëmbëlsirave të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Ai i sheh ato si një tundim shumë i vështirë për t’u kontrolluar, veçanërisht nga zonjat e kohës. “Jam i dashuruar me të gjitha zonjat që hanë pasta në dyqanet e ëmbëlsirave. Zonja me

⁵ Giuseppe Parini (1729-1799). Poet satirik italian.
⁶ Fragment nga poema “Ode e domates” e Pablo Neruda, një përkthim të lirë të Stefan Çapalikut
⁷ Poet simbolist Italian (1883-1916)

gishtërinj pa doreza dhe që bëhen sërish vajza të vogla!” shkruan gjeniu post-dekadent, pasi kishte përshkruar, ulur në një kafene me një sy të mprehtë dhe ironik, vështirësinë për të mos u dorëzuar para mëkateve të grykësisë së të rinjve.

Trilussa gjithashtu, komedian dhe shkrimtar italian i shekullit të kaluar, ka shkruar një poezi të famshme me titull “La madre panza”⁸, duke treguar sesi nuk qe në gjendje t’i rezistonte tundimit për të lavdëruar ushqimin.

Në dialektin napoletan janë shkruar vargjet e një tjetër gjeniu si Eduardo De Filippo, i cili i kushton një poezi ragusë.

Më në fund, nga homazhet për ushqimin nuk mund të mungonte edhe Gianni Rodari, pedagogu dhe shkrimtari i dashur për fëmijët e çdo epoke. Te poezia “Buka” ai shkruan se:

Po të isha furrtar,
do doja të pigja një bukë
aq të madhe sa të ushqeja
të gjithë njerëzit që
nuk kanë çfarë të hanë.

Duket pra se në kulturën europiano-perëndimore nuk ka roman pa ushqim ose pa historinë e përgatitjes së një gjelle në kuzhinën e protagonistit, ose pa një darkë në restorant, ose pa një kafe në bar.

Pjesa e dytë e një monumenti tjetër letrar, “Uliski” i Joyce, hapet kështu: *Zoti Leopold Blum hante gjithë dëshirë të brendshmet e kafshëve dhe shpezëve. Pëlqente supën e trashë me të brendshme pule, plëndësat pikantë, zemrat e mbushura të pjekura, copat e mëlçive të lyera me galetë dhe vezë merluci të skuqura. Më shumë nga të gjitha pëlqente veshkat e qengjit të pjekura në zgarë, që i linin në qiellzë*

⁸ Barku nënë.

një duhmë të mirë e të lehtë urine.⁹

Periudha e modernitetit nuk lë pa prekë edhe kuzhinën dhe diskursin për mbi të. Një fushatë e vërtetë për afirmimin e një kuzhine avangardiste, me teori dhe propozime konkrete, filloi më 28 dhjetor 1930, kur Filippo Tommaso Marinetti botoi Manifestin e kuzhinës futuriste. Ky manifest njihet gjithashtu edhe si manifesti “Kundër makaronave”, të cilat provokojnë lemonti te populli italian. Sipas Marinetit “ne mendojmë, ëndërrojmë dhe veprojmë sipas asaj që pimë dhe hamë”.

Gjithashtu, teatri dhe kinemaja rezultojnë të jenë të mbushur me situata mbingopje apo urie ekstreme.

Në kinema përshembull, mjafton të permendim filmin ikonik “Gostia e madhe”¹⁰. Ai është një film satirik i vitit 1973, me regji nga Marco Ferreri dhe në interpretimin e aktorëve të famshëm Marcello Mastroianni, Ugo Tognazzi, Michel Piccoli, Philippe Noiret dhe Andréa Ferréol. Filmi përqendrohet në një grup miqsh që planifikojnë të hanë deri në vdekje. Ai satirizon konsumizmin dhe dekadencën e borgjezisë, duke u kthyer në një film që diskretiton instinktet bazë.

Një stacion tjetër i rëndësishëm në letërsinë moderne është libri i shkrimtares amerikano-latine Izabel Aljende “Afërdita” me rrëfime, receta dhe afrodiziakë të tjerë, të cilin ajo ia kushton “të dashuruarve që luajnë dhe... burrave të trembur e grave të dëshpëruara”.

Ushqimi në kulturën e shkruar shqipe

Në kulturën orale apo të shkruar shqiptare ushqimi gjendet përgjithësisht në forma mjaft të himnizuara. Apoteozat kushtuar ushqimeve janë të lidhura me kushtet shumë të vështira nëpër të cilat është përshkruar mbijetesa e fisit tonë. Por, ama, nuk kanë ngelë pa lënë gjurmë edhe ditët e bukura dhe me diell që ky popull kaloi, veçanërisht para pushtimit turk.

Në folklorin shqiptar nuk gjendet një begati e tillë gastronomike, që ndeshet ndër popujt e tjerë mesdhetar. Shpesh, në letërsinë tonë popullore, vendin e shijes e zë uria. Si popull blegtor që jemi, në këngët folklorike, por edhe në përrallat, sundon mishi. Por i këndohet gjithashtu edhe ushqimeve të tjera bazike si buka, vaji, vera dhe më vonë rakia...

Po t’i referohemi burimeve të tjera të shkruara, si dhe po të shestojmë me vëmendje dokumentacionin e kohës, vihet re një situatë antropologjike shumë interesante, që ka të bëjë me raportin që vendoset midis ushqimit, alias mirëqënia materiale, dhe asaj mendore dhe shpirtërore. Mjafton të citojmë këtu Kreun e 134 të “Kanuni i Skenderbeut”, ku thuhet se: *Garantët të betohen në Ungjill përpara të ngrënit. Garantët e thirrur në gjyq duhet të vijnë në të njëjtën çështje. Secili prej tyre duhet të ftohet të bëjë betimin mbi Ungjill përpara ngrënies dhe jo pas saj. Përndryshe, dëshmia e tij nuk konsiderohet e vlefshme.*¹¹

Çështjen e ushqimit e gjejmë të sanksionuar edhe në statutet e Shkodrës venedikase. Ja se çfarë shkruhet në kreun e 274 “Mbi peshkun që i takon Kontit e mbi dorëzimin e mallrave të tjera”: *Viti 1393, dita e dhjetë marsit. Ne, të gjithë njerëzit e Komunës së Shkodrës, të mëdhenj e të vegjël, duke qenë me mendje të njejtë dhe të shëndoshë, të mbledhur në kapitullin e kanonikëve, dëshirojmë të konfirmojmë privilegjin me vulë të artë të varur që u lëshua dikur nga Perandori Stefan, lidhur me peshoret, ku thuhet se kontit duhet t’i dorëzohet një e dhjeta e ngjalave, një e nënta e krapit, ndërsa për peshqit e tjerë, t’i jepet një e gjashta, jo më shumë. Për qetë e arave t’i jepet një grosh, po ashtu edhe për lopët e qumështit, kur ato çohen në treg, për çdo kokë derri, të jepet jo më shumë se një gjysëm grosh, kurse për bagëtitë e imta, të paguajë një grosh për kokë, për kalin 6 groshë dhe për një shitje drithi, të paguajë një sold për vandaq, për lesh të tjerrur në shtëpi, të dorëzojë jo më shumë se 34 groshë*¹².

Mbas dy shekujsh e gjysmë, situata

⁹ Joyce, James. “Uliski”. Botimet Zenit. Tiranë, 2009. F. 57.

¹⁰ La Grande Bouffe

¹¹ Ilia, Frano. Kanuni i Skënderbeut. Shkodër, 1993. fq.39.

¹² Statutet e Shkodrës. Botime Onufri. Tiranë, 2010. F. 376



ka ndryshuar katërcipërisht për keq. Në relacionet e Frang Bardhit për Propoganda Fide të vitit 1637, gjenden të përshkruara situata rrënoqethëse që kanë lidhje me të ushqyerit e fshatarëve dhe malësorëve shqiptarë: *Dhe këtu në këtë katundin e Këçirës u krye vizita e jonë në Pukë, e cila zgjati 16 ditë: çdo ditë tue vizitue ndonjë katund dhe tue ecë ndonjë herë 16 milje çdo mbasdite, tue pushue natën dhe të nesërmen në mëngjes tue u marrë me punët e vizitës deri në drekë. Buka që hanim në këtë vizitë ishte prej sorgu përzie me mel, e zezë dhe e gatueme keq, që nuk kishte pamjen e bukës as ndonjë shujte dhe ndonjë herë as nga kjo nuk gjendej, sepse kishte zi të madhe buke në katundet e thanuna. Venë gjendej në disa vende e në disa jo, dhe disa vraponin ta blenin aty ku gjendej, e disa jo, dhe atëherë u donte me drekue, në mos pa gjë, me uj të ftohtë. Mish, djathë e hudra na jepnin me ngranë pa llogari. Duhej të flinim përjashta, e disa herë n'erë e në shi, për dhe mbi pak bar; goftë për hatër të zotit perëndi prej të cilit pritet e korra.*¹³

Gjithashtu në fazën paraletrare kemi edhe ndonjë poezi si puna e poemës “Trahanaja”¹⁴ e bejtexhiut Hasan Zyko Kamberi, që duhet të ketë jetuar fundin e shekullit të XVIII dhe fillimin e shekullit të XIX, i cili i këndon jo vetëm produktit, por edhe mënyrës së të bërit.

Gjurmë të kuzhinës tradicionale shqiptare duhen kërkuar edhe te folklori arbëresh, te ky komunitet që ka ruajtur të gjallë kujtesën e Motit të Madh. Kështu përshembull, Kulaçi arbëresh është një nga elementët e përfshirë në kandidaturën e riteve dhe trashëgimisë arbëreshe për në UNESCO. Cugliaccio (në arbërisht *Kulaç*) është një ëmbëlsirë tipike e traditës gastronomike arbëreshe të San Costantino Albanese. Që nga shekulli i 16-të, përgatitja e kësaj buke ka qenë e lidhur me dasma dhe festën e Pashkëve. Ritual i përgatitjes së tij karakterizohet nga një simbolikë e fortë fetare, e cila në përgjithësi vepron në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e kulturës Arbëreshë.

Gjatë periudhës së fundit të pushtimit turk dhe kohës së ndërtimit të qyteteve shqiptare, mënyra orientale e gatimeve, ngrënies dhe përdorimit të takëmëve të tjera, sundon në të gjithë botën shqiptare. Ja përshembull një dëshmi që na vjen nga Simon Rrota: *Duhet me ditë se të gjithë kafexhitë kishin dugajën e vet dhe shegertin qi i ndihmonte me shpërnda kafet. Aty kishin mjetet e nevojshme për shtypjen (bluemen) e kafës, shterën e madhe, (nji blok guri i latuem, rreth 60-70 cm i naltë, në mes kishte nji birë në formë cilindri e thellë rreth 40-50 cm.), ku u hidhte mbrendë kaffja kokërr e kavërtisun (pjekun në dallap), qyzkinë (vegël hekuri e randë mbi 1 m e gjatë, në majë paksa e hollë) e me lëvizjet e krahut nalt poshtë u rrahte kaffja qi ishte në të, për me e shtypë e me e bā pluhun dhe sitat. Kto ishin dy llojesh: njana kishte rretën e telit me bira pak ma të gjana për me e sitë për të parën herë kafen, pjesa që mbeste në sitë, u hidhte përsëri në shterë për me u rishtypë, ndërsa lloji tjetër i sitës nuk ishte me rretë telit, por me nji pelhurë të fortë me thuerje të imtë. Kjo u thirrte sitë e mëndafshhtë për me sitë kafen e dalun nga sita e parë, e kështu kaffja e dalun ishte shumë e imtë, e përshtatshme për kafen allaturka. Anash dugajës ishin të shtrueme pak rrogosta (hasre) sa me ndejë, megjithëse nuk ishte zakon me ndejë te kafexhija. Kafet piheshin me miq në dugajën e tregtarit, gja kjo që vazhdonte gjithë ditën. Kafexhijtë shetitshin për të gjatë sokakat me kafe të gatëshme ose me marrë porosi për sasinë e kafeve qi dugajxhitë (dyqanxhitë) kërkojshin. Aso kohe, kafexhijtë i çojshin kafet me tabake vezake teneqeje e me dorcë (dorezë rreth 25-30 cm të naltë) për me e mbajtë pa vështirësi, Me vedi kishin hinin e zjermin si dhe xhezet me kafe të pjekun, të cilat i shprazte në sy të miqve të dugajxhisë, mbasi me vedi kishte edhe filxhanët simbas sasive të porositura.*¹⁵

Gjithashtu, etnografë të ndryshëm të huaj që kanë vizituar Shqipërinë, kanë treguar interes edhe në dokumentimin e mënyrës së të ngrënit. Kështu përshembull, në shënimet e



etnografëve frëng Rene Benezec dhe Jaqueline Benezec, gjejmë: *Në shtëpi, një surprizë e përgjithshme: Preng Cali kishte therur një pulë për ardhjen tonë. Gëzimi ynë i krijoi atij një kënaqësi të dukshme. Na kishte marrë uria tmerrësisht dhe Renë-a, megjithë disa litra raki që na kishin dhuruar xhandarët, nisi të presë pulën, para se ta pjekë. Preng Cali dukej tepër kureshtar nga ky ritual të coptuari, mënyra e pjekjes së pulës, etj. Gjithçka e shikonte me shumë kureshtje. Tashmë ishte ai që merrej me etnografi. Bonati na njoftoi se do të bënte një ometë në mënyrën e tij. Në realitet ishte një recetë turke. Së pari tregova sesi duhej bërë: omleta bëhet si në Francë, por pa i hedhur kripë e piper. Kur ajo piqu, e palosin pa e nxjerrë nga tigani dhe në këtë çast hedhin përsipër me shumicë shurup të përgatitur veçmas me qëllim që omleta të notojë në të. Duhet njomur nga të gjitha anët me shurupin që djeg dhe kështu omleta fryhet menjëherë. Bonati më dha një ide të largët të asaj që duhet të jetë, pasi duke mos ditur si bëhet një shurup sheqeri, ai mjaftohej ta lagte ometën me një gotë ujë të vakët e të sheqerosur.*¹⁶

Po të kthehemi prapë te kujtimet e piktorit Simon Rrota, kur shërbente si përkthyes me ushtrinë austriake në vitin 1917 në Fier, do vëmë re se situata e ritualeve të ngrënies ishte e mjerueshme edhe në jug të vendit: *Jetesë në familje ishte njisoj; me hangër e me fjetë për tokë, ishte baras gjithkund në Shqypni, prandej nuk asht për t'u çuditë. Austriakët si të huej qi ishin, u çuditshin për zakonet tona e mjaft u munduen me i ndrrue këto zakone; të hangunit e të fjetunit, por gjetën kundërshtime të mëdha. Veç, kur mbaroi lufta, ushtriaja la shtretën e tavolina ndër shpijat e popullit e kështu me këtë rasë filluen me pëlqye me fjetë ndër shtretën e ma vonë me hangër në tavolinë, si njerzit.*¹⁷

Në Shqipërinë e Mesme situata në lidhje me të ushqyerit nuk qe më e mirë. Një udhëtar italian i kohës së Luftës së Dytë shkruan: *Dal nga dal erdhi koha e bukës. Njëri nga trimat na shtiu të lajmë duart në një legen bakëri me një ibrik të bukur. I fshimë me rizë të punuar nga gratë e shtëpisë. Pastaj suall sofrën e rrumbullaktë dhe u ulmë rrotull saj, pakëz të mënjauur nga e mëngjërë që t'u lemë vënd të gjithëvet.*

Hëngrrëm në misurin e vetëm që djemtë vendosin në mez të sofrës duke marrë me lugë lëngun e shijëshme të plëndësit me oriz e duke hequr buzëve të misurit lugën që të mos pikojmë. Buka ishte e pjekur në çerep, një çyrek i madh dhe i shijëshme, bukë misri.

Pastaj na nxuar edhe mish qengji dhe mendova tek çuni i vogël, i cili më tha se në shtëpi nuk kishin tjetër veçse kecin e vogël për damàs. Po u qanja hallë, me mëndje t'ime, për shpenzimet që kishin bërë duke blerë edhe një qengj, këta njerëz që s'ishin më pasanikë. Zoti i shtëpisë posa u lëshua tepsia me mishin me oriz mbi sofër, mernte me dorë të tij felat e filloi të na i flakë, secilit përpara.¹⁸

¹⁶ Nga shënimet e etnografëve frëng Rene Benezec dhe Jaqueline Benezec, 1938.

¹⁷ Rrota, Simon. “Po shkruaj per vedi e Shkodrën”. Botimet Fishta. Tiranë, 2018. F.170

¹⁸ V. D. A. “Drekë në Malësi”, Revista “Drini”, 11-12. Tiranë 1943

Ndër këngët e dasmave, si te ato nga veriu e si te ato nga jugu, gjenden dëshmi të shumta poetike rreth ushqimeve dhe përgatitjes së tyre...

Ndërkaq, është shumë interesant fakti sesi një aristokrat shqiptar, ish ambasador i Shqipërisë në USA, shkrimtari dhe intelektual Faik Konica kishte tërhequr vëmendjen e gazetës së famshme amerikane “The Washington Post”, e cila ka botuar, të enjten e 10 gushtit 1939, një shkrim rreth gjellës së preferuar të tij. Ishte Martha Elyn, redaktorja e “The Post Food”, ajo që ia kishtë marrë shkrimtarit tonë recetën e tij të preferuar¹⁹: “Oriz i egër me mëlçi pule”. Ja si ia ka transmetuar Faiku ynë recetën e vet, gazetares: *Lani mirë 6 mëlçitë e pulës. I përzieni me kripë, piper dhe paprika. Shtoni majdanoz të grirë imët dhe një copë gjalpë. Zieni një gjysëm filxhan oriz të egër për 10 minuta. Kullojeni tërësisht. Përzieni orizin me mëlçitë e ziera dhe shtoni 1 lugë sherry. Lidheni përzierjen në letër patapap të lagur. Zhyteni në ujë të vluar dhe lëreni të ziejë për 30 minuta.*

Specifika e traditës sonë kulinarike, e pasqyruar në letërsi dhe art, është se paraqiten dy pamje ekstreme mbi ushqimin dhe të ushqyerit: një denigrues dhe një tjetër glorifikues. Ka vepra apo fragmente që shpesh t'a çojnë gojën lëng, por ka syresh që edhe të ngjallin krupën.

Në këtë kontekst janë shumë impresionuese letrat e ish të burgosurit politik, Pjetër Arbnorit, dërguar familjes, përgjatë 28 vjetëve të burgimit të tij, përmbedhur te libri “Shumë e dashuna nanë”²⁰. Aty gjejmë shembullin sesi një i burgosur i “burgut të vogël” i jep kurajë të burgosurve të “burgut të madh”, siç qenë familjarët e tij në Shkodër.

Burrel 30. 2. 1986. Nji ditë nanë na u hap muhabet peshku e secili nisi me përmendë llojet që njihte dhe gatimin. U thashë nji herë që ta linin atë bisedë ngacmuese, po ata vazhduen. U futa edhe unë në bisedë si shirokas i lashtë, ia nisa nga peshqit e ujit t'ambël, mandej të lumit e në fund të detit. Mandej fola për tavën e krapit, për qefullin e pjekun në tjegull, për gjuhcat e pjekuna në mashë, për ngjالات me oriz, për zorret e qefullit të fërguem, për putargat, për kublat e fërgueme kurma - kurma, dhe biseda do të ishte zgjatë kushedi deri kur, sikur mos të kishte ardhë koha me marrë supën e drekës. Kur dolëm në oborr mbasdite, hunda më zuni menjherë erë peshku. Shoh shokët që t'i lajmëroj, kur vë re se të gjithë nuhasin pa ditë se nga vjen ajo erë. Dikush aty afër, duket se piqte peshk në sobë. Kjo na e hapi edhe njiherë temën e peshkut, e shumëkush atë natë kapërdiu pështymën. Të nesërmen, kur u hap dyqani, shumica blamë nga nji kuti konserve gjuhca, dhe hoqëm mallin.

Ndërkaq ajo që ndodhte në këtë të ashtuquajturin “burg të madh”, përshkruhet më së miri në librin e Krymit “Dekalogu i një lagjeje tiranase”: *Sa i takon gatimit, ndryshonte*

¹⁹ Nga Aurenc Bebja, Francë. Blogu © Dars (Klos), Mat – Albania, :https://www.darsiani.com/la-gazette/the-ëashington-post-1939-gjella-e-preferuar-e-faik-konices-dhe-receta-e-saj/.”The Washington Post”, 10. 8 1939, f. 12

²⁰ Arbnori, Pjetër. Shumë e dashuna nanë. Nacional. Tiranë, 2009

*mjedisi sipas stinës; në dimër gatuhej me sobë me dru, një Bechi italiane, për mirëmbajtjen e së cilës kujdesej vetë Rizai, ndërsa në verë meqenëse e shoqja refuzonte korrentin apo vajgurin, zjarrin e të cilëve nuk e ndërronte me atë të drurit, ai kish shpikur dy soba binjake me tallash. Këto praktikisht ishin dy cilindra gize që mbanin secila përmbi krye një pllakë rrethore po prej gize, të larta pak a shumë sa një kovë 4 litërshe. Sobat kishin secila një sportel të vogël që hapej me menteshë dhe lidheshin mes tyre horizontalisht me një qyngj në trajtë T-je, që lidhej me tubin vertikal dhe nxirrte tymin jashtë. Kjo pajisje përbënte pjesën qendrore të kuzhinës verore, e cila instalohej në fund të oborrit për të gjithë muajt e stinës së butë. Një nikje pranë portës qendrore pajisej dhe me sergjenët e nevojshëm për të mbajtur erëzat, vajin, lugët e mëdha të gatimit etj. Brenda secilit cilindër futej e ashtuquajtura kovë tallashi, në të cilën çelej një dritare 4 x 4cm. Nga kjo dritare futej brenda kovës një copë druri, e cila vihej pingul me një tjetër pak më e gjatë se lartësia e vetë kovës. Pas kësaj, kova mbushej me tallash të imët, e mandej ngjeshjej nga sipër me një tokmak të drunjë. Si ngjeshjej mirë, hiqeshin me shumë kujdes dy copat e drunjtat që kishin formuar këndin e drejtë. Me pak fjalë, në këtë menyër krijohej korridori i ajrit që ndihmonte ndezjen e zjarrit. Nga dritarja e vogël, e cila përputhej me sportelin e sobës, përmes një lecke me vajgur, ndizej zjarri duke bërë që tallashi të konsumohej ngadalë. Një kovë e tillë e mbante zjarrin të ndezur për rreth dy orë. Kështu familja kishte zjarr druri pa dru, përmes përdorimit të lëndës së ricikluar; mënyra më ekologjile e mundshme.*²¹

Gjithashtu letërsia gojore që ecte paralel me atë zyrtare, përcillte një realitet të ashpër edhe nëpërmjet barceletave, si kjo e mëposhtmjta:

Shkon nji kontroll prej Ministrisë së Mbrojtjes të inspektojë një repart ushtarak. Komandanti i kishte përgatitë ushtarët sesi do t'i pwrvgigjeshin pyetjeve të mundshme. Vjen ekipi, kontrollojnë, shohin gjithandej dhe në fund i mbledhin ushtarët. Pyet njëri prej oficerëve të ekipit:

- Si ia kaloni?
- Mirë - përgjigjen ushtarët.
- A jeni mërzitë?
- Aspak - ishte përgjigja.
- Si sillen eprorët me ju ?
- Shumë mirë.
- A ju del ushqimi ?
- Pooooo, na del e na tepron.
- Po çfarë bëni me atë që ju tepron?
- E hamë.

Në letërsinë e Realizmit Socialist, ushqimi thuajse nuk pwrmmendet. Sa më aktuale të ishte ngjarja apo subjekti i veprës, aq më pak përmendej ai, sepse zgjidhja më e thjeshtë dhe më e sigurt ishte shmangia dhe anashkalimi i problemit. Kurse në artin e Realizmit Socialist, tabllotë me temë ushqimin zaptohen nga frutat, pra nga produktet e tokës. Kjo edhe si një farë reklame për punën e kooperativistëve.

Menytë e artit të Realizmit Socialist ishin ideologjike. Në letërsinë dhe artin e asaj kohe, partizanët duhej të hanin vetëm mishernike me një gjysmë qepe, kurse ballistët pula të pjekura të marra me zor ndër fshatarë të varfër.

Po kështu, gjatë viteve '70-'80 kishte skena filmash, ku tavolina shtrohej si për Vitin e Ri. Paraqiteshin dyqane plot me mish dhe me mollë, që shiteshin pa racion. Ndër kontekste të tjera, personazhet jo vetëm nuk hanin, po as nuk laheshin. Është interesant, por në filmat e atëhershëm nuk i sheh një herë duke bërë dush.

Por në përgjithësi pozicioni i shkrimtarëve të Realizmit Socialist ndaj hedonistikës së të ushqyerit ishte krejtësisht indiferent.

Tamam në kohën e tollonëve, më 6 prill të vitit 1987, Shqipërisë do t'i akordohej një çmim ndërkombëtar për ushqimin. Shtypi i kohës sillte një artikull të gazetës zyrtare të komunistëve danezë, ku evidentohet ky çmim që iu akordua Shqipërisë, në një event për ushqimin, të mbajtur në Meksikë. Gazeta daneze “Arbejden” e 22 prillit të vitit 1987, raportonte se çmimi iu dorëzua shokut Sofokli Lazri, si përfaqësues i Shqipërisë.

¹³ Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë veriore e të mesme në shekullin XVII: teksti origjinal dhe përkthimi përgatitur nga Injac Zamputi. Tiranë 1965. F. 83

¹⁴ Hasan Zyko Kamberi ; bot. tekstual kritik. Botimet Albanologjike. Tiranë, 2016.

¹⁵ Rrota, Simon. Po shkruaj për vedi e Shkodrën, Botimet Fishta, Lezhë, 2018, f.14

²¹ Krymi. “Dekalogu i një lagjeje tiranase”. Berk botime. Tiranë 2022. F. 127 – 128.

²² Çapaliku, Stefan. Barceletat e komunizmit. Botimet Fishta. Tiranë, 2022. F.32

Një nga mjeshttrat shkodranë të aparatit fotografik me veprimtari gjatë shekullit XX, është edhe Dedë Jakova. Nga literatura për fotografimin, shtypi dhe familjarët e mjeshtrit (kryesisht i biri, Nikolini, fotograf), mësojmë disa të dhëna për jetën dhe veprimtarinë e Dedë Jakovës.

Dedë Jakova është lindur në Shkodër në vitin 1915, në një familje të vjetër dhe intelektuale qytetare dhe kishte tre vëllezër, Prenk, Ndoc edhe Çesk. I pari u bë një nga kompozitorët më të shquar shqiptar të shekullit XX, madje edhe në gjithë historinë e kulturës kombëtare. Ai është autori (në këtë rast, kompozitor, regjisor, dirigjent) i operas së parë në vend “Mrika” (1958). Ndoci, vëllai tjetër i Dedës, në vitet e L2B, u përfshi në lëvizjen nacionaliste dhe pas përfundimit të luftës, në atë antikomuniste dhe u hodh në mal. Kjo shkaktoi që e gjithë familja të izolohej brenda në shtëpi, madje Deda të arrestohej në burg politik prej 1 janar 1945 deri më 27 qershor 1946. Hija e kësaj periudhe e shoqëroi gjatë të gjithë jetës fotografimin Dedë. Vëllai më i vogël, Prenka, gjatë kohës së izolimit të familjes, ditën punonte si drejtues muzike, kurse natën kthehej në shtëpi e bashkohej me familjarët e tjerë.

Mësimet e para të rregullta, Deda i mori në Kolegjin Saverian të qytetit, ndërsa mjeshttrinë e fotografimit e përvehtësoi pranë fotografit Kel Marubi në studion e njohur “Foto Marubi”. Aty, ai u aftësua shpejt si fotograf, sa që në vitin 1932, djalë rreth moshës 17-18 vjeçare, hapi në qytet studion e tij vetjake të quajtur “Foto Jakova”, veprim që pahtëson besimin dhe kurajon e tij të veçantë për të çarë vet në jetë. Në atelien e tij, krahas punën me bashkësinë e qytetit dhe rrethinave (si të gjithë fotografët e tjerë), Deda nisi të përngrinte në xhama dhe filma celuloidi (të parat me format 10x15 cm, të dytët në filma 6x9 cm) edhe imazhe të ngjarjeve të ndryshme politike, shoqërore, fetare dhe kulturore të Shkodrës, por edhe të zonave të tjera si p.sh. Lezhës. Gjithashtu, ai është tërhequr shumë nga peizazhet urbane, por edhe natyrore të Shkodrës dhe fshatrave të saj dhe i ka fotografuar ato me syrin e një artisti. Me këto fotografime ai ka lënë jo vetëm imazhe dokumentare, por edhe foto arti.

Shtojmë këtu se, Jakova, ashtu si kolegët e tij shkodranë, ka përdorur pajisje (aparate, ndriçues e zmadhues) dhe materiale (xhama, filma, letra, kimikate) të teknologjisë më të re të atyre kohëve. Në vitet ’30 ai ishte edhe përfaqësuesi tregtar në Shqipëri i firmave të njohura italiane për aparate dhe pajisje fotografimi, “Ferrania” dhe “Lomborg”.

Shpejt, Deda u dallua për syrin e mprehtë dhe aftësinë përzgjedhëse të imazheve që do nëpërkallonin objektivin e aparatit të tij. Përmendim këtu, shoqërimin dhe fotografimin e një grupi alpinistësh

FOTOGRAFI I SHQUAR SHKODRAN DEDË JAKOVA

Nga Qerim Vrioni



Dedë Jakova



Tinka Kurti-Foto Jakova, 1949

në ngjitjen e majave të maleve të veriut të vendit, (pra veproi edhe si fotograf sporti)

ose fotografimin e pjesëmarësve të një veprimtarie folklorike në rrethinat e Lezhës. Tek kjo e dyta, ai realizoi disa foto mjaft të goditura, ku bien në sy gratë e hijshme të zonës me xhubletat e tyre mahnitëse. Po ashtu, brenda grupit të madh të këtyre fotove, spikasin disa portrete grash me tipare karakteristike të zonës dhe psikologji të veçantë, të cilat nuk ishin pozime në studio, por shkrepje çasti.

Në grupin e fotove që shpërfaqin jetën shoqërore dhe kulturore të Shkodrës, hyjnë edhe disa shkrepje në oborrin e shtëpisë së biznesmenit të njohur të qytetit, Mark Kakarriqi (një nga organizatorët e Kongresit të atdhetarëve shqiptarë në Trieste më 1913). Ato janë realizuar në vitin 1941, me rastin e një shfaqjeje baleti të një trupe teatrore shëtitëse italiane, “Carro di tespi”. Të dhjetë balerinat italiane ekzekutuan skena baleti klasik rreth një shtatoreje nudo të “Venera” të skulptorit të njohur Italian, Antonio Canova-s, të vendosur në qendër të oborrit në mes një baseni të vogël gjashtëkëndësh me ujë. Ndonëse spektatorët e shfaqjes

ishin të paktë, familjarë dhe miq të afërt të Kakarriqit, fotografimi i saj mund të futet edhe në pasqyrimin e veprimtarive kulturore të qytetit. Shtojmë këtu se, Jakova ka fotografuar edhe skena nga drama të ndryshme të vëna në skenë në Teatrin e Shkodrës nga viti 1932 deri 1940, foto të cilat kanë shumë vlera për historinë e kulturës së qytetit.

Si shumë nga kolegët e tij në Shkodër dhe nga qytetet e tjera, Deda realizoi shkrepje fotografike edhe për t'i shtypur e shpërndarë më pas si kartolina postare. Ai fotografoi shumë në qytetin e tij, veçse dallohet një kënd i veçantë fotografimi, përgjithësisht i pjerrët dhe jo ballor me objektet, duke treguar se e njeh mirë edhe përdorimin e perspektivës në fotografi. Nga një pjesë e këtyre fotove, të kapura në padijeni të qytetarëve, mësohet edhe për jetën e një niveli të mirë civilizimi të shkodranëve.

Një foto unike e Jakovës paraqet një çast nga një zjarr në një banesë fshati (Razëm, 1936), dhe deri tani nuk kemi hasur ndonjë foto të tillë (të paktën autori i këtyre rreshtave). Ndoshta e ka çuar rastësia atje, por ai e ka shfrytëzuar mirë atë. “Ura e Mesit” është subjekti i një fotoje



tjetër të Jakovës të kthyer edhe në kartolinë. Përgjithësisht nga kjo urë fotografohet vetëm harku qëndror, ndërsa në foton tonë paraqiten edhe harqet e tjerë, madje peizazhi i zonave ku të çon ajo, kapje interesante dhe e menduar mirë nga fotografi.

Në nëntor 1937, Dedë Jakova u ftua në Tiranë nga Qeveria Shqiptare, bashkë me fotografë të tjerë të njohur si Gegë Marubi, Kolë Maca, Mandi Koçi, Ali Bakiu, Vasil Ristani, Ymer Bali etj. që të përjetësonin në letrën fotografike festimet e “25-vjetorit të Pavarësisë” në kryeqytet. Të gjithë mjeshttrat paraqiten në foto gati për të kryer detyrën e caktuar, secili bashkë me aparatin e vet “Leica”.

Pas përfshirjes së detyruar të fotografëve në kooperativat e artizanatit në vitin 1955, puna e tyre u normua si mjeshtritë e tjera pa asnjë pikë lidhje me artet, kështu që shkrepjet e aparatit fotografik me synime vetëm estetike nuk mund të praktikoheshin. Në vitin 1970, pas dorëzimit më “dëshirë” dhe me bujë propagandistike të arkivit të fotove (xhama, filma, letër) të “Studio Marubi” nga Gegë Marubi shtetit, edhe fotografët e tjerë shkodranë, Dedë Jakova, Shan Pici dhe Pjetër Rraboshta, i “dhuruan” shtetit arkivat e tyre (Gazeta “Jeta e re”, 14 tetor 1970). Arkivi i Dedë Jakovës përbëhej prej rreth 58 mijë imazhe fotografike, të krijuara gjatë një kohështrirje prej 3-4 dhjetëvjeçarësh.

Dedë Jakova është ndarë nga jeta në vitin 1973, në moshën 58 vjeçare, kohë kur ai mund të jepte ende shumë në lëmin e fotografisë.

Në vitin 2020, “Fototeka Marubi” hapi në Shkodër një ekspozitë vetëm me foto të Dedë Jakovës (një pjesë shumë të vogël të krijimtarisë së tij), nismë kjo me vlerë dhe që u mirëprit nga publiku i gjerë dhe media. Veçse, më i nevojshëm e i rëndësishëm mendoj se do të jetë botimi në të ardhmen i një albumi ose monografie me fotot më të zgjedhura të tij nga një komision e posaçëm. Kështu, publiku, tashmë i pakufizuar, mund të shikojë një numër edhe më të madh fotosh dhe koha e kundrimit të tyre të jetë e pafundme. Dedë Jakova e meriton plotësisht këtë, madje edhe historia e fotografisë shqiptare.



Skenë baleti nga trupa italiane "Carro di tespi", foto Jakova, 1941




Pamje nga Rozafa



Në qytet



Tiranë, 28.11.1937



Jakova-Ura e Mesit



Jakova - Zjarr ne fshat

ÇFARË ËSHTË NJË LEXIM PLAZHI?

By Chelsea Ennen



Përshkrimi i zhanereve në shumicën e rasteve ka kuptim logjik – fantazia ka magji, fantashkenca ka teknologji të avancuar, misteret kanë..., epo, një mister. Shih poshtë çadrave të mëdha të zhanrave dhe do të gjeshtë më të vogla, më specifike, si fantazi epike, opera në hapësirë, dhe thriller domestic.

Por në disa përshkrime zhanrash nuk duket se përshkruhet ndonjë gjë. Një “lexim plazhi”? Çfarë do të thotë kjo? Njerëzit marrin në plazh librat që kanë qejf zakonisht, apo jo? A do të thotë çdo libër që botohet në verë? Apo botuesit zgjedhin një lloj të caktuar librash për të pasur në stenda kur njerëzit shkojnë në aeroport për tu nisur me pushime?

Ndryshe nga disa kategori të dukshme zhanrash, ajo që e përcakton një lexim plazhi nuk është e vendosur. Ka një shumëllojshmëri mënyrash që një libër të cilësohet si lexim plazhi, që do të thotë se ka shumë mënyra për ty, si autor, që ta shkruash një të tillë.

Ngjarjet ndodhin... në plazh!

Elin Hilderbrand konsiderohet gjerësisht të jetë mbretëresha e leximeve të plazhit. Një e diplomuar e punishtes legjendare të shkrimtarëve të Iowa, Hilderbrand është e famshme për libra të vendosur në qytetin bregdetar të Nantucket. Librat e saj shpesh përqendrohen në marrëdhënie romantike, tensione familjare, probleme me biznesin dhe suksese, dhe, sigurisht, plazhin.

Edhe nëse nuk i ke lexuar kurrë librat e Hilderbrand-it, me siguri i gjen titujt e saj vetëm prej imazhit të kopertinës – karriqe Adirondack pranë ujit, ose shapka mbi rërë. Librat e saj janë dukshëm lexime plazhi, por vendosja në plazh është gjithashtu thellësisht e rëndësishme për personazhet e saj. Mund të thuash se, Nantucket, është personazh më vete.

Fiksioni realist është dukshëm i lehtë për t'u vendosur në plazh, dhe ke pikë shtesë nëse është një qytet i vogël bregdetar me personazhe të këndshëm dhe shtëpi të bukura. Shumë seri me mistere fokusohen në qytetet bregdetare, duke i bërë misteret e përsosura për në plazh.

Janë zemërlehtë... kryesisht

Mënyra tjetër se si librat e Hilderbrand-it janë tipikisht lexime plazhi është se konfliktet janë të lehta. Jo për të thënë se nuk janë seriozë – ekzaminimi i ngushtë i marrëdhënieve ndërpersonale dhe problemeve të grave për të përmbushur dëshirat e tyre romantike janë po aq mirë të skicuara sa te secili i të diplomuarve të programit në Iowa.

Por librat e Hilderbrand-it nuk janë frikësues apo shqetësues. Nuk ka vrasës serialë duke përgjuar rrugët e Nantucket-it të Hilderbrand-it, dhe ajo qëndron aq larg të prekurit të ngjarjeve të vërteta politike botërore sa disa e kanë kritikuar për këtë. Hilderbrand-i mund ta çojë lexuesin nëpër një karusel emocionesh, por jo ai lloj ku të duhet të shohësh video këlyshësh më pas.

Si me shembullin e Hilderbrand-it, fikcioni realist është shumë i thjeshtë të mbahet i lehtë, duke marrë me mend se nuk po shkruan krime të vërteta (megjithëse fansat e dedikuar të krimeve të vërteta do të t'i merrnin me gjithë qejf në det këto tituj).

Por çdo lloj zhanri trillimi mund të bëhet pak më i lehtë nëse do, edhe horrori. Mendo për filmat e vjetër me vrasje që kanë trembje argëtuese dhe zuzarë qesharakë në vend të gjakut dhe dëshpërimit.

Është përpirës

Pyet çdo lexues plazhi se çfarë kërkojnë kur po zgjedh titujt për udhëtimin e vet, dhe mund të kenë shumë preferenca. Por “të mos e heq dot nga dora” është me siguri në krye të secilës listë.

Askush nuk do që të lexojë një libër që nuk do ta pëlqejë. Por teksa bëjnë gati valixhet për pushime, shumë lexues duan diçka për të cilën janë të sigurt se do t'u pëlqejë. Dhe meqë e kemi vendosur se subjekti nuk duhet të jetë i rëndë më shumë sesa për një trembëdhjetë vjeçar, dhe duhet të japë atë efektin e këndshëm të të qëndruarit në plazh, leximi yt i plazhit prapëseprap nuk mund të qendrojë pa një përmbajtje tërheqëse për lexuesin.

Si shkrimtar, e di se asgjë nuk krahasohet me ndjesinë se po humbet kohë qoftë edhe vetëm tek je duke ndërruar faqen e një libri veçanërisht magjepsës. Lexuesit duan të njëjtën gjë. Dhe në plazh, duan *vërtetë* që historia t'i tërheqë aq shumë brenda vetes dhe të mos i lërë shtigje për t'u arratisur.

Sërish na del Hilderbrand-i si mjeshtër. Thoni çfarë të doni për trekëndëshat e dashurisë dhe romancat e ndaluara, por ka një arsye pse janë kthyer në klishe: janë një mënyrë e sigurt për t'i mbajtur lexuesit zgjuar deri natën vonë që të mësojnë se çfarë do të ndodhë.

Mendoni se çfarë bëjnë njerëzit në plazh. Notojnë, hanë ndonjë patatinë, dremisin dhe ç'bëjnë tjetër? Rrinë në plazh! Shpesh për orë të tëra, teksa fëmijët po luajnë ose pijet ju vijnë pranë në buzë të pishinës. Për shumë të rritur, koha e kaluar në një vend të bukur, pa asgjë për të bërë, është pushimi i përsosur. Dhe ku të gjeshtë një kohë më të mirë për të hequr telefonin dhe për të marrë një libër në dorë?

Zbavitë lexuesin tënd

Trillimi letrar me prozën e shtjelluar është një gjë. Po ashtu edhe historitë e vështira rreth çështjeve shqetësuese.

Por nëse synimi yt si shkrimtar është për të prodhuar një libër, faqet e të cilit do të krijojnë dredha nga uji i kripur dhe mes tyre do të mbeten grimcat e rërës, atëherë e gjitha çfarë duhet të bësh është t'i japësh lexuesit dhuratën e zbavitjes.

Chelsea Ennen është shkrimtare dhe jeton në Brooklyn bashkë me të shoqin dhe qenin e saj.

Karikaturë nga Arben Mexsi

